

ANISA MARKARIAN: DISA PIKLA DËSHMI NË OQEANIN E KUJTESËS SË PËRBASHKËT

Bisedoi Andreas Dushi

Tradita dhe e sotshmja në
Panairin XXI të Librit në Ulqin
(30 korrik – 02 gusht, 2022)

(fq. 21)

SHËNIME MBI LIBRAT

Me rastin e ribotimit të librit “Valët e Detit” të Spiro Dines

“Valët e detit” – një përmendore
e folklorit shqiptar

Nga Emil Lafe

(fq. 9)

Nga thellësitë e ferrit pashë Jezusin në kryq

“BURGJET...” E DOM
SIMON JUBANIT

nga Visar Zhiti

(fq. 13)

Tetëdhjetë vjet pas fillimit të shkrimit të Ditarit nga Ana Frank

Nesër, “ditare” të tjera do të
lexojmë nga Ana Frank

nga Luan Rama

(fq. 20)

Këtë të shtunë, mbushen 4 vjet nga ikja në amshim e Bekim Lumit,
njërit ndër regjisorët më emblematik të teatrit shqiptar.

Shekspiri dhe Kanuni
i Lekë Dukagjinit

Nga Prof. Asc. Mr. Bekim Lumi

(fq. 12)

Romani “Vdekja e Omerit”

i Adil Ollurit – lugati i një
qarku të mbyllur

nga Ballsor Hoxha

(fq. 7)

Genc Leka në kohën e harresës

FUNDI ËSHTË FILLIMI IM

Dr. Eris RUSI

(fq. 8)



Me rastin e 25 vjetorit të vdekjes së kompozitorit të shquar

Atë që Kadare e bëri në letërsi,
Feim Ibrahimit e bëri në muzikë

Nga Zana Shuteriqi Prela


Ibrahimit shfaq qartë pikësynimin për të tejkaluar nivelet e arritura deri në atë
kohë në muzikën shqiptare. Viti 1967, kur u shkrua muzika e filmit *Ngadhjnim
mbi vdekjen*, përfaqëson ende një fazë të parë të kinematografisë...

(fq. 5)

ALFONS BALLIÇI,
PËRTEJ RRUGËTIMIT
TË USTA
ISUF MYZYRIT

Nga Fatmir Manushi

(fq. 6)



HENRI MATISSE,
“SHËNIMET E NJË
PIKTORI”, 1908

(fq. 22)

BIBLIOTEKË

Anisa Markarian

(fq. 4)

Trupat e rinj

Virion Graçi

(fq. 16)

Ajo di diçka

Agron Tufa

(fq. 17)

Takimi

Roland Gjoza

(fq. 14)

Piktori nga Roma

Shqiptar Oseku

(fq. 18)

Cikli i verimeve

Nurie Emrullai

(fq. 19)

Fletë xhami

Mbi autorësinë e romaneve “Martesa e Lejlës”
dhe “Sotiri e Mitka”

ROMANET QË
JANË KONSIDERUAR
GABIMISHT
TË FAIK KONICËS

Nga Sevdai Kastrati

(fq. 6)

ANISA MARKARIAN: DISA PIKLA DËSHMI NË OQEANIN E KUJTESËS SË PËRBASHKËT

Bisedoi Andreas Dushi



A.D: Tuj rrëmue n' do gjana t'vjetra / gjeta një fotografi. Këto dy vargje nga një këngë popullore shkodrane m'u kujtuan me të hapur faqen e parë të librit tuaj të ri "Shtëpia te Selvia", botuar nga "Çabej" pak kohë më parë, libër që fillon me: *Shfletimin e albumeve të familjes e kam pasion të hershëm. Fotografitë nuk i kundroj, i përjetoj.* Mes letërsisë dhe imazhit të ngulitur – fotografisë, dhe atij në lëvizje – filmit, (ju jeni aktore dhe skenariste, gjithashtu), si do ta emërtonit raportin që krijohet brenda jush e, në të njëjtën kohë, si manifestohet ky raport përtej jush, në atë çka bëni, shkruani, krijoni?

A.M: Vargjet që citoni më tingëllojnë si fillimi i një udhëtimi të vyer; një udhëtim që çdokush nga ne duhet ta ndër marrë një ditë në jetë. *Gjanat e vjetra* - reliket e së kaluarës dhe *fotografia* – çastet e përjetësuar, janë elementet nga nis rrugëtimi ynë i vështirë, por i domosdoshëm, drejt njohjes së rrënjëve familjare.

E ngulitur a në lëvizje, figura është themeli mbi të cilin lartësoj ngrehinën time letrare. I kushtoj një kujdes të veçantë ndërtimit të dekorit historik e natyror në të cilin lëvizin personazhet. Dëshiroj që, për aq kohë sa e ka librin në dorë, lexuesi të ndihet plotësisht brenda "tablosë". I thëthitur nga atmosfera e ngjarjeve. Për këtë, më ndihmon fjala. Fotografia, vizatohet, kompozohet e filmohet nëpërmjet fjalës. Aty-këtu, më qëllon të përfshij edhe shqisat e tjera. Të shijuarit e të nuhaturit, për shembull. Sidomos te libri i fundit, "Shtëpia te Selvia". Gjatë fazës përgatitore të mbledhjes, përzgjedhjes, rifreskimit dhe rindërtimit të kujtimeve, disa nga ndodhitë e jetuara më përhiheshin në formë gatesash. Herë të tjera, më rivinte në hundë një aromë nga fëmijëria e më hapej një botë kujtimesh që mendoja se më ishin fshirë përgjithnjë nga kujtesa.

A.D: Realitetit i kam dhënë një përmasë të re. *Ëndrrën. Një strehë e ylbër të për botën time të brendshme, të papajtuësme me vrazhdësinë e botës që më rrethon. Një botë gri dhe e sëmurë. E shëron veç ëndërrimi.* Kështu fillon tregimi "Kohë ëndërritëse". Lidhur me këtë, më lindin dy pyetje. E keni ndier herë tjetër nevojën për të jetuar brenda kësaj përmasë që, besoj, ka rinovuar veten gjithnjë në bazë të ëndrrave tuaja të reja? Dhe, a mbruhet gjithnjë pikërisht brenda kësaj përmasë letërsia juaj?

A.M: Vazhdoj të ëndërroj, fatmirësisht, por nuk jetoj brenda një bote ëndërrash. Do të ishte tepër kufizuese për temperamentin tim. Të mundesh të ëndërrosh, është një dhunti e bukur - një arratisje shpirtërore e mendore që të çlodh e të përkëdhel. Sipas rastit, edhe të ngushëllon, të ripërtërin e të frymëzon. Ja përse pëlqej më shumë fjalën *projektëndërr*. Ka brenda edhe

këmbënguljen për t'i bërë ëndrrat realitet. Prej vitesh tashmë, në *strehën time të ylbër të*, vendin më të rëndësishëm e zënë ëndrrat për të ardhmen e fëmijëve. Si çdo prind, besoj. Veçse nuk mëtoj t'i realizojnë me doemos. U përket të rinjve vetë të zgjedhin projektëndrrat e jetës së tyre.

Përsa i përket pyetjes së dytë, jo, letërsia ime nuk është e mbrujtur gjithnjë në magjen e ëndrrave. Janë të pranishme shpeshherë, është e vërtetë, por nuk janë tharmi i vetëm i krijimtarisë sime. Në ndonjë rast kanë qenë objekti i saj. Në tregimin distopik "Hëna me

paterica" shpreh "merakun" e humbjes së ëndrrave. Kam përshkruar një shoqëri ku njerëzit dënohen për evazion ëndërrash. I kanë paketuar e postuar drejt një planeti-parajsë për t'i shpëtuar nga zhbërja. Sepse ëndrrat janë si ajri. Nuk mund të jetojmë pa to.

A.D: Tregimeve si këtyre të librit "Shtëpia te Selvia", teoricienët dhe studiuesit u referohen me terma të ndryshëm, mes të cilëve unë pëlqej veçanërisht *autofksion*. Jeta personale, realiteti, ajo çka mund të përmbledhet në pjesën e parë të termit, pra

auto-ja, çfarë vendi zë krahasuar me pjesën *fiksion-ale*, trillimin?

A.M: Vendimin për të përmbledhur në një libër disa nga kujtimet e jetës sime nuk e mora nga dëshira për të shkruar një autobiografi. Të njëjtën gjë mund të them edhe për dy librat e mëparshëm, "Sënduku i kujtimeve" dhe "15 ditë prilli". Qëllimi i vetëm është të jap ndihmesën time në mirëmbajtjen e kujtesës së përbashkët. Me një fjalë, të shtoj disa pikla dëshmi në oqeanin e fakteve mbi të kaluarën tonë të afërt. Ndonëse të shkruara në vetë të parë, tregimet e librit "Shtëpia te Selvia" i konsideroj një biografi letrare kolektive. Ndokujt, që nuk i ka jetuar ato kohë, absurditetet e rrëfyera mund t'i duken trillime. Ju siguroj që janë kryekëput të vërteta. Megjithatë, siç e them në Parafjalë, riprodhimi besnik i kujtimeve është i pamundur. Kjo pamundësi nuk vjen detyrimisht nga vjetërsia e tyre. Faktori kryesor është përvoja jetësore. Sa më e vullshme dhe e larmishme të jetë ekzistenca e tregimtarit dhe sa më kompleks e i sprovuar personaliteti i tij, aq më të përpunuara rezultojnë kujtimet që rrëfen.

A.D: Duke pasur parasysh se informacioni që mund t'i jepej fëmijës nga prindërit gjatë komunizmit ishte i kufizuar, pasi fëmija nga pafajësia dhe pakujdesia mund ta nxirrte ku nuk duhej, sa i vështirë ka qenë për ju perceptimi i botës?

A.M: I vështirë, i ndërlikuar dhe formues njëkohësisht. Jo më kot, në libër e quaj veten *nxënëse të Shkollës së Jetës*. Perceptimi i botës bëhej gjithnjë e më konkret sa më shumë rritesha. Ndihej me fat që prindërit s'më kanë gënjyer. I zgjidhnin fjalët me shumë kujdes e ca përgjigje m'i jepnin të kursyera, por nuk më tregonin broçkulla. Kjo më ndihmoi t'i shpëtoja trushpëlarjes. Me kalimin e viteve, informacionet u bënë të plota e të drejtpërdrejta. Të shoqëruara gjithnjë nga urdhërkëshilla: "çfarë themi në shtëpi mbetet këtu". Me siguri, e njëjta gjë ndodhte në shumicën e familjeve shqiptare. Kur kujtoj se ç'rrezikonin prindërit tanë nga një kallëzim fëmijor, më krijohet bindja se prindërimi në Shqipërinë e atyre viteve duhej të ishte një mision me akrobaci sflitëse.

A.D: Ju e përcaktoni veten si *vajzë babai*. Cili është ndikimi i tij në formimin tuaj? Ç'përfaqëson për ju figura e babait, përtej prindit?

A.M: Po e filloj nga pyetja e dytë. Im atë është heroi im. Njeriu të cilit mundohem t'i ngaj në çdo hap të jetës. Edhe sot e kësaj dite. Përfaqëson ndershmërinë dhe dinjitetin, forcën dhe romantizmin, vullnetin dhe inteligjencën.

Ndikimin e tij në formimin tim nuk



mund ta veçoj nga ai i sime ëme. Secili sipas mënyrës së vet dhe plotësues të njëritjetrit, arritën të skalisin tiparet më të mira të karakterit tim. U jam përjetësisht mirënjohëse.

A.D: Nëntitulli i librit me tregime “Shtëpia te Selvia” është *Rrëfime nga e kaluara e afërt*. Se cila është e kaluara e afërt, kuptohet gjatë leximit të librit. Po e kaluara e largët, cila është?

A.M: Unë si Anisë, nuk kam ende të kaluar të largët. Nuk është çështje moshe. Për dikë tjetër, gjashtë dekada jetë mund të jenë më se të mjaftueshme për të mbyllur hesapet me ca histori të shkuara, vetjake e kolektive, e për t’i arkivuar përfundimisht. Nuk është rasti im. Ja përse vazhdoj të rrëmoj nëpër kujtesë. Bëj pyetje, shfletoj dokumente historike, qëmtoj fakte, kërkoj shpjegime, pres të identifikohen përgjegjësit e krimeve e të më kërkohet falje. E pres si armene dhe si shqiptare. Si bijë e dy popujve të martirizuar. E kam fjalën për gjenocidin otoman dhe atë komunist. Ja përse “Shtëpia te Selvia” është shkruar në kohën e tashme. E shkuara vazhdon të ndodhë.

A.D: Te romani “15 ditë prilli” ju i vendosni ngjarjet në një qytet imagjinari, të paemër, që kushdo mund ta lidhë me Tiranën e viteve ’90. A ka ndonjë arsye të veçantë?

A.M: Ma bëjnë shpesh këtë pyetje. Pothuajse në çdo intervistë apo takim letrar. Kam vënë re se ata që e njësojnë qytetin imagjinari të romanit me Tiranën e viteve ’80-’90 janë bashkëmohatarët e mi ose lexues më të moshuar. Të rinjtë, përkundrazi, gjejnë plot elemente të shoqërisë aktuale të cilave u bën jehonë mesazhi që përcjell libri: despotët mund të lindin në çdo kohë, nëse u japim tepër pushtet, nëse nuk u kërkojmë llogari, nëse u lejojmë ta mbajnë kolltukun për periudha të gjata kohe, nëse i brohorasim apo i votojmë symbyllur. Ky mesazh shpjegon edhe arsyen përse zgjodha një hapësirë pa emër e një kohështrirje pa datë. Për të përforcuar konceptin se ngjarjet që rrëfej në roman janë të gjithëkohshme e të kudondodhshme.

A.D: Mendoni se ngjarjet që ndodhin gjatë atyre ditëve prilli në *Kosheren e Heronjve* i përkasin një linje distopike rrëfimi brenda romanit? Si të thuash, një “1984” apo “Më e mira e botëve”, por në një kontekst tjetër?

A.M: Ngjarjet që zhvillohen në *Kosheren e Heronjve*, në burgun dhe garnizonin ushtarak të Urthit apo te *Kalaja me Zyra* janë tipike të rrëfimit distopik. Por jo vetëm ato. Nëse përkufizimit të termit distopi i heqim veçorinë e përshkrimit të një shoqërie imagjinare, mund të them që i gjithë romani “15 ditë prilli” është distopik. Në libër, vetëm vendndodhjet e ngjarjeve janë imagjinare. Sistemin totalitar që përshkruaj, fatkeqësisht, brezi im dhe ai i prindërve tanë e ka jetuar dhe pësuar në palcë.

A.D: Nisur nga supozimi se “15 ditë prilli” i referohet Shqipërisë në prag të vendosjes së pluralizmit, a mund të më shpjegoni se ç’përfaqëson shkrimtari Vlad Krela?

A.M: Vlad Krela është përfaqësuesi i atyre intelektualëve të paktë, opozitarë të vërtetë, që s’bënë kurrë kompromise me regjimin por që, fatkeqësisht, nuk arritën të shndërrohen në udhëheqës të revoltës popullore që çoi në rrëzimin e diktaturës dhe vendosjen e demokracisë.



Në libër shtjelloj edhe shkaqet e këtij roli të munguar. Së pari: besimi naiv se dikaturat mund të mposhten me vepra letrare; së dyti: privilegjet që gëzonte e kishin diskredituar në sytë e një pjese të popullatës që e konsideronte si “shkrimtar oborri” dhe së treti, më e rëndësishmja: regjimi nuk lejonte asnjë opozitë; kundërshtarët që guxonin të kapërcenin “vijën e verdhë” eliminoheshin menjëherë.

A.D: Në letërsinë e para viteve ’90 dhe artin në përgjithësi, prania e heroit ishte e domosdoshme, ndërsa më pas, shohim se ai zëvendësohet gjithnjë e më tepër me antiheroin. Si e shihni këtë proces?

A.M: E shoh si një zhvillim pozitiv. Një proces që letërsia botërore e ka ndërmarrë që prej dy shekujsh, të paktën. Në Shqipërinë e pasçlirimit, metoda e realizmit socialist u impononte krijuesve të vinin në qendër të veprave të tyre heronj e heroina epike. Letërsia, kinematografia dhe artet figurative kishin për detyrë të himnizonin vetitë e Njeriut të Ri socialist. Shabllonizmi i bëmave dhe tipareve fizike që e karakterizonin ishte grotesk e qesharak. Po sajoj një shembull. Traktoristja e dalluar, kockëmadhe e nofullkërcyer, me muskuj po aq të fuqishëm sa të kolegëve meshkuj, që punonte për të realizuar planin e vitit 2050, arrinte të ishte një nikoqire e papërtuar, një nënë shembullore, një bashkëshorte e ëmbël dhe e kuptueshme – kampione në shtrat, një bijë e devotshme për prindërit e saj të moshuar, sekretare partie e kooperativës dhe studente nate në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike me rezultate të shkëlqyera!

Zëvendësimi i këtyre figurave me personazhe që nuk kryejnë heroizma, që kanë një inteligjencë e një pamje fizike krejt të rëndomtë, ndonjëherë pa ideale e pa virtyte morale ose, edhe më keq, plot me vese e me një të shkuar të kritikueshme, i bën antiheronjtë e letërsisë së sotme më të prekshëm për lexuesit. Një antihero “tipik” në romanin “15 ditë prilli” është Teo Graca. Dezertor, mashtrues, sipërfaqësor e qylaxhi. E, megjithatë, është një personazh shumë simpatik. Pasi i kupton thelbin, lexuesi e ndjek me dashamirësi dhe ia përligj veprimet e gabuara duke menduar se, po të kishte qenë në vendin e tij, do të ishte sjellë në të njëjtën mënyrë. Pra, identifikohet plotësisht në të.

A.D: Zonja Markarian, librin “15 ditë prilli” ua keni kushtuar fëmijëve tuaj

ndërsa “Shtëpia te Selvia”, prindërve. A ndodh kjo pasi i pari rrëfen një histori që e tregoni për ta njohur fëmijët tuaj dhe brezi i tyre ndërsa i dyti, një histori që e tregoni për të nderuar e kujtuar prindërit tuaj dhe brezin e tyre?

A.M: Librin tim të parë, “Sënduku i kujtimeve”, ia kam kushtuar tim eti në shenjë mirënjohjeje për të gjitha nxitjet, mësimet dhe këshillat e vyera që më ka dhënë në jetë. Një ndër to: “ndiqi gjer në fund ëndrrat dhe pasionet e tua”.

Romanin “15 ditë prilli” ua kushtoj fëmijëve të mi për tri arsye. Për t’i falenderuar për durimin që patën dhe inkurajimet e tyre gjatë shkrimit të librit, që zgjati dy vjet e gjysmë; për faktin se me pyetjet dhe kërkesat e vazhdueshme për t’u treguar Shqipërinë time më frymëzuan subjektin e romanit dhe, së fundi, për t’u kujtuar premtimin që më kanë bërë për ta mësuar shqipen aq mirë sa që, një ditë, të arrijnë të më lexojnë e të më kuptojnë pa *Google traduction*.

Librin “Shtëpia te Selvia” ua kushtoj prindërve të mi për arsyen e thjeshtë se, për mua, personazhet kryesore të librit janë pikërisht ata të dy.

A.D: Moshë e letërsisë tuaj është e njëjtë me moshën time (po të mos përmend tregimet e botuara në antologjinë me tregimtarë të rinj në 1990). Në 1999, ju botoni “Sënduku i kujtimeve” dhe veç pasi kalojnë 20 vjet, romanin “15 ditë prilli”. Ndërsa tanimë, duhen dhjetë herë më pak, dy vjet deri te romani i radhës. Nga çfarë vjen gjithë kjo hapësirë kohore?

A.M: S’më kishte shkuar ndonjëherë nëpër mend t’i llogarisja moshën por, meqenëse e përmendët, letërsia ime është te të dyzetat tashmë. Kam filluar të botoj që në moshën 20 vjeçare. Shkruaj pothuajse çdo ditë e jo detyrimisht për të botuar. Më ndihmon të zhdërvjell shqipen time letrare. E vetmja periudhë “shterpë”, që prej 40 vjetësh, ka qenë viti i parë i Covidit. Artistikisht, ndihesh krejtësisht e mpirë. Një ushtar e vijës së parë që të gjithë vëmendjen dhe forcat e veta i kishte përqendruar në një front të vetëm: betejën me armikun e padukshëm.

Hapësirat kohore që ndajnë daljen në dritë të librave të një autori kanë arsye të brendshme që jo gjithnjë përkrijnë me pritshmëritë e lexuesit apo të botuesit. E rëndësishme është rrjedhshmëria e procesit krijues. Kur nuk botoj, s’do të

thotë se e kam lënë pasdore pasionin tim. Në kohëhapësirën mes “15 ditë prilli” dhe “Shtëpia te Selvia”, mbarova së shkruari skenarin e vazhdimin të filmit “Në çdo stinë” (titullohet “Stina e dytë”) dhe dramën me tre akte “Kosherja e Heronjve”. Aktualisht po punoj për romanin e dytë, gjithnjë në frymën e realizmit magjik.

A.D: Në mbyllje, një pyetje për botuesin tuaj, Brikena Çabej. Prej 22 vjetësh i keni qëndruar besnike bashkëpunimit me të. Si do ta përshkruanit punën me të dhe çfarë roli e rëndësie mendoni se ka botuesi në jetën e një libri?

A.M: Të jem pjesëtare e listës prestigjioze të autorëve të botuar nga Botime Çabej, në krye të të cilëve qëndron babai i ndritur i Brikenës, zoti Eqrem Çabej, gjuhëtari dhe albanologu ynë i shquar, e quaj nder e përgjegjësi të madhe. Lidhjet që kam me Brikenën janë më të hershme se marrëdhëniet tona autor-botues. Ne njihemi që në fëmijëri. Nën at tona ishin shoqe shkolle e baballarët tanë kishin miqësi edhe më përpara se të martoheshin me gratë respektive. Për sa i përket Brikenës botuese, cilësia e parë është dashamirësia dhe profesionalizmi me të cilët trajton krijuesit dhe veprën e tyre. E ka të gdhendur në ADN-në e saj. Pastaj vjen përkushtimi i plotë për t’i paraqitur publikut një libër sa më dinjitoz, gjithë duke dëgjuar e respektuar idetë dhe dëshirat e autorit. Dy librat e mi të parë i ka redaktuar Brikena, ndërsa “Shtëpia te Selvia” ua redaktua nga Irena Dono. Cilësia dhe eleganca e punës së saj ndihet në çdo faqe.

Në përgjigje të pyetjes suaj mbi rolin që luan botuesi në ecurinë e një libri, mendoj se një rëndësi të veçantë ka natyra e marrëdhënies së tij me shkrimtarin. Besimi i plotë, vlerësimi dhe respekti reciprok ndikojnë shumë në suksesin e veprës. Të rëndësishme janë edhe mjetet e komunikimit që përdor botuesi për prezantimin e librit dhe të autorit vetë. Jetojmë në epokën e informacionit-shënjestër. Fiton kush e ngul shigjetën (librin) në qendër të tabelës (së vëmendjes). Së fundi, roli i një botuesi mund të shtrihet në kohë duke sugjeruar mundësi përkthimi për ta përçarur veprën drejt publikut të huaj, mundësi adaptimi në skenë a në ekran, ndonjë ribotim, etj.

Ju falenderoj për bisedën e këndshme e ju uroj, ju dhe lexuesve të *ExLibris*, një verë të freskët, të shëndetshme e të frymëzuar.

Anisa Markarian

TRUPAT E RINJ

fragment nga romani «15 ditë prilli»
– Botime Çabej

Tavolina e laboratorit të anatomisë, e gjatë dhe e lartë si vagon dekovili, ishte bosh. Vende-vende, bardhësia e mermerit kishte ca njolla të verdhëlleme. Dritat e fuqishme të neoneve, që zbritnin pingul mbi të, nxirrnin në pah një mori brazdash të holla të skalitura me bisturi si të ishin grihësat ku mprehej veglëria e disektimit. Ida priste fillimin e praktikës në heshtje. Atë mëngjes, përveç Vikut, askush s'kishte denjuar ta përshëndeste. Madje i qenë shmangur duke i qëndruar disa hapa larg. Lajmi kishte marrë dhenë tashmë. Në gjirin e grupit të 7-të B kishte bërë shtrat një lungë me qelb me emrin Ida Raez. Studente me dosje dhe fletërrufe! Çibani rrezikonte të shpërthente nga çasti në çast e t'i infektonte. Bërk! Ja përse duhej respektuar një distancë sigurie.

– Po ju vjen trupi i ri! – i lajmëroi njëri nga studentët e grupit të 5-të A, që kishte pikasur në korridor asistenten e profesorit të shoqëruar nga laborantja; kjo e fundit shtynte karrocën metalike me materialin e freskët mësimor.

– Vëmë bast që plumbin s'do ta ketë në tëmth, por në ballë? – i pëshpëriti Viku në vesh Idës.

– Bast idiot, – ia ktheu ajo nëpër dhëmbë.

Ndonëse pa pikë njohurie në Mjekësinë Ligjore, studentët do të hamendësonin rrethanat, mënyrën dhe shkaku në vdekjes sapo të ngrihej mushamaja e bardhë që mbulonte kufomën. Pastaj do të nisnin vajtje-ardhjet për “kryeshëndoshë”. Përfaqësues të çdonjërit nga grupet do të bënin vizita në sallat fqinje, kureshtarë të dinin se ç'trupa u kishin rënë në hise. Laborantja e ndaloi karrocën paralelisht me tavolinën e mermertë. Mori forca dhe, me të dy duart, shtyu mbi të “pakon” mishtore. Pastaj, me një gjest prestigjitor – mungonin veç të rënat e tamburit për të mbajtur pezull ankthin e të pranishmëve – tërhoqi mbulesën dhe zbuloi trupin e të riut. Nuk duhej të ishte më shumë se 19 a 20 vjeç. Ia kishin ngjeshur pistoletën në ballë dhe ekzekutuar me një plumb të vetëm. Bam!

– Ooj... – u dhemb Ida, sikur plumbi ta kishte përshkuar edhe atë vetë.

Për të mos u rrëzuar, u kap fort pas flanaxhës së tavolinës brenda së cilës shtrihej ulluku që drenonte lëngjet e trupave të disektuar dhe ujërat e shpëlarjes e të dezinfektimit. Tiparet e djaloshtit i kujtuan pikë për pikë ato të të vrarit të plazhit. Lëkurën ezmere, mollëzat e gërryera, vetullat e kërlëshura mbi sytë e squllët si paluze, hundën të hollë, mjekrën drejtkëndëshe, mustaqen të porsadërsirë. Vetëm... vrima e plumbit s'ishte e njëjta.

– Profesor Sabrani është në një mbledhje në Dekanat. Uluni në vendet tuaja dhe priteni qetësisht, – i porositi asistentja tek linte sallën e ndjekur nga laborantja.

Në këmbë pranë trupit, Ida zgjati dorën dhe i ledhatoi kryet. I kaloi gishtërinjtë mes flokëve të qethur shkurt, pastaj ia zbriti ngadalë përgjatë zverkut të rruar “zero”. Akullsi e lagështi. Dhe era hundëshpuese e formalinës...

– Hë, puthe në buzë tani, – e ngacmoi njëri nga djemtë.

– Ho, ho, ho!!

– Fryji te pipi i kallamit, se ndoshta ringjallet, – shtoi një tjetër.

– Hi, hi, hi!

U dëgjua një kërcitje shuplake. Viku i kishte dhënë një flakërimë në fytyrë djalit që zgërdhihej në krah të saj.

– E pamundur... E pa-mun-dur!

– Ç'të ndodhi moj?!

Në prag të derës, gishtin tregues drejt kufomës, qëndronte njëra nga studentet e grupit të 5-të A.

– ... Ne ke... kemi të... njëj... – foli me fërgëllima dhe iu afrua tavolinës. – ... Po të mos e kishte vrimën në ballë, do të thoja që... është i njëjti trup. I yni e ka vrimën pas veshit...

– Është binjakuuuu! – këlthiti Ida dhe u sul në sallën nga vinte studentja.

Në tavolinën e laboratorit të tretë të Anatomisë së Përgjithshme dergjej kufoma që kishte gjetur me Vladin të hënë në të gdhirë në cekëtinën e molit të vogël. Pali dhe Timi ishin aty, që të dy. Të lindur njëzet vjet më parë në një fshat të vogël në rrethinat e kryeqytetit, ishin sëbashku edhe pas vdekjes. Mbi tavolinat e disektimit anatomik të Fakultetit të Mjekësisë. Ç'trajktore e hidhur! Djelmëri e thyer në mes mizorisht. Si do të mund t'ia rrëfente nënës mynxyrëmadhe?! Ku do t'i gjente fjalët për t'ia përshkuar se ç'po i shihnin sytë?! Jo, më mirë të mos

e dinte. Ida u përkul mbi djaloshtin; ia mori kokën në duart e veta. Gishti i vogël preku buzët e përzhitura të një bire prapa veshit të majtë, nga e cila u rrokullisën disa kokrriza rëre. I përkëdheli qafën, shpatullat, gjoksin... Ia ngrohu faqet me frymën e vet. I pëshpëriti fjalë motre dhe e vesiti me lot të nxehtë.

– Shporru, o psikopate! – u çor njëri nga studentët.

– O nekrofile! – e përbuzi një i dytë.

– Mbërritën! – lajmëroi i treti.

I veshur me një përparëse plastike mbi bluzën e bardhë dhe dorezat e trasha prej gome, profesor Sabrani zuri vend pranë kokës së të vdekurit.

– Sistemi nervor qendror përbëhet nga truri dhe palca kurrizore, që e marrin origjinën nga tubi nervor embrional, – u shpjegoi. – Truri është i mbyllur brenda kafkës që e mbron nga goditjet, ndërsa palca shtrihet në kanalën e shtyllës kurrizore të formuar nga vertebrat. Tek i rrituri, truri peshon rreth 1300-1500 gram dhe ndahet në tri pjesë: truri i përparmë, i mesëm dhe i pasëm. ...Frezën! – urdhëroi asistenten.

– Jooooo!!! Mos e prekni me dorë! – buçiti i përbindshëm zëri i Idës.

– Ulu në vend! – ia ktheu profesori autoritar.

– Guxoni t'i ngitni qoftë edhe një fije floku e jua rrjep lëkurën! – e kërcënoi Ida.

Kishte ngritur krahët mbi kokë e mprehur kthetrat. Shprehja e fytyrës së saj kalte tmerr: syshqyer, buzëkërvëshur, gojëçapëlyer, flegrarrëqethur.

– Dil jashtë! – iu përvesh tjetri. – Lipsu! Më dëgjove? Pa gëk e pa mëk!

– Joo!!

– Je e përjashtuar nga Fakulteti! Nuk më takonte mua të ta thoja, por ja ku po të njoftoj: Këshilli Pedagogjik sapo mori vendimin për të ta prerë bursën. S'ke të drejtë të studiosh në universitet. Nuk e meriton!

Ida u bresht. Kishin vendosur t'i hiqnin bursën e studimit pa pritur t'i përgjigjej fletërrufesë. E kishin linçuar.

– ... Në vend që t'i mjekosh, ti do t'i vdesësh njerëzit! Je armike e popullit!...

Po ju, ç'më rrini si mumje?! – iu drejtua studentëve të tjerë. – Nxirrmani jashtë këtë zgjyrë revizioniste!

Por Ida nuk u dha kënaqësinë ta shtynin jashtë derës. Mori çantën e doli vetë. Plagët e përfytyjes së pardeshme me anëtarët e Bashkimit Rinor të Qytezës Universitare (BRQU) i thernin si t'i kishin ngulur spica pishe. Një përlëshje e re trup më trup do ta kishte shpërbërë thërmija-thërmija.



Kur unë nisa studimet në Institutin e Lartë të Arteve, Feim Ibrahim i sapo ishte emëruar zv. Drejtor i shkollës. Në vitin e dytë kryem me të polifoninë e stilit të rreptë. Ishte shumë serioz dhe sistematik dhe, përkundëjt asaj çka ne na pëlqente të mendonim për të, kjo dukej paksa e çuditëshme. Vetëm dy vite më parë, Koncerti Nr. 1 për piano dhe orkestër kishte shkaktuar një turbullirë të pazakontë në qarqet muzikore shqiptare të kohës. Dhe ne, studentët e tij, që me humor e cilësonim mes vetes si mbjellësin e farës së keqe të dekadentizmit perëndimor, për habinë tonë, u ndeshëm me një pedagog apo zv. Drejtor autoritar dhe hijerëndë. Padyshim që, për 18-vjeçarët e asaj kohe, kjo ishte disi zhgënjyese. Së paku për mua, artisti liberal njëmendësohej me ato pak "modernistë" të shpalluar, mes tyre piktori me pamje bohemi Edison Gjergo, që i shkujdesur i zbardhte netët e nxehta të verës përpara gotës së konjakut në "Kafe Tirana", apo enigmatiku Maks Velo, i cili të zgjonte gjithnjë kureshtje tek e ndeshje rrugës pothuajse të shpërqendruar apo gjatë ecjeve malore drejt Dajtit, që e ngjiste filli i vetëm.

Nuk them pra, se e njoha më shumë Ibrahimin si studente, por edhe më pas në këtë drejtim nuk ndodhi ndonjë gjë e madhe. Por di të them me siguri, se ai ishte shumë i vendosur në vetvetë, i mbizotëruar nga bindjet e tij, aq sa, po të ishte i pakujdesshëm - siç ndodhi me mua në një rast gjatë viteve '90 - mund të keqkuptohesh fare lehtë, keqkuptime, do të thoja, së paku për mua, nga ato që mbeten në mendje, pasi nuk dëshiron të ndodhin me njerëz që i vlerëson.

Por atë që jo gjithnjë mund ta gjesësh përmes marrëdhënieve të drejtpërdrejta njerëzore, te krijuesit, veçanërisht tek ata të vërtetët, ku bën pjesë, padyshim, edhe Feim Ibrahim, mund edhe t'ia mbërish ta kuptosh përmes artit të tyre. Vepra muzikore e Ibrahimit them se e jep mundësinë për të njohur personalitetin njerëzor të tij.

Një e dhënë e parë, e shfaqur që herët në krijimtarinë e Ibrahimit, është përfaqja shumë serioze me muzikën në përkatësi me gjinitë dhe mundësitë dramatike të tyre: kur e do puna duke përdorur një gjuhë të elaboruar, shumë komplekse në format e mëdha orkestrale, skenike dhe në muzikën e dhomës; dhe, përkundëjt kësaj, me spikatjen e qartë të gjinive, të themi më popullore, si rapsodia, vallja për orkestër etj. Edhe pse nuk iu kushtua posaçërisht vokalit, në kompozimin e këngëve, romancave apo të gjinive të mëdha vokale-orkestrale mjetet muzikore udhëhiqen qartësisht prej ideve poetike për ta shpënë kompozitorin drejt çlirimit prej standardeve të mërzitëshme të realizmit socialist. Dhe, si rezultati i kësaj, ai ndërtoi këngë të tipologjive të ndryshme, disa prej tyre njëra më e bukur apo më e qëlluar se tjetra. Dy rastet e para për t'u përmendur vijnë prej krijimtarisë së tij më të hershme, të themi të përmbyllur në vitin 1970, por me shenjime të dukshme për muzikën që ai do të shkruante më vonë: muzika e filmit *Ngadhënim mbi vdekjen* (1967-68) dhe kantata *Këngë për komisar* (1970) me vargje të Fatos Harapit. Në secilën prej tyre, në mënyrën e duhur, Ibrahim shfaq qartë pikësynimin për të tejkaluar nivelet e arritura deri në atë kohë në muzikën shqiptare. Viti 1967, kur u shkrua muzika e filmit *Ngadhënim mbi vdekjen*, përfaqëson ende një fazë të parë të kinematografisë shqiptare, për rrjedhojë edhe të muzikës për film, atëherë kryesisht të konceptuar në terma të muzikës orkestrale. Në muzikën e tij të parë të filmit, Ibrahim mendoi se është edhe ndër të parët që përdori funksionalisht lajtmotivin, në këtë rast një këngë shumë e bukur në stilin e këngës partizane, bartëse e romantikës së kohës, e risjellë në tingëllime të ndryshme në varësi të dramaturgjisë filmike.

Kantatën "Këngë për komisar" do



Me rastin e 25 vjetorit të vdekjes së kompozitorit të shquar

ATË QË KADARE E BËRI NË LETËRSI, FEIM IBRAHIMI E BËRI NË MUZIKË

Nga Zana Shuteriqi Prela

ta cilësoja pa droje si veprën, që shënoi ndarjen përfundimtare me kompozimet analoge të llojit, kantata, poema vokale apo oratorio pllakateske të stilit sovjetik. (*Gasparit i varfër* i Nolit, i krijuar më 1937, nuk njihet në atë kohë në Shqipëri). Edhe këtu kënga e kohës II të mbetet në mendje, po aq sa dhe koralet dramatike të finalit apo shtresëzimi harmonik tonalo-modal (pentatoni), që paralajmëron Koncertin nr. 1 për Piano dhe orkestër të një viti më pas.

Kështu nisi rrugëtimi i Ibrahimit drejt kërkimeve për afrimin, me sa ishte e mundur, të muzikës shqiptare me zhvillimet bashkëkohore. Kjo përbën një cilësi të dytë të arritjeve të tij kompozicionale, që do të desha të veçoj.


Koha (fundi viteve 1960, fillimi i viteve '70) ishte më se e favorshme. Letërisa ishte shkëputur tashmë nga tradicionalizmi përmes autorëve të rinj si Ismail Kadare, Fatos Harapi, Dritëro Agolli e ndonjë tjetër. Artet figurative, me Edi Hilën, Edison Gjergon dhe Ali Osekun po bënin përpara në të njëjtin drejtim. Këtë mision në muzikë e mori përsipër Feim Ibrahim, për të kryesuar, gjatë viteve 1970-90, frymën e re muzikore të kohës. Koncerti Nr. 1 lindi pikërisht në vitet e atij ngazëllimi dhe iluzionit për një hapje të mundëshme të vendit ndaj Perëndimit, mbas largimit nga Traktati i Varshavës. Nuk mund të gjendet një rast

i dytë, që një veprë muzikore shqiptare të ketë shkaktuar aq polemika midis ithtarëve dhe mospranuesve. Këta të fundit, krahas ndikimeve moderniste (çuditërisht nga dodekafonizmi i Schoenberg-ut?!), e akuzuan edhe për plagjiaturë, ndonëse nuk kishin dashur të flisnin asnjëherë për importimin e modeleve sovjetike, por as edhe për përshtatjen e shumbujve të autorëve të caktuar romantikë. Pra çështja ishte shumë më komplekse se kaq, pasi reagimi, në të vërtetë, nuk vinte nga lart, por nga qarqet e muzikantëve, një pjesë e të cilëve me mendësi të kufizuara, të tjerë që besonin sinqerisht te doktrina dhe, të tjerë akoma, edhe më agresiv se të parët, që e shihnin të rrezikshëm projektimin e një rruge të re, e cila do të mund ta largonte, qoftë edhe sado pak, muzikën shqiptare nga vetëkënaqësia e provincionalizmit të ligjruar nën petkun e muzikës kombëtare. Nëse kjo do të kishte ndodhur në një shoqëri të hapur, si rasti i Debussy-së në Paris, apo i Stravinskut me *Shenjtërimin e pranverës*, po në Paris, polemikat do të kishin prodhuar padyshim diçka frytëdhënëse. Nuk ka dyshim pra, që trazira e shkaktuar nga Koncerti nr. 1 lidhet me faktin se ai foli me një gjuhë tjetër. Përmes tij, Ibrahim iu përfaqësua estetikës antiromantike të gjysmës së parë të shekullit XX, duke i bërë një shërbim të vërtetë progresit të muzikës

shqiptare të kohës.

Katër vite më vonë, Ibrahim kompozoi Koncertin nr. 2 për piano - midis dy koncerteve edhe dy vepra kompromisi, Rapsoditë nr. 1 dhe 2 për orkestër - edhe më i guximshëm se i pari, për rrjedhojë edhe me pasoja. Koncerti u censuroi, po ashtu siç ndodhi pak a shumë shtatë vite më pas me Koncertin për Oboe, një ndër veprat me frymë më intelektualiste dhe me profesionalizëm të përkorë në muzikën shqiptare të kohës, e cila u dënua të mbetej në harresë. Me Koncertin nr. 2, Ibrahim përcakttoi dukshëm orientimin kompozicional drejt neoklasizmit, të modeluar pjesërisht sipas shembullit të baletëve të Stravinskut - për energjinë ritmike dhe përparësinë e ritmit përkundëjt melodisë - dhe sidomos të Bartokut. Përse neoklasizmi dhe përse Bartoku? Mendoj se gjetja ishte e duhura, së pari sepse e orientonte muzikën shqiptare drejt një estetike konstruktiviste, pra disiplinuese, që i kufizonte shtigjet e abuzivizmit me pseudo-frymëzimin apo populizmin dhe provincionalizmin në emër të artit kombëtar; dhe, së dyti, sepse përmes shembullit të Bartokut, i cili nëpërmjet shfrytëzimit racional të folklorit ndërtoi gjuhën e tij origjinale bashkëkohore, muzika shqiptare do të mund të kërkonte shprehje identitare përtej praktikave të folklorizmit apo të stilizimit të materialeve burimore.

Vitet '90 shënojnë fazën e fundit krijuese të Ibrahimit, dhe ai sërish u vu në krye të proceseve të reja kompozicionale. Në maj 1993 organizoi koncertin e parë të Muzikës së Re Shqiptare, me të cilin hapet, praktikisht, kapitulli i zhvillimeve bashkëkohore të muzikës në vend. Si kompozitor e nisi këtë periudhë përmblylëse krijuese me një veprë eksperimentale, *De profundis*, e cila shenjon edhe fillimet e muzikës elektro-akustike ndër ne. Në katër vitet e fundit të jetës, krijimtaria e Ibrahimit njohu një përqendrim të thellë dramatik, me nota tragjike, të spikatur veçanërisht te trio e harqeve *Vikamë* dhe simfonia *Tragjike*, por të paralajmëruar shumë më herët, do të thosha që te koha II e Koncertit nr. 2 për piano, te romanca *Recital i malësorit* me vargje të Migjenit (1976), pjesërisht edhe te Simfonia për orkestër harqesh (1988). Kompozitori duket se po e mbyllte jetën me një dhembje të akumuluar nga shtresëzimi i zhgënjimeve të njëpasnjëshme, që realiteti mbytës u ofronte me shumicë artistëve shqiptarë. Ndër të tjera, ai duhet ta ketë vuajtur thellësisht humbjen e gjatë në kohë për të arritur atë çka dëshironte, gjithashtu edhe largimin nga detyra si drejtor i TOB vetëm një vit pas emërimit, por edhe daljen e befasishme në pension si vendim i një rektori që ishte edhe ai vetë pensionist. Por një prej dy veprave të fundit që ai la, *Regalo di nozze* për violonçel dhe piano (e luajtur një vit pasi u shkrua, "post mortum"), dhuratë për martesën e vajzës së tij, është befasuese për atë përpunim mjeshtëror të linjave instrumentale, që e pajisin me një tish të rrallë hijeshie.



Vijon nga numri i kaluar

Shkakun dhe natyrën e kësaj marrëveshje për romanet e porsitur të Aladro Kastriotit është vështirë ta besojmë. Argumentet e radhitura më sipër nga F. Andrea janë në fushën e hamendësimeve dhe është e çuditëshme se si një hipotezë e tillë (aspak e njohur dhe e trajtuar deri më sot në historinë e letërsisë shqipe) është pranuar si tezë bindëse nga Th. Gjika.

Për këtë hipotezë (pa asnjë provë) kemi një përgjigje, siç shkruan vetë Konica në polemikat e tij:

«Ata që kanë studiuar pakë frëngjishten e vjetër, do të kenë vënë re në kohërat e shkuara ka patur në Francë një soj njerës që quheshin *valets de plume*, do me thënë *hyzmeqarë të pëndës*. Njerës të pasur që kishin bujq-skllavë vëjën nonjë të mësojë të shkruaj nga prifti i vëndit, dhe skllavinxënës bëhej pastaj hyzmeqar i pëndës, shkruante mi gjunjë dhe duke u-dridhur urdhërat e të zot».

Dhe më pas vazhdon:

«Në Shqipëri, ku rastet e historisë, dhe as pakë dëshira e popullit, e çliruan vëndin dhe po e shtrëngojnë me zor të modernizohet shpejt a von, në Shqipëri leu një zanat i çuditshëm, më i poshtë se ay i hyzmeqarëve të pëndës: - zanati i *larove të pëndës*. Gjith' ata njerës të cilët, po të kish mbetur Shqipëria siç ka qënë, do t'ishin bërë *laro*, do me thënë njerës të paguar për ta ndihur në vrasje e në grabitje, mbeten sot pa punë; dhe që të mos rinë pa bukë, ndruan formën e veprimt tyre, dhe nga *laro të pisqollës*, u-bënë tani *laro të pëndës*, do me thënë i japin me qira pëndën e tyre të mykur çdo njeriu i cili u heth një urdhër, u dëfton me gisht një shënjë, u flak një këlbazë me një kuletë, dhe i lë të *“punojnë”*».

Me interes të veçantë është përkufizimi që Konica bën për larot: *të dyfekat* për të vrarë *trupin*, kurse *të penës* për të vrarë *nderin*.

Në një rast tjetër F. Andrea përmend vitin 1909, pikërisht në këtë vit Faik Konicën e ka kapluar një krizë ekonomike. Sipas tij:

«Dhe si përherë e mbi të gjitha i duheshin të holla. Ah, ato të shkreta të holla!!!...»

Nuk pajtohem me pohimin F. Andreas për vështirësitë ekonomike që kishte Faiku në vitin 1909, sepse në këtë vit Faiku vazhdon të marrë subvencionin e caktuar nga Vjena për të mbuluar shpenzimet tipografike për botimin e “Albanisë” në çdo tre muaj. Siç dihet e përkohshmja e famshme “Albania” pushoi së botuari më 15 shkurt 1909 dhe po në këtë datë u nis botimi i gazetës “Dielli”.

Është një gjë e ditur se Faik Konicën vështirësitë ekonomike do ta shoqërojnë gjithë jetën: mbas botimit të numrit të shtatë të *Albanisë* s'kishte asnjë para, kurse në vitin 1902 në një letër që i dërgon At Pashk Bardhit i kujton ‘një barrë të rëndë që ka dhe ajo është vobektësia’. I ftuar prej Shoqërisë “Besa-Besa” për ta botuar “Diellin” arriti në Boston më 9 tetor 1909. Ai nisi punën e redaktorit më 30 tetor dhe pas një mosmarrëveshje me kryesinë e shoqërisë “Besa-Besë” më 25 shkurt 1910 dorëhiqet nga drejtimi i “Diellit”. Dorëheqja e tij nga drejtimi i “Diellit” i çuditi të gjithë: u vendos nga anëtarët si drejtor i gazetës gjer më 1 korrik, kur gazeta për shkak të fondeve u mbyll. Gazeta u botua tre muaj më vonë (7 tetor 1910) nën drejtimin e Fan S. Nolit. Dy vjet më vonë, më 18 korrik 1912 përsëri Faik Konica⁴ do të jetë drejtues i “Diellit”. Tashmë e ka hequr edhe titullin *bej* pas emrit ‘e shkruan për Komisionin Federal: Faik Konitza’. Ai do të mbajë detyrën e redaktorit dhe sekretarit

Mbi autorësinë e romaneve “Martesa e Lejlës” dhe “Sotiri e Mitka”

ROMANET QË JANË KONSIDERUAR GABIMISHT TË FAIK KONICËS

Nga Sevdai Kastrati

Më bën përshtypje se si Fotaq Andrea nuk ngurron para hipotezave dhe ec përpara pa fakte. Pajtohem pjesërisht se Konica nuk i ka përmendur, por kjo nuk do të thotë se ai nuk kishte dijeni për ‘romanet misterioze’. (Në parim, romanet nuk janë të panjohura për Konicën). Romani “Sotiri e Mitka” është shitur për lexuesit gjatë kohës që Konica e drejtonte “Diellin”, ndërsa Fan S. Noli ka qenë i pari që na njofton për romanin në fjalë më 1911. Pastaj romani “Sotiri e Mitka” është shitur për disa vjet: herë në shoqërinë “Besa-Besa”, herë në “Vatër”.

të përgjithshëm të *Vatërës* deri më 8 korrik 1913 (edhe pse është larguar nga Bostoni më 16 dhjetor 1912.) Ai është zotuar se do të dërgojë në gazetën “Dielli” për botim një sërë korrespondencash: botohen vetëm dy prej tyre për çështjen shqiptare⁵. Ndërkaq në gazetën “Dielli” nga 19 dhjetori 1912 deri më 8 korrik 1913 njoftohet se Faik Konica do të dërgojë nga Evropa kryeartikullin dhe korrespondencat e nënshkuara. Në të vërtetë botohen vetëm dy letra: në të parën, që mban datën 28 maj 1913, Konica rrëfen se ka botuar rreth njëqind artikuj gjermanisht për çështjen shqiptare në Vjenë. Ai ka kundërshtuar kandidaturën e princit Mexhid të Turqisë dhe princit Fuad të Egjiptit për fronin e Shqipërisë. Ndërsa letra e dytë është dërguar nga Konica për shkak të

një shkrimi⁶ ku ankohen pse i dërguari i tyre nuk shkruan asnjëherë për gazetën “Dielli”. Në letrën e botuar më 4 mars 1914 Konica i bën me dije se nuk ka vajtur në Evropë nga *Vatra* për të dërguar korrespondencat për gazetën “Dielli”, por ka vajtur me një mision të veçantë që kishte për qëllim të sillte një princ evropian për fronin e Shqipërisë dhe të përpiquej që kushtetuta e Shqipërisë të ishte liberale. Dy vjet më pas “Vatra” i dërgon 100 dollarë për të blerë broshurën *L'Allemagne et l'Albanie* [Gjermania dhe Shqipëria] dhe ishte marrë vendim që broshura të përkthehet në anglisht. Jo vetëm që broshura nuk e pa dritën e botimit në anglisht, por e detyruan Konicën t'i kthejë paratë. Për shkak se Konica (diplomati me formim shkencor e historik – siç thotë

Luan Starova) e kritikonte Gjermaninë që kishte kurdisur një plan për copëtimin e Shqipërisë nga Greqia dhe Bullgaria. Me këtë rast marrëdhëniet e Konicës me *Vatërën* u ndërpre. Por më vonë, në vitin 1921, do të shkruajë se “Të gjitha këto më vijnë nga “Vatra”, se s'më shkonte as n'ëndër që të më nxjerin pa tjetër shkak veç se thashë të vërtetën”.

Tani për tani nuk mund të pohet me siguri (nuk kemi shumë të dhëna) se në çfarë rrethana ekonomike jetonte Konica në Zvicër dhe në Austri. Ndërsa sa përket qëndrimit në Itali vetë Konica hedh dritë në një letër që (mban datën 25 maj 1921) i dërgon nga Roma dy të rinjve Sotir Noke e Konstantin Demo, botuesit e gazetës “Shkëndija” në Watertown:

«Që të mundim t'i bëjmë një shërbim të vërtetë vëndit t'onë, më duhet nonjë mot të mos merem me tjetër gjë, veç se me të ndriturit e mëndjes së përgjithëshme në Shqipëri. Po këtë punë jo vetëm s'e bëj se s' m' arrijnë mjetet që kam për të jetuar në një vënt si Italia, po kam bërë dhe borxhe që më vënë në një ndodhje të dëshpëruar. Përveç kësaj, kam me vete një mbesë që i ka vdekur i ati.»

Në vitin 1921 Konica kthehet përgjithmonë në SHBA. Ai si kryetar i *Vatërës* dhe kryeredaktor i “Diellit” më 1926 kishte një pagë javore rreth 60 dollarë, kurse si ambasador i Shqipërisë pagën javore e kishte 28 dollarë.

Së fundi, Faik Konica ndërroi jetë më 15 dhjetor 1942. Edhe në çastin e fundit: Ai vdiq i vetmuar dhe me borxhe.

Nga anë tjetër, është për t'u përmendur se, Faik Konica nuk ka pasur mjetet ekonomike t'i botonte vetë librat që i shkruante. I pari botim që bëri, është fjala për shqipërimin e përrallave arabe⁷ *Një-mijë net dhe një natë* me titullin *Nën hien e hurmave*, i mbeti borxh shtypshkronjës. Duke u nisur nga pohimet e tij se “shumë Vatanë më dhanë një përkrahje fisnike dhe shitnë disa libra e më dërguan paratë, - janë ca të tjerë që i shitnë dhe ose harruan të më dërgojnë gjësëndi ose muarnë paratë dhe shkuan në Shqipëri”. Më vonë Konica vendosi për librat që do të shkruante t'i botonte pjesë-pjesë nëpër shtyllat e gazetave me qëllim që të shpëtonte nga borxhet e shtypshkronjës. Siç dihet Faik Konica ka botuar në shtyllat e gazetës “Dielli” veprat e papërfunduara: *Dr. Gjëlpera zbulon rënjët e dramës së Mamurrasit*, dhe *Shqipëria s'i m' u-duk*.

F. Andrea pasi ka qëmtuar me durim e këmbëngulje ka arritur në përfundim se Faiku ynë nuk i përmend askund romanet “Martesa e Lejlës” dhe “Sotiri e Mitka” sepse nuk ka:

«asnjë dokument, fakt, gjurmë nuk ka për to, as edhe një aluzion i vetëm, edhe pse Konica herë-herë nuk mungon të fliste për artikuj, studime, shkrime të tij lart e poshtë, tek botonte në shtypin e huaj, me emër e pa emër, madje edhe për projekte libash që niste, i linte përgjysmë apo i çonte gjer në fund. Pra, as edhe një gjurmë nga ana e tij për këto dy romane, edhe enigma bëhej më e çuditshme e misterioze!»

Më bën përshtypje se si Fotaq Andrea nuk ngurron para hipotezave dhe ec përpara pa fakte. Pajtohem pjesërisht se Konica nuk i ka përmendur, por kjo nuk do të thotë se ai nuk kishte dijeni për ‘romanet misterioze’. (Në parim, romanet nuk janë të panjohura për Konicën). Romani “Sotiri e Mitka” është shitur për lexuesit gjatë kohës që Konica e drejtonte “Diellin”, ndërsa Fan S. Noli ka qenë i pari që na njofton për romanin në fjalë më 1911. Pastaj romani “Sotiri e Mitka” është shitur për disa vjet: herë në shoqërinë “Besa-Besa”, herë në “Vatër”.



Do të ndalem edhe një herë në hipotezën e pakuptimshme të F. Andreas kinse Konica i dorëzon 'romanet në dorë Aladros kundrejt një pagese për punën e bërë' dhe nga ana tjetër mbetet një problem i hapur mosgjetyja e shumë imagjinare të parave!!!

Vlen të theksojmë në këtë rast se F. Andrea nuk e njeht veprën Faik Konicës.

Në letërkëmbimin e Faik Konicës gjenden tregues të shumtë për të vërtetuar se çfarë do të thotë marrëveshje për librin. Kështu për shembull:

a) Faik Konica u propozon S. Nokës dhe K. Demos që t'i botojnë kujtimet e tij që nga Lufta Ballkanike e deri në ikjen e princ Wied-it nga Durrësi (1912-1914). U bën me dije se libri do të ketë rreth 300 faqe në një formë me "Othellon" e Fan Nolit. U propozon në tirazh 4000 copë. Ndërsa sa i përket çmimit, po ashtu u propozon \$1.50 ose \$ 2.00 për copë, ndërsa për vete kërkon 0.50 centë. Po ashtu, Konica bën me dije se pjesën e parë të dorëshkrimit e kishte gati dhe me të pranuar ofertën do ta dërgonte menjëherë në postë.

b) Më 10 qershor 1930 botohet në gazetën "Dielli" një letër e Fuad I. Babametos, kryetari i Shoqërisë "Drita" të gjirokastritëve nga East Pittsburgh-u (PA), ku na bën me dije se Faik Konica nuk e kishte bërë gati librin e blerë nga Shoqëria "Drita", sepse e patën penguar "shumë punë serioze që ka patur, dhe do t'ketë për një kohë të shkurtër". Po aty mësojmë se Konica i pati kthyer të hollat si paradhënje që i kishte marrë dhe ai pati premtuar se librin 'do t'ja dhuroj "Dritës" darovisht kur t'a përgatit'. Se për çfarë libri bëhet fjalë dhe se a ka mbetur për gjysmë sot për sot nuk mund të dimë.

Kjo që një përpjekje e kotë e Fotaq Andreas për të provuar, se edhe kjo hipotezë ndihmon për të përcaktuar autorësinë e romaneve. Pikërisht kjo hipotezë⁸, do të përsëritet në një rast tjetër nga Andrea si ide e ngjashme me një vepër tjetër të Konicës. Është fjala për librin *A Short History of Albania* [Një histori e shkurtër e Shqipërisë], libër që mbeti i papërfunduar dhe nuk e pa dritën e botimit në gjallje të autorit. U botua më 1957 nga Qerim Panariti me titull të ndryshuar *Albania: The Rock Garden of Southeastern Europe and Other Essays* [Shqipëria: kopsht shkëmbor i Evropës Juglindore dhe ese të tjera].

vijon

⁴Jup Kastrati gabimisht përmend datën 1 gusht në monografinë e tij për Faik Konicën në faqen 165.

⁵Shih Faik Konica: *Mbretëria shqipëtare edhe paanësia e saj*, "Dielli", 16 janar 1913, nr. 184, f. 2 dhe *Problemi i kufireve*, "Dielli", 6 shkurt 1913, nr. 178, f. 2.

⁶'Yll' i Shqipërisë: *Shqiptarët e Amerikës dhe Faik Konica*, "Dielli", 27 janar 1914, nr. 281, f. 1.

⁷Edhe në këtë rast J. Kastrati gabon kur thotë se botimi i parë u bë nga "Vatra". (Në fakt është 'shtypur me harxhet e përkthenjësit'). Shih Jup Kastrati: *Faik Konica*, "Gjonlekaj Publishing Company", New York, 1995, f. 66.

⁸Shih Fotaq Andrea, *Zbulim i rrallë në Letrat koniciane* (Faik Konica alias Gjoni i Krujës me dy romane të reja, të panjohura deri më sot, "Martesa e Lejlës" – "Sotiri dhe Mitka"), "Illyria", 28 nëntor 2016, f. 51

ROMANI VDEKJA E OMERIT – LUGATI I NJË QARKU TË MBYLLUR

nga Ballsor Hoxha

Në këtë roman, në këtë shtresëzim të një shoqërie nën ankthin e pafuqisë ndaj urisë së saj, nën ankthin e pafuqisë ndaj vegjëlisë së saj, ka një kurthim, është lehtësia e gjuhës dhe prapavijës së shkëmbimit të pjesëve të romanit. Kjo lehtësi e të trajtuarit të kësaj narrative, e cila edhe i përgjigjet standardit të shoqërisë të cilën e trajton, dhe edhe regresit që ka pësuar shoqëria shtjellohet si kritikë e shoqërisë së mbyllur në atë që autori e quan "Mujshmeri", e që është zhveshja e shoqërisë në forcën fizike dhe brutalitetin e klanores.

Autori i romanit në fjalë e fillon narracionin me një krisje të tërë shoqërisë. Me vdekjen e një njeriu pikës më të dhembshme, më të brishtë dhe më të thellë. Vdes Omeri, djali i Mujës. Në të vërtetë vritet Omeri. Këtu megjithë paradoksin autori i kthehet vetë legjendës së Mujës dhe Omerit për të ri-reflektuar dhembjen dhe dashurinë e zhveshur në mbijetesë e uri fizike të një kolektivi. Derisa kjo shoqëri vuan patriarkalen e një babai për tërë shoqërinë, Mujën, edhe zgjidhja, tërë ajo që pason në kulminacionin e romanit e sipër i rikthehet dashurisë së babait ndaj djalit të tij, si paradoks i pazgjidhshëm i një shoqërie patriarkale. Në të vërtetë thënë thjeshtë, patriarkalizmi si një lugat i një ankti të një shoqërie vdes, vritet (qoftë edhe pafajshëm) dhe ngritët përsëri në fundin e tij, në lamentin e shoqërisë ndaj djalit të "vetëm" të babait të vetëm të tërë shoqërisë. Kjo në të vërtetë

është vetë Daed End, vetë qorrrokaku, e rruga e padalje e një shoqërie të mbyllur në jo vetëm vuajtjen e saj, por edhe shpërbërë humanizmin dhe dinamikën e të përballurit, të ballafaquarit. Gjë që sjellë në mendje teknikën e autorit Olluri në këtë roman ku nuk ka asnjë ballafaqim dhe asnjë dialog.

Më tutje, kjo krisje siç është paramenduar e zbrërthen dhe e shpërfaqë të palarë tërë shoqërinë. Shoqëria është e ndarë në ekstremin e vetëm dy anëve, në ata që kishin lidhje dhe vetëm për këtë e vuajnë vrasjen e një njeriu të pafajshëm, dhe ata që urrejne çdo gjë që është në lidhje me këtë. Ekstremi i të jetuarit me një baba për të gjithë, me një njeri mbi të gjithë, me dhe pa dëshirën e shoqërisë, krisë zinxhirin e ekstremeve të cilat e zbulojnë terrenin për të shprehur tërë nënshtrimin shoqërisë. Edhe në anën nënshtruese por edhe anën e nënshtruar të anëtarëve të shoqërisë. Në të vërtetë kjo është shoqëri ku është zhdukur dinamika e humanes, dhe në këtë tërë kolektivi jeton si i dytë (From), si dhurues i lirisë personale për një baba mbizotërues.

Këtu në të vërtetë, haset edhe prapavija e kësaj shoqërie, vetë shkëmbimi dhe zhvillimi i saj deri aty ku është. Në të vërtetë ka shumë pak krahasim dhe dinamikë në roman, mirëpo, është e qartë se liria e dhuruar, liria e të qenit të dytë, liria e të qenit turmë, është ankti i një shoqërie e cila është viktimë e shtjellës së stagnimit në historinë e saj patriarkale, pamundësinë të dalë jashtë saj

dhe të zhvilloj shoqërinë si është. Gjë që sjellë pyetjen nëse kjo është pamundësi e daljes prej kësaj strukture patriarkale me një Baba mbizotërues të tërës, apo është vetë reaksioni i shoqërisë nën shtjellat e konstelacionet të cilat e kanë – hedhur – në atë që është e atë që është bërë.

Më tutje zbulohet meskiniteti, shpirtvogëlsia, dhe njëanshmëria e të parit të jetës në këtë shoqëri. Por kjo sado që është e gjykueshme nga jashtë, në të vërtetë është vetëmbrojtje dhe mënyrë e jetës në një shoqëri e cila e dhuron lirinë, ndaj një tjetri. Është mekanizëm mbrojtës po aq sa edhe rrënjësim në të kaluarën e cila ka qenë e vetmja mënyrë mbijetese, apo nëse e shohim më me guxim, si mënyra klanore e kalimit nëpër kohë.

Sigurisht me këtë të gjithë tërhiqen në zhguallet e tyre dhe askush nuk di asgjë. Apo dikush edhe i di të gjitha. Megjithëse në gjuhë sociale (ta quajmë ashtu), të kapshme për të gjithë, të lexueshme për të gjithë, gjërat janë të ndara thjeshtë dhe të gjithë kanë pozicionin e tyre dhe në këtë strukturojnë shoqërinë me një Baba, ata megjithatë në tërë këtë kanë lirinë të jenë kundër dhe të akuzojnë njëri tjetrin. Por, kjo është politika e të dytit i cili gjithnjë hedh tutje dhe para përfaqësuesin dhe të parin e shoqërisë, dhe në anën tjetër krijon territorin e vet.

Gjë që në fund na sjellë edhe tek bërthama e kësaj shoqërie. Një njeri mbi të gjithë, dhe të gjithë me dhe pa dëshirë nën një njeri. Kjo pikërisht shpërfaqë regresin e shoqërisë në shtyllat në të cilat është ndërtuar historia e kësaj shoqërie. Vetë karizmatikun Mujë të përrallave e legjendave të historisë së kësaj shoqërie. Përpjekja e autorit për të bërë të vetëdijshme regresin e shoqërisë në vetë shtyllat e historisë së saj të legjendave është këtu përpjekje për të reflektuar kritikën ndaj një shoqërie e cila vuan, në paradoks, jetën si i/e dytë, dhe është i mbrojtur në po të njëjtën shoqëri me antagonizmin dhe po ashtu me qëniesimin e tij/saj.

Shpërfaqja e regresit në këtë roman është në një anë e pabesueshme, e pamundshme, e pakapshme, e që është dobësia e romanit duke qenë se nuk ndalet në krahasimin e fragmenteve të shoqërisë që e përmbajnë këtë fenomen. Ajo është e dhënë qysh në titullin e romanit e tutje, por në këtë ne përballemi me një reflektim i cili e sheh si të paikshme, vazhdimësi të paikshme këtë vendosje shoqërore në këto shtylla, derisa është e përballur me të pambizotërueshmen dhe aq më shumë të pambizotërueshmen e asaj që e ka krijuar.

Dhe në shtresën e fundit kemi rikthimin e shoqërisë, apo rrënimin e shoqërisë në atë që kishte ndërtuar për të parë se paprekshmëria dhe i dyti (Erich From) është po aq fajtor sa edhe ai që qëndron mbi majën e shoqërisë.

Duke iu kthyer edhe një herë fillimit të këtij teksti, gjuhës së ashtuquajtur sociale të cilën e përdor autori, është e pashmangshme kritika ndaj këtij romani për thjeshtësinë, qoftë si për afrim me legjendën e qoftë si kritikë ndaj shoqërisë, më e prekshme dhe më e kapshme për secilin. Përpjekja për të krijuar një rrënim të një shoqërie të ndërtuar në legjendën e saj, e që është asgjë tjetër përpos konstelacion i forcës fizike dhe klanore, dhe me këtë rikthimit të autorit në gjuhën e vetë gjuhës së shoqërisë, është një guxim tejet interesant dhe i ri në letërsinë tonë mirëpo ballafaqimi i të gjitha ideve dhe shtresave të këtij narracioni mbetet i padukshëm dhe aq më shumë i padiskutuar.

Lugati i këtij qarku të mbyllur të shoqërisë së Vdekja e Omerit në të vërtetë nuk është një njeri, një që mundet, është vetë problemi i lirisë. Lirisë për të ballafaquar. Lirisë për të dalë jashtë mallkimit. Lirisë për të dalë ballë njëri tjetrit në dinamikën e humanizmit. E kjo e vdes shoqërinë në një njeri, në një që mundet, derisa çdo i dytë në këtë mes krijon territorin e tij për të imituar, për të jetuar dhe për të arritur nën këtë dhurim të lirisë. Shtrohet pyetja nëse vetë liria kthehet si mallkim, liria e qëniesimit të pastër ndaj këtij dhurimit të lirisë. E mallkimi i lirisë në lugat i cili s'vdes.



"Vdekja nuk është asgjë. Thjesht sa kam kaluar në anën tjetër: zëre se jam fshehur në dhomën ngjitur. Unë jam i njëjti, gjithmonë, e ti je përherë ti. Ajo çka ishim për njëri tjetrin më parë, jemi akoma." - Kjo frazë mbi domethënien e vdekjes, i është atribuar gabimisht Shën Agostinit, por në realitet është një përshpirtje që teologu anglez Henri Skot Holand mbajti në katedralen e Shën Palit në Londër, pas vdekjes së mbretit Eduardi VII.

Të krijohet ideja e ekzistencës me dy dhoma të ndara nga një mur i hollë, ku mund të ndjehet çdo fjalë pëshpërimë, të dëgjohen ofshamat, të kuptohet kërcitja e hapave të zbatuar mbi dysheme. Sikur asgjë nuk ka marrë fund, e trishtimi nuk duhet të jetë dramë, për sa kohë në anën tjetër, në dhomën ngjitur, gjendet dikush që ende komunikon, që ende ndjen, që ende flet me ne.

Por për çerek shekulli, dhoma e të gjallëve, që duhet të komunikonte me poetin Genc Leka ishte e zbrazët. E sa përfytyrim i kobshëm duhet të jetë pritja e përjetësisë, i ftohti i përtej botës, atje ku duhet të ndjehej (të paktën pas vdekjes) një lloj lehtësimi, çlirim, rilidhjeje me botën dhe njerëzit. E në vend të gjithë kësaj, baltë mbi baltë, errësirë mbi errësirë, shurdhim mbi shurdhim, shpërfillje mbi shpërfillje, fillikat e përjetësisht brenda një dhome ku duhet të depërtonte zhurma e të gjallëve në dhomën ngjitur.

Gjithçka e lënë pas fundit të jetës, është fillimi i letërsisë: shënime, vargje, poezi me dhe pa titull, fragmente përkthimi, fragmente që donin ta lidhnin një jetë të gjymtuar, nën diktaturën e kobshme që kishte shënjuar si armik fatin e poetit Genc Leka. Trajtimi që i është bërë figurës së këtij poeti, jeta e të cilit u kryqëzua tragjikisht në diktaturë, vijon të synojë nxjerrjen në pah të shëmtisë së shoqërisë sonë. Më kot i atribuohet sistemit totalitar mëkati i madh, gjëra fatale. Ata njerëz që zgjoheshin në të njëjtën kohë, në të njëjtin vend me poetin, e dinin mirë që mund të përfitonin po të thoshin diçka kundër tij, po të kapnin qoftë edhe diçka e vogël që mund të servirej kundër djaloshit të mbetur pa baba. Në provinca, është mjaft e thjeshtë të bëhesh masë, e t'i kundërvihesh të dobbit, të shkelësh atë që është ndryshe, të shëmtosh jetën e dikujt që akoma s'e ka nisur një të tillë.

Në atë që është tabloja e jetës dikur, fare mirë mund të përfytyrojmë lëvizjet e vogla, të ngadalta, të këtij të riu që përpigje të mos binte në sy, të merrte frymë sic donin të tjerët të merrte, të qeshte kur donin ata, të mallëngjehej, të trishtohej e të kridhte vështrimin e humbur diku, sipas busullës së turmës. Sepse e tillë ishte koha dhe nevoja për ekzistencë. E megjithatë, përpara se akrepat e orës të ngrinin lëvizjen për jetën e Genc Lekës, ky i fundit e kishte pasur një jetë që i shëmbëllente iluzionit, e ndonjëherë mund ta bënte edhe të ndjehej ngrohtë dhe i dashur. Këtu, nuk mund të mos përmendet nevoja për të krijuar një diell të vogël, artificial, me dritën e zbehtë, të ftohtë, që mudohej të krijonte përshtypjen e një të riu të nënshtruar ndaj klimës së kohës dhe frymës zyrtare të regjimit. Gjithçka, një fasadë e pafuqishme, për t'u mimetizuar, për t'i shpëtuar përndjekjes, për t'u bërë heshtje në një vend ku gjykohej edhe kur flisje nën zë, me vete. Të tilla janë krijimet në "Zërin e rinisë" ato pak vjersha të botuara të cilat kontrollohen, vlerësohen si të padëmshme, gjykohen si të shëndetshme për sistemin, e dalin të shtypura në gazetë:

LUMES

1

Ja, këtu përpara shkollës sonë
Ne e ngritëm lart një lapidar,
Që të përkujtojmë gjithmonë,
Shokët, ty... dhe vrullin çlirimtar...

- Genc Leka në kohën e harresës -

FUNDI ËSHTË FILLIMI IM

Dr. Eris RUSI

E vetmja gjë që ka rëndësi në këtë vjershë, është emri i Gencit poshtë saj. E përfytyroni përballjen e Davidit me Golian, të njeriut me regjimin, e në rastin e Gencit njeriu ishte fillikat, pa Zotin në anën e tij, e regjimi ishte humnerë, hon i zi që përthitthe brenda çdo sinjal drite e mirësie. Në këto poezi ku Genci u rrek më kot të krijonte një realitet fiktiv, lexuesi duhet të përfytyrojë dhimbjen e rrallë: të shkruash për diçka që nuk e ndjen se duhet shkruar, të jetosh sipas ideve që nuk e ndjen se duhet jetuar; të qeshësh, të luash, të punosh, të pranosh, me vetëdijen se vetëm ashtu, një midis të tjerëve, mund t'i shpëtosh e të bëhesh hije e pakapshme për makinerinë e regjimit.

Titulli i kësaj poezie për mua sot duhet të tingëllojë: Unë jam askushi!

Një hiç, askush, ishin të gjithë njerëzit e zakonshëm që mbusheshin me frymë nën regjimin komunist, por që mund të zgjoheshin një ditë të zgjedhur nga fati e keq. E pastaj vinte fundi.

Megjithatë, këtë përpjekje, për t'i dhënë një dukje normale jetës, poeti Sadik Bejko e përshkruan kështu: "Me kalimin e viteve Genci mori hijen e njeriut që di të heqë dorë, që di ta pranohet domosdoshmërinë. Të jetë me një sy të hapur përbrenda vetes dhe me një sy të mbështetur fort te bota jashtë tij. {...} Nga ana tjetër, shkallë-shkallë ai u mësua të gjejë gëzime dhe kënaqësi të vogla dhe në punët e vështira që bënte."

A mësohet vallë njeriu me flatrat e prera të ëndrrave të tij? A hoqi dorë Ikariusi nga ëndrra e fluturimit, me gjithë pamundësinë për të lindur banor i qiejve që në fillim të ekzistencës? Dyshoj që Genci mund të kishte qoftë edhe një moment paqejeje, harresë e ngazëllimi në atë izolim. E vetmja që mund të shëmbëllente si shpresë, ishte harresa. Të harroje veten, njerëzit rreth teje, rrahjet e zemrës dhe trokitjen e kujtimeve. Pastaj të vishje maskën e të qeshurit, të përkushtuarit, të të mirit që mendon për të mirën e të tjerëve.

Ka një dramë të madhe në krijimtarinë

e Genc Lekës, ku rreket të ngjajë normal. Buzët e tua duan të thuash jo, e t'i rrekesh të bësh të kundërtën. Sepse e di që në atë jetë, edhe vetes duhet t'i flisje me frikë, e të ruaje shpinën edhe pasi mbylleshe me çelës brenda dhomës tënde.

Pikërisht këtu, brenda dhomës që Genci ende nuk e dinte në i takonte jetës së të gjallëve, apo botës së të vdekurve, ngjizen ëndrrat e tij, si flokë të lëshuar Gorgone, ku spikat së largu pikëllimi:

O hënë, pse dole, moj, aq e trishtuar,
Mos vallë për mua po mban zi?

.....

Ç'më fsheh ashtu me sy të lotuar,
Mos m'u sos jeta dhe unë nuk e di?
Po dhe në vdeksha, jeta s'ka mbaruar,
Dhe pse po shkruaj të fundmen poezi.

Këto nuk janë thjesht fjalë, por zgjatime të shpirtit që të lidhin e të mbajnë fort pas poezisë. Janë një grusht që të godet fort në bark e të heq frymën, të bën të shtrëngosh sytë, e të mos nxjerrësh dot lot. Ç'gjë e mrekullueshme jeta e njeriut: arrin të ndjehet atë që është e paimagjineshme, e të lërë trashëgim diçka që kthehet në eter, por është përjetësi: një imazh, një vegim që e shënjon jetën e kujtdo që ka mundësi të lexojë dhe të depërtojë brenda këtyre vargjeve.

Kjo është rruga më e mirë për të komunikuar me poetin Genc Leka. Të nisesh nga këto vargje, e ta kuptosh që përfytyrimi i të riut që mendon vdekjen, nuk është i veshur me terrin e errët të pashpresës.

Kështu më ngjan, që toka e PASHPRESËS nuk është trualli ku shkel Genc Leka i gjallë. Sa i afërt është ky njeri, me një tjetër krijues, të botës së lirë perëndimore, me shkrimtarin Ian Mek Evan, i cili në vitin 1994 do të shkruante romanin "Shpikësi i ëndrrave" e në një nga kapitujt do të përshkruante kështu:

Nëse jeta ishte një ëndërr, atëherë vdekja duhet të ishte momenti kur njeriu zgjohet.

Është aq e thjeshtë, sa kështu duhet të jetë medoemos. Njeriu vdes, ëndrra merr fund dhe vjen koha të zgjohet".

A s'është ky përfytyrim një simetri e çuditshme me vargjet: "Po dhe në vdeksha, jeta s'ka mbaruar?" Një lloj drithërime që kërkon të mbajë në jetë atë që është esenca e ëndrrës, përjetësia? Një pritje e gjatë, në dhomën ngjitur i veçuar nga bota e nga njerëzit, i ndarë nga jeta e nga të gjallët, në pritje, për të dëgjuar të feksi kjo dritëz e shpirtit të tij tridhjetë vjet më vonë. E këtu më vijnë ndër mend vargjet e poetit Sergej Esenin:

Butësisht i vlarë nga kujtime fëmijërie/
Ëndërrroj mjegullën, në një natë prilli!

Sepse Esenini është stepa e lirisë së Gencit, toka ku ai rend, ngrihet në ajër e bëhet qiell, dëshirë, liri. Poshtë, e ç'i duhet të shohë poshtë, atje ku gjithçka është e qetë dhe e zhytur në një kohë të palëvizshme, ku jeta dhe vdekja ngjajnë të jenë e njëjta gjë?

Me këtë frymë, Genci shkruan:

Horizont i largët, zogj në shtegëtim,
Erë, pika shiu, fletë pa mbarim...

Por a nuk është e mbledhur në këto vargje edhe fryma e Eseninit, rebelimi i poetit rus, që digjej së brendshmi me një dritë të çuditshme, që ishte vetë përjetësia, kur shkruante:

Shkretëtimë bore, era farfurin
Bora anembanë mbytur nën qefin
Dhe mëshkenat qajnë pyjeve pa jetë
Kush kështu ka vdekur, mos vallë unë vete?

Ka gjasë që Genci ta ketë lexuar këtë poezi, e të ketë gjetur në vargjet e saj kthinën ku mund të hiqte prej vetes pelerinën e shpirtit, ta varte diku, ku mund ta shihte veç shpirti i tij. Sepse përtej, në botën jashtë, ishim ne, njerëzit e thjeshtë e të përkushtuar, që donim të rrafshonim gjithçka, për hir të dëlirrit të kohës, që ishte ideologjia. Kështu, hap e mbyll sytë u rrafshua në themele shtëpia e fëmijërisë së poetit. A ka më keq se mos kesh një vend ku t'i fshehësh kujtimet e fëmijërisë? Atje ku kanë jetuar armiq, të arratisurit, kundërshtarët e regjimit, edhe gurët janë armiq, edhe balta është rrezik, edhe tjegullat janë kërcënim.

Dhe poeti shkruan, pa e ditur që poezia e tij do të lexohet nga nëpunësit e regjimit, fatlum që ata s'e kuptojnë dot deri në fund, fatkeq që prapësepër e pushkatojnë në fund:

Kur në dritare rri me mall
Me lulet e saksisë,
Më shfaqen si vegim, përballë,
Gërmadhat e shtëpisë.

Pastaj më ngjan sikur bën zë
E ndrojtur fëminia,
Që fle mes gurësh përgjithnjë,
Mes ëndrrave të mia.

Lexojini këto vargje, dhe mbushuni me frymë. Mendoni për gjërat dhe njerëzit që keni humbur, për kohën që nuk vjen më, për jetën, që është çast, e pastaj përjetësi. Ndjesia e harresës, e kohës që bëhet muzg, e vdekjes që merr gjithçka. Ç'aurolë poezi i vsh poezia këtij përfytyrimi.

E humbëm Genc Lekën të dashur miq. Një poet kaq i freskët, kaq i vërtetë. Dhe në ç'mënyrë tragjike e humbëm. U largua i vlarë. E rrëzuan nga jeta, e u përmbys pa asnjë klithmë mërie, pa asnjë shenjë revolte.


E megjithatë, e kemi sërish Genc Lekën, të dashur miq. Një poet kaq i freskët, kaq i vërtetë. I ringritur nga vdekja. Na fton për lexim!



Ka qenë një ide e bukur e Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale për të përkujtuar Spiro Dinen në 100-vjetorin e ndarjes nga jeta (Korçë, 1922) me një botim anastatik të përmbledhjes folklorike të tij “Valët e Detit”. Siç është bërë e njohur, libri ka dalë nga shtypi kohët e fundit (për fat të keq lë mjaft për të dëshiruar nga ana teknike). Ky ribotim i detyrohet kujdesit të studiuesit Niko Kotherja, hulumtues si zellshëm i traditave kulturore e kombëtare të qarkut të Korçës e më gjerë dhe drejtor i Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale. Ai ka shkruar edhe studimin hyrës “Rreth figurës së patriotit dhe folkloristit Spiro Dine”, që përmban të dhëna dhe shqyrtime historike-kulturore me shumë interes për kohën kur jetoi autori i librit dhe për vetë librin (studimi meriton të botohet edhe në një revistë shkencore). Libri “Valët e Detit” është shkruar dhe shtypur me alfabetin e Shoqërisë së Stambollit, e njohur ndryshe edhe si Shoqëria e Shkronjzave (1879). Në këtë vështrim ai ka vlerë më fort për studiuesit, që duan ta njohin e ta shfrytëzojnë lëndën folklorike të tij në botimin e parë original.

Nga 856 faqet që ka libri “Valët e Detit” 186 faqe janë një përmbledhje vjershash të vetë Spiro Dines dhe të disa autorëve të tjerë bashkëkohës, si Koto Hoxhi, Thimi Krej, Loni Logori, Kristo Floqi, Eftim Brandi, Jani Vreto, L. G. Naçi dhe një përkthim i K. Kristoforidhit. Janë përgjithësisht vjersha të thjeshta, pa ndonjë vlerë të spikatur letrare, që meritojnë të botohen edhe më vete si antologji e poezisë së Rilindjes (të ashtuquajturit poetë minorë). Vetë S. Dinia rrëfëhet se dëshira për të shkruar vjersha edhe ai iu ngjall pasi lexoi “Istorinë e Skënderbeut” të Naim Frashërit, që e mahniti dhe e preku thellë në shpirt, por nuk e njeh veten për vjershëtor (“nga vjershëtorët jam larg sa qielli me dhenë” – shih Parathënien). Tematika e vjershave të S. Dines dhe të tjerëve është kryesisht dashuria për atdheun e për gjuhën shqipe, brenga për gjendjen e mjeruar të Shqipërisë, nderimi e vlerësimi i atyre që kanë punuar e punojnë për atdheun e vet, dënimi i ashpër për ata që bëhen vegla të propagandave dhe politikave të huaja armiqësore, harmonia ndërmjet shqiptarëve të besimeve të ndryshme: *Gjithë Shqipëtarë jemi, / Sido s’jemi më një besë, / Po një atë e mëmë kemi, / Për mirësi të mëmëdhesë*. Te parathënia e librit “Valët e Detit” S. Dinia tregon bukur, thjeshtë e me çiltërsi për jetën tij, për rrethanat kur mësoi të shkruajë shqip në shkollë me abetaren e Naum Veqilharxhit, kur hyri në lëvizjen kombëtare dhe si nisi të mbledhë me zell e me dashuri visaret folklorike që kishin sjellë me vete dhe i mbanin të gjalla shqiptarët në Egjipt. Kjo parathënie ka vlera të shumanshme atdhetare, historike, diturore etj., prandaj po e sjellim të plotë më poshtë për lexuesin e sotshëm, se lexohet me ëndje dhe me një frymë.

Lënda folklorike e librit “Valët e Detit”



Me rastin e ribotimit të librit “Valët e Detit” të Spiro Dines

“VALËT E DETIT” – NJË PËRMENDORE E FOLKLORIT SHQIPTAR

Nga Emil Lafa

është ribotuar më 1962 me alfabetin e sotshëm të vëllimi i tretë i serisë “Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar” nga Instituti i atëhershëm i Folklorit. Përkujtimi i Spiro Dines në 100-vjetorin e ndarjes nga jeta le të jetë edhe një shtysë për një botim të ri e të përkujdesur mirë të “Valëve të Detit” me alfabetin e sotshëm (pas dy vjetësh vjen dhe 180-vjetori i lindjes së tij).

PARATHENJE NGA SPIRO DINE

Që të dalë njeriu në dritë e të duket në botë, lîpset mënt e dituri, jo si unë që nuk di se nga ziretë kalemî.

Po dhëmbja e shkretë edhe dëshira e madhe për mëmëdhenë që ma ka ndërë zëmra që kur qeshë djalë 3-10 vjeçë, kur mësova nde prifti Panajoti në fshat tim Vithkuq, që ahëre pra më kish hipur kjo idhe, dhe gjithënjë ëndërrinja për këtë, edhe thoshnja që nga zëmra: Ah! sikur të kishim dhe neve shqipëtarët të shkruanim e të këndonim më gjuhën e vet! – Po kur thoshën: «Ç’kërkon njeriu ja dhënka perëndija», kështu pra më ngjau dhe mua, se, kur erdha këtu në Misir (Egjiptë) më 1866, djalë pothua 20-21 vjeç, dëgjova këtu se Thimi Mitkua është shqipëtar, shqipëtar them se vetëm ky përpiquej për të shkruar gjuhën e vet. Kështu pra m’u shtua shpresa dhe zëmra ime m’u bë sa një mal. Kur u poqa herën e parë në Han Alil, ku kish shkresëtoren, më priti si mëmëdhetar i vërtetë edhe e para fjalë që më pyeti më tha në di ndonjë këngë a përrallë të vjetërë. Po mua kjo m’u duk, si çudi dhe vura buzën më të qeshur, po më së fundi ma mbushi mëndjen duke thënë për Kamardën, prift Arhimandrit, filllolog i math shqipëtar nga Livorna e Italisë, dhe Panajoti Kupitori nga Idhra e Greqisë, edhe shumë e shumë të tjerë filllologë të mbëdhenj evropianë, të cilët thonë që në këngët dhe në përrallat e vjetëra të popullit, ruhen zakonet, gjuha dhe historia e vet. Kështu pra, këngët tona, sikundër shikonjëm, janë shumë të nevojshme e të vjejtura për kombin tonë, se

ndër këto shikonjëm të ngjarat e çdo kohe, që ka shkuar si valët e detit dhe prej këtyreve munt të dalë një histori e plotë.

Kjo, pra, më dha shkak edhe mua të mbleth jo vetëm këngët popullore, po edhe çdo farë gjë të vlyer e të pavlyer dhe të ja u përmënt atyre q’i kanë dëgjuar dhe i kanë haruar, edhe t’i mësonjën ata që nuk i dinë, po më tepër për ata që do vinjën pas, duhet t’ja u bënëjmë të njojtura punët e prindërve, se pa mos mbedhur dhe shkruar, humbasën edhe vdiën sikundër janë humbur edhe vdiër gjer më sot.

Kështu pra mora kalemnë dhe kudo që gjenja shqipëtar, do t’i ngarkohesha dhe do t’i lutesha të më thosh sa që dinte.

Por edhe për fat të mirë atë kohë, ndodheshin dhe shqipëtarë shumë n’Egjipt, nga do të shkonje do të piqnje shqipëtarë. Karakollët e Kairos qenë plotë gegë e toskë. Këngët e vallet nukë reshtnin; bozuku, tamburaja e bakllamaja buçisnin më të katër anët, na dukej sikur gjëndeshim në Shqipëri; tregu i armëve (çoksillah) përveç shqipëtarëve tjetër nukë kish, më të shumëgëgë myslimanë e të krishterë mirëditas; prandaj gjeta kohë të mbleth nga të dy anët (dialekte) prej gegëve dhe prej toskëve. Kështu, duke mbledhur dhe duke dhënë Mitkos, të cilat ky i shtypi në “Mbletën”, po më të shumat mbetnë për “Mbletën e vogël”, e cila është gati për të shtypur, po nuk arriu i mjeri; por mbesonj që djemtë e tij nukë do ta lënë pa shtypur, po shpejt do ta qitin në dritë.

Pasandaj, sa që mblodha i mbajta, më nuk ja dhashë Mitkos. Pas kohe më ra në dorë dhe Istoria e Skënderbegut, të cilën, as e dinja, as e kisha dëgjuar fare. Kur e këndova mbeta shumë i mahnitur, dhe munt të them që kush prej shqipëtarëve s’ka kënduar historinë e Gjerq Kastriotit (Skënderbeut), nuk munt të bënet mëmëdhetar i vërtetë, se këtu do të shohë e do të çuditet e do të mahnitet me mëndjen e me trimëritë që kanë rrëfyerë shtërgjyshërit tanë, dhe kështu ka me lavdëruar zonë që u lint shqipëtar, dhe kur të sjellim këtë emër ta kemi për lëndatë, e jo si ca quravecë dhe të humburë që humbasin në lëkurën e tyre, edhe e kanë për turp të quhen ç’janë, po fshihen si



miza nënë bishtin e kalit! Duke kënduarë pra këtë histori, dhe duke qarë dhe duke derdhur lot, psherëtinja dhe thoshnja: “Ah! E varfëra Shqipëri! O vatra e trimërisë; ku paske qënë dhe ku gjëndesh sot!”


Që ahëre pra, o vëllezër, m’u mbush shpirti me mallëngjim dhe që ahëre zura, i shkreti, të shkruanj hidhërimet e zëmërës, jo si vjershëtor, se nga vjershëtorët jam lark sa qielli me dhenë, po shkrojta psherëtimet që më delnin nga zëmra, dhe më çdo kohë që kam shkruar, kam shënuar vitin edhe vëndin; në ato kohë, siç dihet, s’kishim shkronjat tona, po shkruanim me të botës, ashtu si dinte gjithkush. Kur pra dolli Abetari ynë shqip në Stamboll prej shoqërisë shqiptare më 1879, — dhe më pastaj në Bukuresht, që ahëre zunë shqipëtarët të shkruajnë gjuhën e vet, e cila në pakë kohë u përhap më të katër anët e Shqipërisë edhe gjetkë, dhe që ahëre çdo shqipëtar shkruan e këndon shqip, përveç ca të humbur që janë edhe në gjumë e nukë hapin dot sytë. Oh! Sa qënka e nevojshme gjuha e vet nde njeriu! Kjo pra, në pak kohë, bëri shqipëtarët të njihen njeri me tjetrin; kjo them për pakë kohë ç’faqë mëmëdhetarët dhe vjershëtorët e flaktë që u rrjedhin vjershat si ari i kulluar, dhe të tjera e të tjera.

Unë pra që të nderonj këtë libër, shumë herë shkruanja dhe lutesha të më bënin gjithkush nga një vjershë, dhe ata që patnë nderë e më dërguan jau di për të mirë, dhe gjithkujt i kam shënuar emërin në vjershën e bërësit, po nga këto 5-6 vjersha me emërin Th. K. më kushtonjën plot 15,379 franga e 60 q. !...

Pas këtyre më ra nder mënt të mbleth të thënat, fjalë të vjetëra të popullit, si dhe ca lodra e zakone etj., siç duken në libër. Më së fundi bëra dhe ca mëndjake me sa që ma preu mëndja, pas këtyre mblodha dhe emërat që kanë dhe përdorur dhe përdornin gjer më sot populli shqipëtar. Si pashë që u mblodhë dhe u bënë shumë, vura ndër mënt t’i shtyp e t’i qit në dritë, po, kur mejtonja turpin që një si unë qysh munt të dalë përpara të diturve, u hoqa dhe i plasa më njanë edhe kurrë do mos e shikonin dritën, po, pas kohe më kupëtuan ca mëmëdhetarë të vërtetë, vjershëtorë me mënt, këta zotërinj, them, më ngutnë që ta shtyp dhe të mos kem turp fare, se kjo libër, më thanë, është popullore edhe e vyershime, në mos po t’ja u jap ta shtypin ata vetë.

Unë pra, me gjithë këtë kurajo, përsëri nukë më mbushej mëndja, po më së fundi mejtova edhe një tjetër gjë, thashë me mënt e mija: “Unë këtu nukë shkruanj as historinë Piros, as të Lekës së Math, as trimëritë e Babës tonë Gjerq Kastriotit (Skënderbegut), po shkruanj këngët edhe zakonet e popullit tonë, që munt t’i shkruanjë gjithëkush. Kjo pra më dha kurajo shumë dhe më nguti që ta shtyp e ta qit në dritë, pra, po në bëra mirë a liksht, Ie ta gjykonjën ata që dinë; unë kaqë munda, kaqë bëra; sa për gjuhën që është një ujëm, u lutem këndonjëset, të mos vënë re, po të shikonjën vetëm qëllimin e zëmërës se ku qëllon. Kështu pra them që do më ndjenjën të metat.

Librën e quajta «Valët e Detit», duke kujtuar popullin tonë që ka shkuar jetën e ti valë-valë, kështu pra, duke dhënë funt kësaj libër, i lutem Zotit t’i falnjë kombit shqipëtar dëshirën e shtërgjyshërvet tanë për mëmëdhenë e varfër që të harinjëm edhe ne si gjithë kombet e qytetëruar.



Elbasani i viteve pesëdhjetë të shekullit që lamë pas, si e gjithë Shqipëria, ishte i përfshirë në entuziazmin e komunizmit eksperimental për shoqërimin e gjithë jetës materiale dhe shpirtërore. E shkuara e këtij qyteti të bukur dhe të butë, qytetit të luleve, ballokumeve, këngëve dhe arsimit dukej se po gremisej në harresë, shoqëruar nën tingujt e këngëve të usta Isuf Myzyrit.

*Një lulishtë me trandafila
Asht parajsja e vërtet
Ky asht vend q'i kndojn bylbylat
Flak ç'mu dogj ashiku i shkret*

Dhe ndërsa Usta Isufi po ikte nga kjo jetë duke lënë pas lirizmin e tij të strukturuar në shpirtrat e elbasanasve, një fëmijë çapiste në skenat e shfaqjeve publike, me kitarën po aq sa shtati i tij. Ky djalosh ishte Alfons Balliçi. Zoti di ç'bën. Qytetin e kishte bekuar me një muzikant të ri.

Është e vërtetë që edukimin muzikor e mori nga i ati, instrumentist i kitarës, por, siç do të shprehej kompozitori Aleksander Lalo, "(Alfonsi) kishte lindur me fat të madh për muzikë, sepse kishte një vesh të jashtëzakonshëm, që më vonë për ne kolegët do bëhej proverbial e do t'i thureshin legjenda edhe nga ato që mund të duken si të pabesueshme." Instrumenti i të atit filloi të shndërrohej në lodra e këtij fëmije ëndërrimtar, të cilën e përdorte më shumë kur i ati nuk ndodhej në shtëpi.

-Mos e prek, - e qortonte e ëma sa herë e shihte me kitarën e stërmadhe për trupin e tij. - Mos e prek se me atë hamë bukë. Do t'kpus kokën yt atë po të pa që ia lun kitarën.

Kjo trysni e bënte më kurioz për këtë kuti që lëshonte tinguj magjik kur i prekje telat e tendosur. Dhe "hataja" ndodhi një mbasdite kur ishte zhytur i tëri në harmoninë e tingujve, ndërsa përkëdhelte telat e kitarës së vendosur mbi kofshët e voçkëla. Dera e dhomës ishte hapur dhe në të u shfaq babai. Levizi vrullshëm duke larguar me forcë kitarën që u rrokullis në dysheme. U struk i tromaksur në qoshkun më të afërt. Që përtej dhomës dëgjohej ofshama e së emës me theksin peqinas.

-T'kam thënë mos e prek, sa herë t'kam thënë?

Babai, një elbasanas tipik në qetësinë e vet, mori kitarën, u ul në minderin ku luante i biri dhe i tha.

-Ulu këtu- duke vënë pëllëmbën e dorës mbi minder, në të djathtë të tij. U afrua ngadalë, ende duke besuar se ajo pëllëmbë do t'i fluturonte mbi. U rehatua pasi pëllëmba i shpupurisi flokët, ndjehej mirë pranë babait që ai njihte.

Dita e parë që filloi të merrte mësim në kitarë nga i ati. Ishte vetëm katër vjeç.

Ai mprovizonte dhe tingujt e harmonishëm i fluturonin nga pentagrami i telave të kitarës dhe më pak nga ai i notave mbi pentagramin letër. Thuhet se fati e përkëdheli herët, duke e ngjitur në skenë ende fëmijë. Por shumë mendojnë se fati e gjeti atë, ai ishte virtuoz. E zhvilloi perfeksionin në kitarë duke punuar orë e orë çdo ditë, ndërsa nuk e grishnin aspak lodrat dhe aventurat e bashkëmohatave.

Adoleshenca e gjeti të rritur, si instrumentist. Si i tillë do të shfaqej në formacionet muzikore të qytetit duke tërhequr admirimin e bashkëqytetarëve. Ne hotel Turizmin (e vjetër) do të jetë pjesë e orkestrës, megjithëse pesëmbëdhjetëvjeçar dhe kitarë e tij do joste sa e sa dëfrimtarë në këngë e vallëzime. Dhe ndërsa rritej duke u përkëdhelur nga ky admirim i pakursyer, djaloshi simpatik, fytyrëmbullakët dhe i qeshur bëhej akoma më interesant e tërheqës edhe për vajzat. Ai ishte i sjellshëm dhe elegant. Por vendi që i rezervonte fama dhe vituoziteti i shtuan njëllëj "aristokracie" sjelljeve të tij. Në këtë kohë ndodhi të njihej me një tjetër bashkëmohatar dhe virtuoz të

Alfons Balliçi, përtej rrugëtimit të usta Isuf Myzyrit

Nga Fatmir Manushi



muzikës, Ferdinand Deda. Festa e Shelgut, buzë lumit Shkumbin, pranë Cërrikut, bëhej çdo vit në përkujtim të një batalioni të luftës antifashiste. Ajo merrte përmasa të mëdha nga propaganda e kohës dhe mbledheshin aty shumë banor të zonës, Cërrikut, Elbasanit e Peqinit. Ansamblet e tyre derdhnin talentet duke e shndërruar festën e Shelgut në një ditë vërtet të gëzueshme. Alfonsi vinte me trupën e Elbasanit ndërsa Ferdinandin me atë të Peqinit. Të gjithë gëzonin dhe harbonin për qejfin e tyre dhe askujt nuk u shkante mendja se pikërisht aty takoheshin sëpari dy nga më virtuozët e muzikës moderne Shqiptare. Rrugëtimi i tyre muzikor do t'i shoqëronte për gjithë jetën, si vëllezër siamez. Me gjithë telashet që diktatura derdhte mbi ta, do t'i gjendeshin njëri tjetrit. "Ai ishte nxënës në Liceun Artistik atëherë - shprehej Alfonsi në një intervistë - dhe vinte kastile në Elbasan për të punuar me mua. Bëmë një grup shumë simpatik. Njohja me Ferdinandin ndikoi në zhvillimin tim të mëtejshëm muzikor, sepse Ferdinandin jo vetëm që ishte shumë i talentuar, por vinte nga Tirana, përfaqësonte diçka tjetër. Dhe Tirana ishte ëndërr, në atë kohë, për gjithë artistët e rrethëve. Këtu pata një hop cilësor. Mund të them se ne mësonim nga njëri tjetri. Ai

luante në fizarmonikë solo, unë e shoqëroja në kitarë. Me Ferdinandin haheshim si macja me miun se cili do të gjente notën. Ferdi më angazhoi edhe më shumë dhe truri im, edhe pse i ri, nisi të ekspozohej përpara një bote muzikore gjithnjë e më të pasur". Shkollimin e mesëm e kreu në një nga gjimnazet e Elbasanit dhe muzika vijonte t'i buronte përmes virtuositetit. Miqtë muzikantë do të befasoneshin nga improvizimet e tij të pa precedent për kohën. A.Lalo do të shprehej se "Alfonsin e bëri muzikant pasioni më tepër se kultivimi, ishte tepër subjektiv... shpesh një pikë referimi për ne".

Në këtë atmosferë suksesesh dhe adhurimi, veçanërisht nga të rinjtë, ai do të garonte në Institutin e Lartë të Arteve. Vinte nga gjimnazi dhe jo nga shkollë muzikore. Aq më tepër në moshë më të madhe nga bashkëkonkurrentët, pasi sapo kishte kryer dhe shërbimin ushtarak. E kishin shtyrë në këtë "aventurë" miqtë e tij muzikant e veçanërisht shoku i tij Ferdinand Deda, i cili, pas një edukimi të mirëfilltë muzikor ishte bërë, brenda një kohe të shkurtër, personalitet i rëndësishëm i muzikës në Shqipëri. Me virtuositetin dhe perfeksionin në evidentimin e tingullit iu qep solfezhit për ta zotëruar më së miri. Por e ndiente boshllëkun e madh në teorinë e

harmonisë. Ai ishte virtuoz që ende nuk dinte të shpjegonte harmoninë e dalë nga interpretimi i tij. Në qendër të panelit që do ta vlerësonte ndodhej i adhureshmi Çesk Zadeja, pedagogët e tjerë nuk i njihte. Dhe, normalisht, ndodhi ajo që pritej. E pyetën mbi diçka që lidhej me teorinë e muzikës. Mbeti si dru, i turpëruar.

-Ky nuk është liceist,- ndërhyri dikush nga juria, -ktheje me shpinë nga pianoja dhe e pyesim për tingullin.

Dikush filloj t'i binte pianos me një notë dhe Alfonsi gjente lehtësisht notën përkatëse, pastaj me dy e tre nota.

-O po bjeri me bërryl pianos, - ndërhyri përsëri nga juria. Alfonsi, i gjendur në habitatin e vet befasonte panelin me evidentimin e pagabueshëm të notave.

-Këta janë talente, për këta kemi nevojë, -vlerësoi i kënaqur Profesor Zadeja

Jeta në Tiranë ishte jo më pak e magjishme. Studenti i afirmuar si muzikant që e kalonte kohën e lirë duke luajtur në orkestrat rinore më të mira të kryeqytetit. Ishte padyshim kitaristi më i kërkuar. Kur hynte në sallë pritej me ovacione si një mjeshtër i vërtet. "Në qytetin Studenti, - kujton kompozitori Gazmend Mullhaj - ishte i magjishëm. Në atë kohë ishte e vështirë të gjeje dhe tela kitarë, por Fonsi



me katër pesë tela i trazonte studentët, duke i kthyer takimet në festa të vërteta. Loja në kitarë kishte karakter improvizues, shpirt dhe muzikalitet të lart, të magjishëm, nuk përsëriste vetveten. "Suksesi dhe gjendja e mirë ekonomike që buronte nga koncertet i lejonin të shijonte moshën, me aq sa lëshonte litarin diktatura. Ishin vitet gjashtëdhjetë. Vite kur botohej Heminguej, vite kur në mbrëmjet rinore të vallëzimit ndodhte të kërcehej charlestoni, vite kur kishte hapur siparin festivali I i këngës (në imitim të Sanremos), vite kur dëgjoheshin Bitëllsat dhe Hitparade, vite kur një rrugë në Tiranë rinia e thërriste Broadway, vite kur djaloshi Kadare niste rrugëtimin metaforik të kryeveprave në letërsi, ishin vitet e bohemeve të parë, kur ndër intelektualët qarkullonte më tepër art ndër biseda e takime sesa në vitrinat zyrtare të jetës së tyre. Pjesë e kësaj bote ishte dhe Alfonsi, si pikë referimi për artistët dhe muzikantët, ku bashkë me muzikën përzihej dhe alkooli, apo fërneta, në modë të asaj kohe. Ne periudhën si student i Institutit të Lartë të Arteve ai e kishte pushtuar rininë e Tiranës dhe më tej. Ishte mjeshtër i paimitueshëm i kitarës. Ky instrument gjallohej nën gishtërinjtë e mjeshtrit, duke u shndëruar në një kuti magjike. Repertori shqiptar ishte mjaft i kufizuar për kitarën. Ai do të interpretonte këngë dhe pjesë instrumentale latine, të cilat sot nderojnë fondin e Radio Televizionit Shqiptar. Në librin "Broadway i Tiranës" Bedri Alimehmeti do të shkruante: "Sa shumë vallezohej e këndohej në Tiranë në ato vite! Kishte shumë lokale me orkestra të mira. Vvetëm për t'i dëgjuar shkëputeshim nga Broadway dhe kënaqeshim të mrekulluar nga magjia e tingujve. Mbi të gjitha pëlqeheshin orkestra e "Vollgës" ("Drini" i sotëm) ku spikatnin dy vëllezërit Shkoza dhe sidomos kitaristi i njohur Mehdi Prodan, i vëllai i kompozitorit të famshëm Agim Prodanit, bashkë me saksofonistin e njohur Sazanin. Herë pas here në këtë orkestër luante edhe një kitarist i ri, të cilin ne e pëlqenim të gjithë dhe në më të shumtën e rasteve enkas për të e linim Broadway-in. Që vërtet virtuoz dhe premtonte shumë në të ardhmen, ç'ka u vërtetua në vitet e mëvonshme. Besoj se ata që i kanë jetuar ato kohë me siguri, që do të jenë kujtuar, behet fjalë për të mirënjohurin Alfons Ballici, kompozitor e instrumentist. Te "Vollga" këndonin çdo natë. Vërtet ishte kënaqësi për ne, por në fakt me shume entuziazmoheshim nga ndonjë detaj virtuozi të kitarës, që kryente mjeshtërisht Alfons Ballici. Ky mjeshtër i kitarës, vite më vonë, në festivalin e njëmbëdhjetë të këngës, do të na kushtonte ne djemve të Broadway-it këngën "Rruga e Dibrës" kënduar nga i madhi Sherif Merdani, që e pagoi keq pas festivalit. Madje, edhe Alfons Ballici nuk shpëtoi pa e lagur nga katrahura e plenumit të katërt (te zi) të KQPPSH. Megjithatë, të dy artistët e mëdhenj, në atë kohë, për krijimin e tyre të bukur, patën marrë mirënjohjen vëllazërore të gjithë bashkëmoshatarëve të tyre tiranas, që gjallonin "Rrugën e Dibrës", të cilës i kishin kushtuar atë këngë të bukur."

Në këto vite fillon dhe krijimtaria e pjesëve muzikore për kitarë, gjithashtu dhe këngëve ku kitara do të kishte vendin qendror. Do të mahniste publikun, kolegët dhe pedagogët me interpretimin në kitarë të Sabre Danc nga Aram Khaçaturjan. Dhe jo më kot do tërhiqej si solist kitarist i orkestrës së festivalit në RTVSH. Shkollimi muzikor në Institutin e Lartë të Arteve e kishte shndërruar djaloshin bohem, ëndërrimtar dhe të përkëdhelur në një muzikant të kultivuar, krijues dhe instrumentist të admiruar. Duke zotëruar harmoninë, ritmin, instrumentin dhe kompozimin natyrshëm filloi ta tërhiqte tradita, muzika popullore qytetare e Elbasanit, Edhe këtu ishte me fat. E ku do të gjente një model



më të mirë se krijimtaria e Isuf Myzyrit, këngët e të cilit ishin përhapur në arteriet mbarë vendorë të interpretimit. Kështu, diplomën në IL Arteve e mbrojti me temë: "Disa karakteristika të përgjithshme të këngës popullore qytetare elbasanase dhe krijimtaria e Isuf Myzyrit (1881-1956), kompozitor, vjershëtor dhe këngëtar popullor".

Një paradite qershori, kur vapa ende nuk e kishte përpërë kryeqytetin, një pajton ndaloi përpara sheshit të bukur të Institutit të Lartë të Arteve. Nga aty zbritën dy djem, dukej, të vetëkënaqur. Alfons Ballici, i shoqëruar nga shoku i fëmijërisë Xhevdet Dervishi, shkante të mbronte diplomën. Datonte viti 1967.

Pas diplomimit u caktua në Elbasan të drejtonte orkestrën e estradës "Skampa", të qytetit. Një ëndërr. Ja pra, ia kishte arritur. E ndjente se jeta muzikore e qytetit ishte e tija. Bashkëqytetarët sikur ja kërkonin këtë. Një vit më pas drejtoi orkestrën simfonike

dhe atë frymore duke bërë të vlerësoheshin maksimalisht nga kritika muzikore e kohës, shoqëruar me çmime përkatëse.

Pas diplomimit, me formimin muzikor dhe përvojën e instrumentistit, ambicia e tij ishte kompozimi. Vazhdoi të merrte rregullisht, për tre vjet radhazi, mësim për kompozim nga Mjeshtri Çesk Zadeja. Ky ecejak ndërmjet Elbasanit dhe Tiranës mbante gjallë jo vetëm marrëdhënien me kolegët e muzikës në Tiranë, ku dhe ishte përqendruar e gjithë elita artistike e vendit, por gjithashtu i mbante gjallë atë shpirt lirizmi gati gati bohemian. Rikthimet në Tiranë i përngjanin arratisjeve artistike. Me Ferdinand Dedjan, Lalon e të tjerë, pasi të ishin "lodhur" me grindjet mbi harmoninë e ritmin, për Elvis Preslin dhe grupet e tjera muzikore, do të bënin mbylljen e mbrëmjes duke lënë pas një tavolinë të mbushur me gota e shishe të zbrazura. "Ishim euforik, atëherë" do t'i thoshte pas dyzet vitesh, gazetares Alma Mile. Njëherësh me punën e përditshme në drejtimin e orkestrës së estradës në "Skampa", përpjekjeve për ngritjen e orkestrës simfonike të qytetit dhe ndjekjes së mësimave për kompozim, do të ishte pjesëmarrës si kitarist në grupin e orkestrës të Festivaleve në RTSH, që drejtohej nga Agim Krajka. Dhe në vitin '69 fillon rrugëtimin si kompozitor në këtë festival me këngën "Në ekskursion", mjaft rinore kjo për nga melodia dhe ritmi. Natyrisht, i mirëpritur nga kolegët ai dukej sikur po u "shkelte syrin" fansave që deri më parë e adhuronin si kitaristin e tyre. Një vit më pas do të ndërhynte me këmbëngulje për të rikthyer në festival këngëtarin e ri Bashkim Alibali, të larguar nga pjesëmarrja për interpretim ekstravagant, duke i besuar këngën e tij. "U ngazëlleva, - kujton Alibali - ishte një moment i veçantë. E kalova me sukses. Nuk ishte e lehtë të merrje pjesë në një festival të tillë në atë kohë. Kishte



shumë kërkesa nga ana profesionale. "Ky veprim i Alfonsit dëshmonte jo thjesht dashamirësinë, dukuri kjo më se e zakonshme e përditshmërisë së tij, por veçanërisht autoritetin dhe personalitetin që ai kishte brenda festivalit. Ne festivalin e radhës, për të njëmbëdhjetin bëhet fjalë, do të guxonte fort. Së pari solli në festival orkestracionin e tij. Një formacion vetëm me tri kitara, me tre djem gjimnazistë të qytetit të tij, Elbasanit, Fatjon Penin, Emil Prodanin dhe Dragan Hoxhën. Gjithashtu solli në festival "Broadway-in e Tiranës" përmes këngës Rruga e Dibrës, të kënduar nga Sherif Merdani, i cilësuar në atë kohë si këngëtar modern dhe më premtues i kohës. E kush kishte guxuar më shumë në muzikën e lehtë deri atëherë? Rinia, veçmas ajo e kryeqytetit gjeti mëshirimin e vet në këngën Rruga e Dibrës.

Kënga fillon me një fishkëllimë melodioze, dhe më tej, me po atë zhvillim melodioz:

*Ky është sinjali që mbledh shokët tanë
Atje tek Rruga e Dibrës në Tiranë*

Më pas këngën e ezauron ritmi rinor, i thjeshtë, i vrullshëm, i pa shkëputur nga melodia që i jep trupit të këngës harmoni të admirueshme.

*E mira rruga jonë e thjeshtë
Ç' do mbrëmje dalim andej
Dhe ajo pret e qeshur, mbi dhemi ne*

Ai ishte njëri prej djemve të Broadway-it të Tiranës. Tani nuk u kishte shkelur syrin fansave, u kishte dhuruar dhe himnin, kishte institucionalizuar lirinë dhe lirizmin e tyre në "kongresin e muzikës së lehtë" do ta quaja, sikundër ishte Festivali I këngës në RTSH. Ishte në qiellin e shtatë dhe i adhuroar nga të gjithë. Festivali u komentua nga mediat dhe kritika artistike si sukses, veçanërisht për risit në promovimin e këngëve rinore dhe pjesëmarrjen e këngëtarëve të rinj. Festivali kishte kaluar pa probleme serjoze filtrat e vlerësimit ideo-artistik të politikës zyrtare.

Për çfarë ndodhi më pas e përfshiu në konfuzion total. Filluan ca kritikëza, gjoja dashamirëse. Pritej qëndrimi zyrtar i KQ të PPSH. Dhe erdhi si një pranverë socialiste. Me kumtin e Partisë në pushtet, me luftën kundër ideologjisë borgjezo-revizioniste që përpiqej të helmonte rininë të artin tonë socialist e të tjera e të tjera... Filluan ta gjykonin se e kishte tepruar me atë këngë, por me naivitet nuk po e kuptonte në kishin vërtet seriozisht. Goditja e madhe i erdhi kur u arrestua dhe u burgos këngëtar Sherif Merdani. Tani pse jo, radhën e kishte edhe ai, krijuesi i këngës të cilën me aq pasion e këndoj këngëtar, tashmë pas hekurave të burgut. U topit i tëri. I iku ajo buzëqeshje që zbkuronte fytyrën e rrumbullakët. Ashtu i ndjeshëm, siç ishte, e trondiste ndryshimi i sjelljes së administratës dhe herë herë edhe koleg që aty më parë i kërkonin shoqërinë dhe opinionet. Mbrëmja, me pagjumësinë, e lodhte tmerrësisht. Çdo zhurmë makine pran shtëpisë i dukej sikur vinte gazi i degës së punëve të brendshme për ta marë. Kishte dëgjuar plotë historira dhe i ishte bërë obsesion. Por jo, nuk përfundoj në burg. Politika zyrtare kishte, edhe ajo, zgjuarsinë brenda diabolizmit të saj. E la jashtë burgut, me frikën e përjetshme, duke i kujtuar se e kishte falur njëherë. Tani do të paguante haraçin. E ndaluan për një periudhë tre vjeçare të merrej me kompozim. Duket absurd për lexuesin e ri. Por ka ndodhur. U mësua të kuptojë se botës së tij muzikore i ishin vënë gardhe përtej të cilëve nuk duhej të kalonte. U reduktuan takimet me kolegët. U rralluan udhëtimet në Tiranë. Ashtu si hebrenjtë yllin e Davidit, ai kishte mbi shpinë Festivalin e 11.

Hyrje

Falë përsosmërisë, gjenialitetit dhe gjithanshmërisë së saj, vepra dramatike e William Shakespeare-it (1564 – 1616) mund të lexohet, shetohet, zbërthehet, shkoqitet dhe shpjegohet në mënyra të ndryshme dhe nga këndvështrime të ndryshme. Kjo, natyrisht, nuk ka të bëjë vetëm me mënyrën e as vetëm me mundësinë e leximit e të trajtimit regjisorial të tragjedi, dramave historike e të komedive të Shakespeare-it, të cilat, sidomos tashmë në rrethanat dhe në përvijimet bashkëkohore, varësisht nga prirjet regjisoriale, përmes shfaqjeve të ndryshme teatrore i gjejmë në forma, versione e “motërzime” nga më të çuditshmet, por edhe me vet rrafshin e gjerë e të gjithanshëm të studimeve shakespeareologjike, të cilat, që prej disa shekujsh, varësisht nga autorët, nga qasja, metodologjia, motivet, prirjet, idetë apo qëllimet e tyre, variojnë dhe shpërfaqen në formën e shqyrtimeve, shkoqitjeve, zbërthimeve, kritikave, vlerësimeve dhe përfundimeve nga më të ndryshmet. Edhe pse të gjithanshme e të shumta në numër, të pjesshme apo gjithëpërfshirëse, shqyrtime, kritikë dhe studime të deritashme jo vetëm që nuk i kanë shterruar dot të gjitha mundësitë e studimit të veprës së Shakespeare-it, por, me vet thellimin dhe zgjerimin e tyre të vazhdueshëm, i kanë vënë në pah edhe më shumë përmasat e saj të skajshme e, bashkë me këtë, edhe nevojën e pashmangshme të gjurmimit dhe të studimit të saj të mëtutjeshëm nga këndvështrime të ndryshme. Jo rastësisht, poeti, dramaturgu, eseisti dhe kritiku britanik T. S. Eliot (1888 – 1965) thotë se “Kritika për Shakespeare-in do të ndryshojë gjithmonë bashkë me ndryshimin e botës” (“Shakespeare criticism will always change as the world changes.”)

Por, gjithsesi, është e qartë se jo të gjitha shqyrtime, shkoqitjet, shpjegimet dhe studimet e ndryshme, shpesh edhe për shkak të njëanshmërisë së autorëve të tyre, përputhen gjithmonë me krejt atë që, në të vërtetë, e jep, e paraqet, e pasqyron dhe e nënkupton vepra dramatike e Shakespeare-it. Madje, në raste të caktuara, ato, ka të ngjarë, të jenë pjesërisht apo krejtësisht të njëanshme, ashtu siç janë të njëanshme apo madje edhe spekulative, bie fjala, shumë nga të ashtuquajturat “teori” dhe “zbulime”, të cilat, në rastet më të skajshme, në mënyrë bukur të zëshme, e mohojnë edhe vetë qenien e Shakespeare-it. Pavarësisht nga kjo, Shakespeare-i dhe vepra e tij jo vetëm i kanë bërë ballë kohës dhe prirjeve për keqkuptimin, keqinterpretimin apo edhe mohimin e tyre, por, gjithashtu, falë magjisë, prirjes dhe fuqisë së saj të përhershme letrare e artistike, me kalimin e kohës, ashtu si moshë e venës qindvjeçare, sa më shumë që janë lexuar dhe studiuar, e kanë shtuar edhe më tepër etjen, afshin, dëshirën dhe nevojën për leximin dhe studimin e tyre të mëtutjeshëm e të vazhdueshëm.

Nuk themi diçka të re nëse pohojmë se vepra dramatike e Shakespeare-it, edhe më tutje, vazhdon të jetë një lëndë e begatshme dhe e pashtershme sidomos në fushën e studimeve krahasuese. Brenda këtij përvijimi, ashtu siç mund ta kenë vënë re shumë më herët studiuesit e shumtë, një nga përparësitë dhe prirjet e saj të dukshme është edhe ajo që, duke qenë e gjithanshme, gjeniale e monumentale në artin dhe në përmasat e saj, ajo, përmes temave, ideve, fabulave, motiveve, ngjarjeve, vetave etj., veç tjerash, përputhet, flet e bashkëvepron lirshëm edhe me gjuhët, traditat dhe kulturat e kombeve e vendeve të ndryshme. Si e tillë, ajo, përmes krahasimit,

Këtë të shtunë, mbushen 4 vjet nga ikja në amshim e Bekim Lumi, njërit ndër regjisorët më emblematic të teatrit shqiptar.

Shekspiri dhe Kanuni i Lekë Dukagjinit



Nga Prof. Asc. Mr. Bekim Lumi

jo vetëm që mund të lexohet, studiohet, shqyrtohet, zbërthehet dhe shpjegohet, por, në raste të caktuara, në krahasim me traditat e ndryshme kulturore, edhe të

kuptohet më ndryshe. Një mundësi të këtyllë na e jep, bie fjala, krahasimi i saj me kodin zakonor shqiptar, përkatësisht me Kanunin e Lekë Dukagjinit.



1. Shakespeare-i, ky “mysafir” i vonuar ndër shqiptarët

Përkundër karakterit shumëstresor dhe mjaft të gjerë të studimeve shakespeareiane në rrafshin botëror, në të cilat, veç tjerash, vepra dramatike e Shakespeare-it është shqyrtuar dhe trajtuar nga këndvështrimenga më të ndryshmet e më të çuditshmet, kur jemi të përkimët apo të krahasimet ndërmjet saj dhe traditës kulturore shqiptare, ajo, të paktën me gjendjen e deritashme, në studimet albanologjike, të autorëve shqiptarë apo të huaj, ndoshta për shkak të vet karakterit të tyre më të kufizuar, më “ishullor” dhe më të “profilizuar”, nuk është prekur (pothuaj) fare. Aq më pak në këto studime janë pasqyruar apo trajtuar përkimet e shumta dhe mjaft interesante ndërmjet Shakespeare-it dhe Kanunit të Lekë Dukagjinit. Mungesa e studimeve të kësaj natyre, edhe pse e pakuptueshme, pjesërisht mund të shpjegohet me ardhjen e vonuar të Shakespeare-it në botën shqiptare, por, ashtu sikundër edhe në fusha të tjera të ngjashme, edhe me mungesën e ndjeshme të shakespeareologëve shqiptarë.

Zaten, në krahasim me gjuhët e kombeve dhe vendeve të tjera të Europës, në të cilat vepra e tij dramatike ishte përkthyer shumë më herët, Shakespeare-i, thënë me gjuhën kanunore, ishte një “mysafir” i vonuar ndër shqiptarët. Për një vend si Shqipëria dhe një komb si shqiptarët, të cilët, për më shumë se pesë shekuj, ishin nën robërinë e gjysmëhënës osmane, gjatë të cilës, përveç shtypjes e shfrytëzimit të egër, nuk e gëzonin as të drejtën për t'u shkolluar e as për të shkruar në gjuhën e tyre, e ku librat e shkruar në shqip e të botuar jashtë vendit, gjithë deri me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, më 1912, shpërndaheshin ilegalisht, ardhja e vonuar e Shakespeare-it është e kuptueshme. Është, gjithashtu, prandaj, po aq e kuptueshme pse, edhe kur është fjala për inskenimin e tyre, dramat e Shakespeare-it në botën shqiptare, në Shqipëri dhe në Kosovë, dy vende ku teatri, në kuptimin e mirëfilltë profesionist, zë fill vetëm mbas Luftës së Dytë Botërore (1945), u vunë në skenë shumë vjet më vonë nga koha e përkthimit dhe e botimit të tyre.

Në të vërtetë, aventura interesante e shqipërimin të Shakespeare-it zë fill në vitin 1915 me përkthimin e *Othellos* (*Othello*), për të vazhduar më tutje, në dhjetë vitet e ardhshme, me tri kryeveprat e tjera të tij. “Unë ia pata filluar me *Othellon*, që u botua në gjuhën shqipe në vitin 1916 dhe, dhjetë vjet më vonë, përkthimet e mia të *Hamletit* (*Hamlet*), *Jul Cesarit* (*Jul Cesar*), dhe *Makbethit* (*Macbeth*) u botuan në Belgjikë”, shpjegon shumë vjet më vonë, më 1964, tashmë në moshën 82 vjeçare, përkthyesi i Shkrimin të Shenjtë dhe përkthyesi i parë i Shakespeare-it në shqip, poeti, historiani, politikani, muzikanti, themeluesi dhe kryepeshkopi i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, Fan Stilian Noli (1882 – 1965), përndryshe, në vitet '20 të shekullit të kaluar, edhe shef i opozitës parlamentare dhe, për një kohë të shkurtër, edhe Kryeministër i Shqipërisë. Krejt shkarazi, është për t'u vënë re se, nga katër përkthimet e tij të kryeveprave shakespeareiane, Fan Stilian Noli e shquan sidomos përkthimin e tij të *Makbethit*. Ai, pra, thotë: “Duke i lexuar sot versionet e mia të përkthimit në gjuhën shqipe, mendoj se *Makbethi* ka qenë përkthimi im më i mirë, sepse ka qenë i fundit dhe asokohe e pata mësuar punën e rëndë të përkthimit pak më mirë.”

(vijon në faqen 15)

Që libri “Burgjet e mia” i Dom Simon Jubanit doli dhe në gjuhën angleze, me një titull si varg lutjeje *“From the depths of hell I saw Jesus on the cross”* (“Nga thellësitë e ferrit unë pashë Jezusin në kryq”), besoj, nuk janë shumë veta që e dinë. Po që është përkthyer nga frëngjishtja, pra, paskësh qenë i botuar dhe në Francë, prapë janë pak ata që e dinin. Po që vitin e kaluar “Kujtimet” e tij i botoi në gjuhën amë, në shkodranishten e bukur të autorit, revista “Kens” me rastin e 10 vjetorit të shkuarjes së tij në amshim dhe me rastin e 20 vjetorit të botimit të tyre të parë? Prapë ende më pak veta e dinë. Po që botimi i parë i kujtimeve “Burgjet e mia” s’dihet në çshtypshkronjë u shtyp në atdhe, në Shkodër a Lezhë, Tiranë a Durrës a Gjirokastrë, por libri u shpërnda keq, fare rastësishëm, por s’ishte e rastit që pengohej siç përndiqej autori dikur, nuk duhej të kishte përhapje, një lloj ndalimi, sa të ishte e mundur më shumë.

1.

Është një libër që guxon, që përplaset, rrëfime të kalvarit të një jete, nga meshtar në diktaturë në burgjet e saj me vite e vite, 26 vjet i dënuar në ferrin e të gjallëve duke akuzuar hapur diktatorin e diktatorin dhe pastaj lirimi i tij, por jo liria, rënia e perandorisë komuniste, me demokracinë e dyshimtë, me në krye ata që bënë dhe diktaturën dhe kjo jo vetëm e zhgënjën meshtarin rebel të burgjeve, por dhe e acarën dhe prapë kundërshton dhe ai vazhdon të predikojë qëndresën me forcën e kryqit dhe të karakterit, duke akuzuar sërish, që liderët e rinj si vazhdues të liderëve të vjetër, pa kursyer as bashkëvuajtësit, deri në zemërim, aq sa të vjen të thuash: libër i prapë i një prifti të prapë! Por është e vërteta e tij, pjesë e së vërtetës epokale.

Lënda e librit duket se është vuajtje pa mbarim, përndjekja mizore, përballimi i asaj vuajtjeje me rrugët e besimit dhe të moralit, me karakterin dhe shpirtin katolik arrin të sfidojë deri edhe kishën e tij ndonjëherë, atë çfarë atij nuk i pëlqen, kështu duket, ndërkaq do të jetë ai që do të celebrojë, fshehurazi dhe hapur, meshën e parë pas atyre dekadave të mynxyrshme, që kur Shqipëria ishte shpallur me kushtetutë si vendi i parë e i vetëm ateist në botë, që ndaloi religjionet, prishi tempujt e fesë, duke i shndërruar kishat e xhamitë në kinema e pallate sporti, në magazina bujqësore në fshatra dhe depo armësh për repartet ushtarake, duke mos u mjaftuar me kaq, por duke vrarë dhe klerin, sidomos atë katolik si më të kulturuarin, pra dhe më kundërshtarin.

Në burg do të flakej dhe Dom Simon Jubani, siç duket për të sjellë dëshminë e tij marramendëse, të acartë.

Që në fillim na tregon se si i helmojnë të vëllanë, prift dhe ai dhe vjen deri te demokracia e helmuar e vdekja e vet.

Një zbulues ndryshe, rrëfyese, meshë dhe tortura, enveri-djall, që i pëlqen ta shkruajë këtë emër me shkronjë nistore të vogël, dhuna, puna dhunuese, bashkë me fitimtarët kishte ardhur dhe injoranca, thotë autori. Dhe si qytetar ai vetëshpallet se “Bëj pjesë në partinë e të vorfënve e të masakruemve, të viktimave të së djeshmes e të së sotmes”...

Dje dhe sot për Dom Simon Jubanin janë një vazhdim pa ndonjë ndryshim të thellë.

2.

Autori s’është më. Por siç duket jo vetëm e para, por edhe e fundit është fjala. Dhe desha t’i shkruaja përgatitësit dhe botuesit të kujtimeve të tij, shkrimtarit Lisandri Kola, ndërkohë dhe studiues e pedagog i letrave shqipe në Universitetin e Miçiganit, drejtor i revistës “Kens”, ku dhe ridoli vepra. “Burgjet e mia”, pajisur me parathënie të gjërë informuese dhe vlerësuese.

...studim, kritikë, dokument, dëshmi e specializuar dhe e lexueshme nga të gjithë, kulturologji, - shkruajta. - Është guxim që vjen prej së thelli nga vetë vepra dhe

NGA THELLËSITË E FERRIT PASHË JEZUSIN NË KRYQ

“BURGJET...” E DOM SIMON JUBANIT

- shkëmbim mesazhesh me botuesin e ri -

Visar Zhiti

shëmbëlltyrë, parafjalë në karakterin e karakterit të autorit, si qëndrimet e tij, duhej dhe ashtu, - vazhdoja, - por ndjej keqardhje për çka shkruhet për një bashkëvuajtës të tij në Burrel, nuk kam qenë në burg me ta, por nuk flitej askund keq për atë nga të burgosurit që njoh. Subjektiviteti i të furishmëve dhe lëndon, por duhet të mësohemi me të vërtetat e tjetrit, t’i shohim sa të vërteta janë ato për të gjithë...

Të lexoj/më Dom Simon Jubanin. Të qetësohemi nëpër shqetësime...

Keni bërë një punë me rëndësi, se edhe “pamëshira” është mëshirë e rreptë, - përfundojta mesazhin tim. - Mrekulli që vjen ky libër antimashtrim, me një si djall antidjall...

Dr. Lisandri Kola më përgjigjej:

Jubani asht i sertë si autor dhe ‘rebel’ (*arrë gungçe* e quen veten në librin e tij). Varianti i tij mbi Arbnorin (*bashkëvuajtës ynë, shën. im.*) ndoshta asht unik, por censura, sapo libri pat dale, të lën vend për pikëpyetje shumë. Sidoqoftë, shumë të vërteta ndryhen në (ish)materialet arkivore. Siç e dini, ata edhe kur merren, censurohet nga vetë AIDSSH-ja. Pra, eliminohen emnat e deponuesve, spiunëve, bp, pseudonimeve etj.

Parathania në frangisht dhe anglisht, asht nga një francez, mik i Jubanit që e pat ndjekë apostullimin e tij. Ai, si duket, ka sponsorizue dy edicionet. [...]


Botimin 1 e ka kurue Ana Luka nën pseudonimin letrar Anza Shkodrane. Unë... mora leje mbas sa viteve në Arkiveshinë e Shkodrës dhe po përgatisnim botimin, Biblioteka Françeskane e botoi në letër...

Sidoqoftë ne jemi të gëzuem se prej një libri të censuruar, në 20 vjetorin e bot. 1, “Burgjet e mia” dhe 10 vjetorin e kalimit në Amshim të S.J., u botuen 4 versione: 2 shqip, 1 anglisht e 1 frangisht. Asht njimend mrekulli!

3.

Dhe unë do t’i shkruaja sërish:

...Kujtoja se s’kisha pse lexoja më për burgjet “tona”, por më mësoi si ta shoh më me ngulm të pamëshirshëm dhe burgun tim...



Libri më shkundëlloi, më preku, autori është i skajshëm, ashtu siç janë dhe të vërtetat e tij shpesh, duhet një qëndrim i tillë që s’kursen asgjë siç nuk na kursen “asgjëja”, sidomos kur është vrastare, e them prapë që ndjej keqardhje për bashkëvuajtësit, në parim jam me Dom Simonin, por mund ta thoshte të vërtetën e tij ndryshe, të mos lëndohen të lënduarit edhe nga ne, se ngjan si një hakmarrje e vonë, por gjithsesi e vërteta duhet, pa maska, e di unë ç’kemi hequr nga “spijunët e burgut”, më pis e gjynahqarë se jashtë... por, t’i lëmë të tjerat, të shohim ato që bëjnë kohë dhe histori, e madhërisht është mesha e parë, një hymn që vetëm Shkodra mund ta jepte si prelude e vetëm një kokëfortësi si prej shenjti e Dom Simon Jubanit mund t’ia dilte...


Kujtimet janë një vepër që duhet, ato janë dhe udhërrëfyese për të ardhmen, sidomos kur janë shkruar artistikisht bukur, pra është bërë alkimia e vuajtjes. E çmoj shumë autoironinë e sarkazmën, tradicionale, që Shkodra i ka...

Dhe Dr. Lisandri më përgjigjet sërish:

Falemnderit shumë... për mendimet dhe komentet rreth librit. Unë mendoj se profili i Dom Simonit, asht si episodi i Jezusit, kur dëbon tezag prej tempullit. Pyetja asht, a duhet të ishte ma i ‘butë’ Jezusi me mëkatnorët? Besoj se nuk del veç një përgjigje në këtë rast. Kështu e perceptoj dhe unë rrëfimin e SJ, i cili asht i sertë e i drejtë (aq sa asht njeriu). Objektiviteti dhe ‘radikalizmi’ narrativ, ndoshta i kanë mungue librit shqiptar mbas 90s. Forma e tij shkrimore, sugjeron reflektim dhe nxit institucionet për lëvizje...

SJ jep një dëshmi, i takon institucioneve shqiptare me pohue ose provue të kundërtën, nëse gjithmonë ka ende dokumente për shqyrtim.

Por unë tham se kulmi i asaj veprë asht mbyllja, siç thoni edhe vetë, dhe ‘kontestimi’ i hierarkisë religjioze sa i takon formimit teorik për shëlbimin. Nëpër fletë sigurisht gjen perla të tjera, si psh ‘antikomunistët’ komunistë që Amerika i ka pranue në shtetin e saj. Rasti i djakonit, Ndoc Vasili alias Anthony Kapaj, i cili ka asistue komunistët për futjen e armëve në kuvendin



Franceskan. Ai vdiq në ‘paqe’ para 3 vjetësh në New York. Stili mandej asht unik për narrativën e burgut.

4.

Isha trallisur nga leximi. E gjithë vepra sikur mbart dhe këtë jehonë diabolike, mosndëshkimin e së keqes, që krijon klimën e saj. Dëmtohen ndërgjegjet dhe s’ka më përgjegjësi, as pendim e përkushtime ideale. Aq sa mua më duket si përgjegjegjshmëri negative, ku nuk janë mbyllur moralisht dyert e “Burgjeve të mia”, ngaqë nuk janë hapur Dosjet kobëzeza të diktaturës. Nuk mjafton të nxjerrësh se ç’dukuri sollën dëme, por dhe cilët emra i projektuan dhe cilët i zbatuan çnjerëzisht. Ku janë dhe ç’bëjnë? Ardhmëria nuk duhet të jetë përsëdytje e së shkuarës.

Aq sa e vonë mund të (u) duket vepra e Dom Simon Jubanit tani, po ashtu dhe aq e parakoshme, ajo gjithsesi sërish vjen në kohë dhe, sa herë ta lexojmë, është koha e saj që jep porosi.

Kujtoj/më kreun që e sheh Shqipërinë diktatoriale si një park zoologjik, kështu ishin bisedat e të burgosurve, ashtu e shihnin dhe burgun, si një rezervat. Një humor i trishtë, i zi, oruellian.

Ndërkaq përdëllimi i autorit për vendin dhe gjuhën është i ndjeshëm ashtu si për të vërtetën dhe lirinë, që janë në madhësinë metaforike të zemrës së plagosur, kanë atë përfundje të saj dhe kulmojnë me Shkodrën e tij – “lagjen kryesore të Jeruzalemit Qiellor” – kështu e quan mahnitshëm.

Dhe prapë një prapësi, deri në fund, na dalin dy epilogë siç nuk ndodh, njëri në tokë dhe tjetri në qiell. Sikur duan të theksojnë një mëdyshje që nuk është e autorit, por e realitetit. Epilogu në tokë është komedia e demokracisë shqiptare, siç do të donte ta quante Dom Simon Jubani. Nërsa Epilogu në Qiell është dërrmues, ka një qortim hyjnor, që vetëm një prift shqiptar si ai do të mund të guxonte ta shkruante, që kërkon në parajsë ndëshkimin, jo vetëm të keqes, por dhe të ushtruesve të saj si një zeje tmerri.

Ja, Autori sheh veten të vdekur me një pikëllim ngazëllues, korp i lodhur... pa dhëmbë, të thyer dhe shkukur torturave, por dhe me buzëqeshjen e pashuar, shpotitësë, teksa shpirti shkëputet për të ikur qiejve për në parajsë... dhe atje takon Shën Pjetrin, por në vend të Shën Mëhillit me kandar aty, që peshon bëmat e njerëzve për të vendosur se nga do të shkohet, ishte tjetër kush, e pabesueshme, Enver Hoxha me kostum të bardhë, me kandar në dorë, madje dhe me flatra (?!?!). Si është e mundur? Këlthasim bashkë me autorin.

Dom Simon Jubani ndërmend se kishte ndjekur një meshë dikur, ku një jezuit i huaj kishte predikuar se edhe në qofsh kriminel i botës, nëse pendoresh, qoftë dhe në minutën e fundit, kur je duke dhënë shpirt, e ke shëlbimin, udha për në parajsë është e hapur, e lejon kisha jonë.

Si? Dhe Dom Simon Jubani, tani vetëm shpirt, vikat sërish me pezmi hokatar: unë të gjej në parajsë dhe atë, diktatorin tim, të pafenë, që më kalbi në burg, jo vetëm mua, por popullin tim të gjithë? Atëherë dal unë nga parajsa. S’mund të jemi të dy bashkë...

Dhe shpirti i tij endet rrugëve qiellore. Po tash nga t’ja mbaj? – pyet mes reve. “S’kam ku të shkoj larg teje, o Zot! Vetëm ti ke fjalë jete të pasosun” – përgjigjet po vetë me fjalët e Shën Pjetrit.

Në fakt pyetja mbetet e hapur për Shqipërinë, që duhet të shkëputet në mënyrë drastike dhe me drejtësi nga e keqja e saj dhe të ngutet të shkojë në parajsën e vet, po me drejtësi dhe mëshirë, pra, në normalitetin e gjërave, në europianizmin e jetës, nëse mund ta themi. Është homelia e një prifti kështu, që pa Krishtin në kryq, pra veten, nga thellësitë e ferrit.

- Baba, ka ardhur një lypsar!
 - Mbaka kapelë bombë si francezët, s'janë kështu lypsarët, moj çupkë!
 - Baba, ai ka vështrimin më melankolik që kam parë, duket si një murg i ri.
 - Thuaj t'ia mbathë, nuk kam kohë të merrem me të, pa shiko, u mbështet te junapi, pema jote e dashur, çupkë.
 - Baba, të dalë ta pyesë?
 - Jo.
 - Po pse, baba?
 - Ti bie në sy... të janë rritur para kohe, bën përshtypje... s'është në gjendje as një cohë, po as një modë të t'i fshehë...
 - Babush, ti nganjëherë i përngjan priftit të Boboshticës, që nuk pranon asnjë grua të hyjë brenda në kishë, pa larë duar dhe këmbë me sapllake e legen te katoi i patave poshtë... Dhe pastaj damllamadhi vete e i shikon nga vrima...

- Mbylle moj cipëplatur, mbylle atë të uruar, se siç e ke nisur do të trembësh dhe burrin e dytë... Çap e i thuaj të sikteriset guhaku, ç'm'i bën torollaku ato shenja me duar?

Ajo, çupka, ishte një kurvë, që ai e kishte sjellë nga ishulli grek i Santorinit, ndërsa ai, babushi, ishte tregtari më i famshëm i Korçës, Rako Rina. Po i panjohuri, që priste përjashta i mbështetur te junapi i hollë me gjethe të reja, ishte lypës vërtet, apo...

Ajo zbriti shkallët e tremes dhe doli përjashta në kopshtin e përparme të vilës së madhe dhe e këqyri për një kohë bombenë teveqe që s't'i ndante sytë, duke u dhënë përpjetë gjinjve të mëdhenj që i dukeshin thujase krejt mbi sutjenat e ngushta dhe të hapura kinse për t'i parë meshkujt sev dallinj korçarë, që veç për kësi hiresh tunduese u qante syri i shkretë, po vetëm kaq, se nga ana e parasë ishin dorërrudhur më keq se çifutët. Ai zotëria me kapele bombë vërtet duhet të ishte lypës, se mbante qillota të zbërdhulëta, të rrjepura te gjunjët dhe të llangosura me bojë, një palë këpucë të vjetra të futura në galloshe të çara, po ajo që binte më fort në sy ishte shprehja e përvuajtur e fytyrës së tij, kaq e mirëz, si e një pendestari që mbante shpresa, se Zoti i madh dhe i mëshirshëm do të bënte diçka dhe për të.

- Zotëri, babai s'të jep asgjë, është kurnac i madh, dhjet dhe shikon prapa, më mori mua nga ishulli i Santorinit, ku vuaja për bukën e gojës dhe më martoi për një grusht napolona flori... Unë ta mbush syrin, djalosh... Thuaj po të duash, jo... ai djall, kushedi sa verdhushka ka marrë, sarafi, i pangopuri, i kamuri dhe i s'kamuri, se s'ka të dytë si ai... Më mban me të ushqyer, me të fjetur, me të ndukur, me të shëtitur me llandonët e tij me dymbëdhjetë kuaj, dhe tani po bëhet gati të më japë duart... Ç'do ti këtu? Shko më mirë nga lagjja e evgjitëve, e shuleve, apo e çobanëve, kushedi gjen andej ndonjë gjë, në mos mbathja fshatrave kuturu dhe po të rastisi të vesh në Boboshticë, atje është im shoq, një prift sev dalli pas mishit dhe verës së kuqe që bredh me mushkë... E quajnë Baba Tasi i Boboshticës!

Bombeja nuk po fliste, papritur ai nxori më të shpejtë nga gjiri një fletë letër dhe e vizatoi atë, çupkën e kolme, aq gojëmbël dhe hamgjitëse me gjithsej, që një e dy u jepte gjinjve të mëdhenj përpjetë duke i tundur, ata gjinj të rumbullt e të rëndë me thimthat përjashta ngjyrë trëndafil të freskët me një ndjellje të hapur e vulgarë. Ai mbaroi punë sakaq dhe i zgjati asaj fletën e letrës që i dridhej me një nënqeshje të lehtë... Ajo e mori, e ktheu mbarë e prapë me koketëri me të dy duart topolake që ta shikonte sa më mirë dhe ia bëri, oh! sikur t'i binte alivan. Ai e kishte vizatuar nudo, po aq bukur, aq të zbukuruar, sa ajo e mikluar, pa e fshehur fërgëllimën e beftë, madje e ndezur papritur për një shturje pa mend, kërceu përpara me hov dhe e puthi djaloshin në buzë.

- Ç'je ti, piktor?
 - Sapo i zbrita karrocës me shalqinj që vinte nga fushat e Korçës... dy net kam fjetur në fushë mbuluar me velenxë të dhirtë... Jam piktor, a s'jam piktor, këtë nuk e di, po më mjafton të të them, dhe kjo më kënaq pa masë, se grua si ty, kaq të bukur, nuk kam

PIKTORINGA ROMA

tregim nga Roland Gjoza



parë asgjëkund...

- Unë jam kurvë, e kam zanat kurvërinë... Keni parë?

- Ajo më mungon prej kohe, paraja, prandaj trokita në këtë portë.

- O, ku paske trokitur, po a njeh ti, o i zi, Rako Rinën, këtë plak matuf, të krimbur në para, po që s'jep asnjë dyshkë veresie?

- Jo, nuk e njoh dhe aq mirë, vetëm sa kam dëgjuar për të, po ne edhe mund të bëjmë pazar...

- Ç'pazar, a e di, o i zi, që do të dalësh i humbur?

- Unë i humbur jam. Kjo është porta e fundit ku po trokas.

- Po çdo prej tij?

- Të më presë t'i parashtroj lutjen time. Ndihmomëni të më presë, zonjë.

- Rrini këtu, po mos u mërzisni po u vonova, se ai leshko do të mendohet një copë herë, pastaj do të belbëzojë, po, ose, jo. Ja, prisni te junapi, kjo është pema ime. Uluni te ky stol dhe më prisni.

Ajo u fut brenda. Ai u ul në stol nën pemën e junapit që fëshfërinte me gjethet e vogla plot shkëlqim sikur sapo ishin fërkuar.

- Çupkë, kush ishte?

- Një piktor, më vizatoi nudo.

Ajo i zgjati fletën e letrës. Ai e këqyri për një kohë.

- Shiko, shiko, pse akoma rrojnë piktorë? Kam njohur një, e quajnë Rembrandt, Saskinë e tij e kam në koleksionet e mia. Sot artisti vdes për bukën e gojës. S'kam asnjë interes për të. Ata budallenj kërkojnë parë për ca bojëra vaji dhe kanavaca liri, po punët s'ua ble njëri. Çudi, ka dhe akademi për piktorë, pthul, kjo botë prandaj ka mbetur mbrapa, se harxhon kohë me këta humbamenë.

- Baba, bëje për mua, prite, se ai ka fjetur dy net jashtë në një karrocë me shalqinj.

- Budallai, pse nuk ra në ujdi me karrocierin t'i shisnin shalqinj të Korçë te Pandua, që i vë në akull dhe i shërben me servis Bohemie, një thelë e ngrirë shalqini me krem, sa qimet e kokës... ai, Pandua, gënjehet lehtë, se e ha përbrenda krimbi i estetikës... tek ai t'i shisnin, që të nxirrte shushkoja kacidhet për bojën dhe kanavacën dhe atë supën spirilëng...

- Po ai nuk di nga këto gjëra, është teveqel, po ka dorë, ama, mua më ka qarë.

- Ti i qenke zhveshur gollomesh atij kërriçi?

- Jo.

- Po si të ka bërë pa të parë? Paska vërtet dorë, shejtani, të paska nxjerrë tamam si atë natë kur të njoha unë tek ajo dhoma e kështjellës në Santorini kur na u shua drita e kandilit nga stuhia... jo, ti i je zhveshur gollomesh!

- Ke luajtur? Ai më bëri sa hap e mbyll sytë, leshko! M'ia kishte ngulur sytë gjinjve, siç bëre dhe ti...

- Po edhe ai derdimeni me mushkë prej gjinjve po të merr...

- Ti ke ditur, po ai s'ia thotë fare...

- Je e bindur se ka dorë?

- Ai është piktor i mbaruar, kjo duket, s'do shumë mend për t'u kuptuar, nuk e shikon sa bukur m'i ka nxjerrë kofshët, vendin e fshehur me kaq shumë lesh, që tromaks dhe të verbrit, po bythë e mëdha?...

- Më lër të mendohem, zuskë, duhet të rrish me mua se më ngacmon, veç të tjerave, dhe idetë. Shko nga shko, burrë më burrë e hu më hu, po të paktën duku nga unë një herë në javë.

- Sa më jep?

- Një napolon flori, në qoftë se m'i ngacmon vërtet idetë.

Në mbrëmje ulur pranë një tryezë, me një shandan, vetëm me një qiri të ndezur, u vendos që piktori të mos kthehej në Romë ku kishte mbaruar studimet dhe, ku prej kohe mbante kyçur në papafingon mbi çati, 36 punë me vaj, kryesisht portrete, peizazhe dhe natyrë mort.

- Hesapet janë të qëruara, - tha Rako Rina - për dhomën e madhe dhe sallonin në katin e parë, që ti do t'i kthesh në sallë ekspozite, unë do të marr toptan gjysmat e fitimeve, shtu këtu dhe reklamën, afisheet, tellallët, llandonët e shkruar, që do të punojnë për mua, kinematë, që do të njoftojnë çdo natë për ekspozitën, e cila hapet për herë të parë në qytetin tonë, pra, bëjnë 10 për qind, demet që mund t'i shkaktohen shtëpisë nga vizitorët, 5 për qind, Kaliopi që do të pozojë nudo dhe që është në hesapin tim, 10 për qind. Pra, ti do të marrësh vetëm 25 për qind. Nuk është pak për një piktor që vuan për bukën e gojës. Po nuk u shitën pikturat unë do t'iu padis në organet kompetente për dhunim banese, sepse kështu ti s'do t'i përmbahesh pikave të kontratës. Përfundimisht punët kopsiten, me avokat, noter, vulë e firmë në Bashki, pra, nesër në ora 6 pasdite. Vishu një çikë më ndryshe, bombenë mund ta mbash, je dakord me kushtet e mia?

- Zotëri i nderuar, edhe kështu është mirë për mua, po kam një peng, peng artisti, më kuptoni? Në Romë kam punët e katër viteve, punët më të mira... Peizazhe, portrete... M'i kanë parë profesorë italianë...

- Jo, jo, nuk pranoj. Vetëm nudo. Ti nuk je Rembrandti. Nudo. Ajo mund të shitet, e blejnë borgjezët e vegjël për t'u dukur, ata që e mbajnë veten për parisienë në këtë qytet bizantin. Unë dua të fitoj pa humbur asnjë dyshkë, të fitoj shpejt dhe ta mbyll këtë punë. Më zutë ngushtë, djalosh, se unë vetë kam një koleksion me piktura të rralla të Rembrandit, Boshit, Karavaxhios, vëllezërve Zografi, David Selenicasit, Nikolla Onufrit. Ai sot s'është kushedi se çfarë, po nesër, pasnesër... merreni me mend vetë, unë mund të fitoj miliona! Ju, kush ju njeh ju, askush! Ah, sa ka

të bëjë emri dhe këtë ju e dini, sigurisht. Nuk po zgjatem më. Pra, do të zografisni nudo Kaliopin në pozicione të ndryshme sapak provokuese, që piktura të ecë shpejt. Më bojëra vaji, pastel, guash, akualet, grafik, si të doni ju, zgjidhni, keni dorë të lirë.

- Faleminderit, - belbëzo piktori - të paktën gjeta një sallë ku të ekspozoj në këtë qytet provincial ku s'ka galeri dhe salla ekspozitash. Unë dua të bëhem piktor këtu, nuk dua të largohem nga Korça, çështje nostalgjie dhe ndjesish të çuditshme, si të shprehem tamam, këtu ndjehem vërtet mirë.

Rako Rina i ktheu krahët dhe atë kohë këndesi lajmëroi se po vinte nata. U dëgjuan me kumb të kthjellët kambanat e Mitropolisë dhe bëri zhurmë për të fundit herë shuli që mbylli portat e mëdha të katedrales. Atë natë ai fjeti të hotel *dërrasa*, një karakatinë e mbuluar me katran. Ajo ndërtesë ishte ngritur me dru mëshketne dhe kur e kur tundej e kërciste sikur do të shembej e rrënohej me rrapëllimë. Fenerët vareshin përjashta dritareve dhe nxirrnin tym. Në dhomë kishte shumë flutura dhe nuse pashke nëpër palat e perdevë të zhubrosura. Po era e drurit të pa zdruguar ishte e këndshme, sikur shpërthenin boçe lulësh në errësirë dhe lëshonin një kundërmim të fortë. Ai s'mbylli sy. Dëgjonte xinxërin që poshtë barit, zëtha e psherëtima të pakuptueshme e vajtime të ankthshme nëpër natë. Në atë qytet jetonin mëma e tata, po ai s'donte të bëhej i gjallë, se i vinte turp. S'kishte pasur parë t'i blinte mëmës shall të zi e tatës çizme e kapele. Ç'fitonte, ato pak kacidhe të shkreta, i bënte bojëra e kanavacë, një gotë verë e një riskë mish të pjekur. Dhe emrin nuk do ta vinte në fund të letrës, a kanavacës. S'duhet ta merrte vesh kurrkush se ai ishte djalë i atij qyteti, po një i huaj që kishte ardhur nga Roma.

Punët u kryen sa hap e mbyll sytë dhe ai dëgjonte herë pas here tellallin që i binte daulles dhe lajmëronte me pohe e bujë për një ekspozitë pikturë që do të hapej së shpejti për herë të parë në atë qytet që i thoshin Paris i Vogël, po që s'kishte aq tempuj për artin e lënë në mëshirë të fatit, i cili shtonte gjithashtu, se, për këtë eveniment të veçantë, kishte hapur dyert e shtëpisë së tij tregtari fort i nderuar zoti Rako Rina. Ajo që do të ekspozohej do të ishte surpriza më e madhe e vitit, më e jashtëzakonshme se filmi i famshëm italian, me dashuri dhe lot, i cili ende s'kishte mbërritur, po pritej të trokiste me ditë në kinema *Magjistik: Voce de la tempesta*.

Erdhi prifti me mushkë nga Boboshtica dhe kërkoi pjesën e vet, me aq bututimë e ngulm, duke kthyer me zhurmë me surba të mëdha një botë të vogël me verë kishë, sa ishte e kotë t'i kundërshtojë. Rako Rina u bind, sepse puna ishte ca delikate, gruaja e tij, Kaliopi, do të zografisej gollomesh dhe kjo ishte thagmë mbi thagmë. Është art, budalla, ti merr verdhushkat dhe mos u ndej, pastaj, po t'u mbush mendja, shite, jepi duart, ajo dërdënge nuk priset kollaj, sa më shumë kohë kalon, aq më e bukur bëhet, dorë pas dore, ajo kuçkë e ëmbël do t'i bëjë parallinj të gjithë.

Prifti i lutej që nudot të mos kishin kokë, që ajo të mos njihej. Ç'thua, je në vete, po koka e Kaliopit është gjysma e bukurisë, or tutkun, pra, gjysma e çmimit, ajo hap varret me një të shtënjë syri, me atë të shtënjë syri të paturpshëm që edhe vetë Episkopin e Mitropolisë, Atë Visarionin, atë qejfliun, do ta shtinin në ngasje e do t'i vinin një damkë turpi kishës sonë të bekuar. Ai piktor tuhaf, që në fillim m'u duk si lypsar, na ka hapur pazar të mbarë.

Pastaj thirri piktorin dhe i tha se kontrata do të rishikohej, në të do të shtohet dhe një pikë, që ishte harruar nga puna e ngutur, shtoi si nëpër dhëmbë dhe një proverbë: «Macja që ngutet, pjell këlyshë të verbër». Pra, 10 për qind do t'i merrte i shoqi, prifti, Baba Tasi i Boboshticës, ai firar i meshës që bridhte me mushkë. Kupton, student, ky dhjetë përqindësh do të zbritet nga shuma që të takon ty, ose përndryshe, ktheji majat nga ke thembrat dhe mbytyja për në Romë.

Pranoi me gjysmë zëri i shkretë piktor

Në spitalin 5 të kryeqytetit, e shoqja e përletur, po i linte porosi Hekuranit si ta rriste vajzën pas vdekjes së saj, ku ta çonte për të mësuar gjuhët e huaja, sa herë ta çonte te varri për të vënë lule.

-Mbaj shënim, Hekuran, - e përsëriti disa herë kërcënueshëm,- pa kaluar të njëzet vitet, mos ma sill vajzën në varreza. Nuk dua të futet në zymtësi. Dëgjon, Hekuran, vetëm kur të ketë mbushur njëzet vjet.

Hekurani u përpoq ta dëgjonte... megjithëse po e humbiste durimin pak nga pak. Nuk deshi ta dëgjonte më kur Sania e këshilloi të martohej pas vdekjes së saj, të mos mbante zi pafundësisht për bashkëshorten fatkeqe.

-Ruaje kujtimin tim me respekt, por martohu, jeta vazhdon, Hekuran, jeta nuk ka mbaruar.

-Ke mbaruar nga trutë, grua, e ke psikologjike, asgjë tjetër s'ke, - i ra shkurt Hekurani. Doli duke përplasur derën. Sania u shkreh në të qara:

-Rrite vajzën me përkëdheli, ta shikojnë jetën me dashuri dhe kurajë. Mos ma sill te varri pa mbushur njëzet vjet, mos qëndro vejan, martohu, jeta vazhdon...Hekurani im i dashur ..të lutem...gjej një grua për sëmbari dhe martohu. Je i ri.

Hekurani u kthye, hapi derën, i briti.

-Do të të çojnë në çmendenë po vazhdove kështu, atje e ke vendin, më duket.

E la gruan në supozimet e saj të frikshme, doli të gjente ndonjë pijetore, nga ato anë rruge ku mund ta pish një birrë pa u ulur. Këtu në Tiranë ka mjaft të tilla, këtu nuk është si te ne, u ngushëllua Hekurani. Ta marrë dreqi punën time, mendoi pas pak, kur e ktheu gjysmë shisheje birrë. Tre vjet martesë dhe e shoqja kish shfaqur rregullisht një ndjenjë të fortë bezdie nga të jetuarit. I lutej perëndisë ta merrte një orë e më parë, ditë për ditë, sa herë grindeshin, sa herë llogaritë e të hollave nuk iu dilnin, sa herë planet optimiste e ambicioze iu dështonin. Edhe kur digite gjellën, edhe kur lavatrica bllokohej, edhe kur kanatat e dritareve, të bymyera nga lagështia e ajrit të vjeshtës donin pak forcë për t'u mbyllur, edhe kur cifloste ndonjë gotë qelqi, Sania i lutej perëndisë që ta merrte dhe atë në gjirin e saj, me të shumtët. Dhe perëndia sikur e dëgjoi. Gruaja nuk ndihej mirë, jam sëmurë, thosh, dhjetëra analiza, ilaçet me kilogramë, shërim s'po gjente.

-Jam keq Hekuran, jam keq. Ti jeto për mua.

- Doje të vdisje, vdis, - i tha i shoqi kur u kthyen shpresëhumbur nga vizita të një mjek i ri, i dëgjuar si shëruar i padiskutueshëm në qytetin e tyre.

Sania nuk i ishte përgjigjur. Ashtu në heshtje, njëri pas tjetrit shkonin përditë nga një mjek te tjetri, ritual që kish filluar t'ju pëlqente të dyve. Ngjanin si një çift që po shkante në kinema ose teatër, nga mënyra si visheshin, si ecnin rrugës.

-Sikur një ditë të gjejmë vërtet shërim, - tha me vete Hekurani, do ta kemi problem, sikur u mësuan me këtë lloj jete.

Udhëtimin për në kryeqytet e bënë me makinën e tyre. Hekurani dukej paksa i gëzuar. Kur e kish blerë makinën, argumenti bazë që kish përdorur në familje ishte: Ta kemi për çdo rast, kur shkojmë me pushime, kur sëmuremi, kur shkojmë te të afërm, te miq, te shokë, për të mira e të këqija, pse të mos kemi makinën tonë, pse të rrimë në anë të xhadesë si shkretanë?!... Dhe rasti e solli që rrugën e parë të gjatë me makinën e tyre ta bënin pikërisht për arsye shëndetësore.

Në spitalin rajonal kishin bërë analizat, laboranti ua kish mbyllur në zarf, kish

AJO DI DIÇKA

Tregim nga Virion Graçi



folur në telefon me Profesorin në Tiranë. I kish nisur laboranti:

-Ai do t'ua interpretojë më mirë, po patët nevojë të shtroheni do t'u dërgoj unë një dokument shoqëruar me *faks*.

-E ke të qartë çfarë është *faksi*? - kish pyetur laboranti Hekuranin kur ky e kish parë me mosbesim, me sy të zgurdulluar.

-Urdhëro?- kish reaguar Hekurani i habitur nga pyetja.

-Të pyet për *faksin*, - i tha e shoqja, - e ke parasysh se çfarë është *faksi*?

Hekurani nuk u qe përgjigjur. Hekurani dinte më shumë se sa dukej. Nëna e tij vazhdonte të punonte si infermiere dhe Hekurani ishte rritur korridoreve dhe lulishteve të spitalit. Edhe pijen e kish mësuar në spital. Burra të mërzhitur merrnin raki ose fërnë, kur dilnin të çlodheshin pas qëndrimeve të gjata te të sëmurët e tyre. *Pija të heq mërzhinë*, kish dëgjuar turbull Hekurani burrat e rritur, dhe, pa prituri të rritej dhe vetë, nisi të pinte herët. Edhe shprehjen: *Jeta është e shkurtër*, - që e kish si refren kur thante shishe birrë, e kish mësuar që i vogël në ambientet e spitalit.

Me nënën nuk fliste më, pas martesës me Sanien, pak kohë pas martesës. Të dyja gratë, nëna dhe e shoqja u ankuan te Hekurani në ditë të ndryshme.

-Ajo më tha: *nuk dua të të shikoj më me sy*, - tha secila prej tyre për tjetrën, sikur ta kishin bërë me fjalë ta fusin Hekuranin e gjorë në një labirint melankolie. Fjalë të njëjta, Hekurani nuk mund t'i besonte asnjëherë, megjithëse e dinte se vetëm njëra gënjente. Kështu u ndanë me nënën, për së gjalli. Lindja e vajzës, sëmundja e Sanies qenë raste të mira për t'u afruar sado pak, por Hekurani qe trembur. Më mirë larg sesa me frikën e përditshme, mos grinden tani, mos grinden pastaj.

- Dua të shërohem, - tha rrugës Sania.

-Do përpiqemi dhe... do të shërohesh, - e mbështeti vullnetin e saj Hekurani, - do t'i shkrijmë të gjitha mundësitë, qoftë dhe zoti me ne.

-Dua të shërohem,- përsëriti gruaja. Një gëzim i brendshëm po e bënte të shfaqej ndryshe, krejt ndryshe.

-E mora vesh.

Në ndalesën e parë, kur thau birrën e tretë, Hekurani pyeti:

-Ti sikur bëje lutje të ikje nga kjo botë, më ke lodhur me fjalime, jetë e padurueshme, jetë qeni.

-Sot fola me mamanë.

-Me...mamanëme mamanë?

-Me mamanë.

-Me...mamanë...time?!

-Me tënden, në spital, kur mora zarfin me analizat. E dinte se do iknim në Tiranë.

-I fole ?

-Më foli, i fola.

-Të lumtë, - u gëzua si rrallë herë Hekurani, - zoti qoftë me ty.

-Madje më përqafoi. Më përqafoi, më puthi në faqe, - tha Sania me të njëjtën ndjesi ku përzihej habia me gëzimin. - Më përqafoi dhe më puthi.

Hekurani nuk u përmbajt. Në ndalesën e dytë, pranë një gomisterie, i telefonoi nënës. E pyeti për ngjarjen e mëngjesit.

-E vërtetë, - tha nëna, e vërtetë, u takuam.

Hekurani donte ta pyeste hollësisht, ta falënderonte. E kuptoi se ajo ishte mallëngjyer, s'qe mirë ta bënte të qante, aq më tepër që ishin larg njëri tjetrit dhe nuk shiheshin dot sy më sy.

-Do të rri me vajzën sa të vini ju, - dha lajmin e dytë të mirë nëna.

-Me vajzën tonë ? Do të shkosh ta marrësh?!

-Patjetër!

-Të njeh vallë? Thua se do të rrijë urtë me ty? - pyeti Hekurani.

-Mirardhshi, - foli nëna e vendosur. Biseda u mbyll. Hekurani mori frymë thellë, po dilte nga ferri i mrisë me nënën e tij.

Hekurani u kthye pranë të shoqes. Profesi, shëruesi i famshëm i kryeqytetit nuk ishte kthyer nga konsulta. Sania po qante.

-S'ka shpëtim, s'ka shpëtim për mua. Kujdesu për vazhën.

Një grua e moshuar, e shtruar në shtratin afër dritares, po mundohej ta qetësonte Sanien. Nuk priti të njihej me

Hekuranin, ia nisi drejt e në temë.

-Pse ia ndillni të shkretës, kjo duket e re, e fortë.

-Kush ia ndolli? - u nxeh Hekurani, -fol, kush të ka katandisur në këtë gjendje?

-Askush, - tha Sania nëpër dhëmbë. Mënyra si foli ajo la të kuptonte se e dinte kush ishte fajtori.

-Askush! - briti Hekurani me fytyrë nga gruaja e tij por për ta dëgjuar gruaja e moshuar. Askush!

Hekurani u kthye për të parë efektin te gruaja e moshuar. Ajo nënqeshi, ai u bë tym.

-Është me fiksime, asgjë më tepër, *psikologjike*.

Hekurani doli në korridor, gruaja e moshuar e ndoqi.

-Dikush i ka thënë se ka sëmundje të pashërueshme, i ka thënë dikush, një person i besuar, me siguri, - i tha gruaja e moshuar. Rrezatonte dhembshuri. Hekurani u përqendrua në fytyrën e saj, ajo qe e mirë, e urtë, mëkat të dyshoje te ajo.

-Kush mund t'i ketë thënë?... Kur?... Unë nuk di gjë, - tha me sinqeritet Hekurani, - ty çfarë të tha?

-E kish marrë vesh në mëngjes, kaq më tha mua, - pranoi gruaja e moshuar, - sot në mëngjes.

Analizat ishin të mbyllura në zarf. Hekurani e dinte nga mjeku se gruaja vuante nga tiroidet, diçka kronike, e kurueshme, pa rrezik jete. U bë më keq. I briti të shoqes

-Me kë ke folur sot në mëngjes?

-Me asnjë.

-Me asnjë! Dhe më jargavite sikur je para pushkatimit.

-Takova mamanë tënde, vetëm atë.

-Të gëzoi takimi me të?

-U gëzova në fillim.

-A nuk më the se biseduat me përzemërsi?!

-Po. Më vonë e kuptova ... me vonë.

-Ajo të paska bërë kështu?! - shfryu Hekurani. Doli. Në korridor kish parë një aparat telefonik. Formoi numrin e spitalit të qytetit të tij, kërkoi nga reparti i analizave të dilte mamaja. Ajo vonoi ca, doli më në fund duke marrë frymë me vështirësi.

-Ti e ke gënjyer këtë idioten time, mama?!

Mamaja nuk u përgjigj por nuk e mbylli telefonin. Hekurani u xhindos.

-Pse s'flet?! Gjete një idiote si ime shoqe, tallesh me të. Turp.

-Hekuran. E përqafova, vetëm kaq. Dua të pajtohem. Jam lodhur duke ndenjtar larg.

-Pse e frikëson gruan time?! Gjete një idiote dhe tallesh me të.

-E përqafova, nuk e gënjeva. Jam shumë e lodhur dhe e vjetër për të tallur fëmijët e mi, - tha mamaja dhe e mbylli telefonin.

Hekurani u kthye pranë të shoqes. Vendi i vinte rrotull, kish marrje mendsh.

-Domethënë nuk ke folur me njeri.

-Përse?

-Për analizat, për sëmundjen

-Jo. Me asnjë.

-Dhe më qan si idiote. Kush të tha se je me kancer?

-Askush.

-E pastaj pse qan? Nga të shkrepni në kokë sëmundja e pashërueshme?

-Kur takova mamanë tënde. Ajo më përqafoi

-Të përqafoi?! E pastaj..?

-Më përqafoi, më shtrëngoi fort në gjoks.

-Mamaja, ë ?!

-Po. Ajo patjetër di diçka, di diçka dhe e mban të fshehtë.

-Ashtu?! - foli qortueshëm dhe me përcmim Hekurani.

-Po! Pse jo?!, - tha me vendosmëri e shoqja, - përndryshe pse do të më përqafoje ashtu. Mamaja jote kurrë s'më ka shfaqur ndjenja të tilla.

-As ti asaj!

-As ti!

-As unë!

-Po, as ti! -tha gruaja duke fërkuar sytë e skuqur nga lotët.

-Kafshë, kafshë e mallkuar, - mërmëriti Hekurani pa e ditur as vetë për kë e kishte fjalën.

Arsyetimi i Sanies e bindi deri diku Hekuranin, nëna e tij i kish parë analizat e Sanies, kish parë se nusja e djalit do ta kish të afërt mynxyrën dhe kish nxituar të pajtohej me të dy. Ia kish thënë dhe të birit në telefon se nuk donte të jetonte më larg tyre. dhe kishte dashur t'i ndihmonte duke ju mbajtur vajzën.

Burrë e grua kishin lënë porosi telefonike te nëna e Sanies për të mbajtur për një periudhë të papërcaktuar vajzën e tyre, kishin marrë analizat nga spitali shtetëror dhe nuk kish humbur kohë me mjekët te "Nënë Tereza". Kishin shkuar në klinikat private, në dymbëdhjetë të tilla kryen vizita, analiza, konsulta, kurrë nuk dëgjuan të njëjtën diagnozë dy herë. Dymbëdhjetë klinika, dymbëdhjetë variante. Kaluan shpejt tre javë kontrollesh, kontradiktash e zhgënjimesh në klinikat e kryeqytetit.

-Në Turqi, Hekuran, shesim veturën, fitojmë ca vite jetë për mua, -u lut Sania. - Ca vite, Hekuran, sa të marrë vajza njëfarë drejtimi në jetë. Pastaj, ti vazhdo të jetosh...

Në spitalet dhe klinikat e Stambollit procedurat ishin më të ngatëruara. Hekurani mori borxh nga kunetërit, dollarët vinin sakaq me Uestern Union. Kaluan katër muaj në Stamboll po aq shpejt sa tre javët e Tiranës. U kuruan për probleme të ndryshme që nuk e kishin ditur se i mbartnin, duke kërkuar ta gjenin e t'i dilnin ballë për ballë diagnozës së tmerrshme, atë për të cilën dyshonin. Ditën e parë të muajit të pestë Hekurani dëgjoji nga mjeku i radhës atë që i kishin thënë në krye të herës në klinikën e parë turke: "Gjëndrat, tiroidet. Krejt pa gjasa vdekshmërie. Pjesa tjetër problem nervor, psikologjik."

Hekurani kthehej optimist nga Stambolli, me adresën e psikiatrit numër një të Tiranës në xhep kur mori vesh rastësisht, nga telefonata e një miku se nëna e tij kish ndërruar jetë.

-Sa të lë gruan këtu, te një specialist i shquar dhe erdha, për katër orë jam atje, - tha Hekurani.

-S'është nevoja të nxitohesh, -i tha getësisht miku i tij.

-Pse, kur ka ndodhur?- dyshoi sakaq Hekurani.

-Ka gati dy muaj, dy muaj e gjysmë. Nga një tumor në tru. U diagnostifikua, u diktua masa tumorale nga analiza skaner dhe mori fund pas dyzetë e tetë ditësh. E kishte lënë veten pas dore. Ngushëllime mik, bëju i fortë.

Dyzetë e tetë ditë që u diagnostifikua me tumor në tru, nisi të llogarisë Hekurani duke shfrytëzuar kalendarin e xhepit, dyzetë e tetë ditë i bie të jetë atëherë kur nëna takoi time shoqe në spital, kur e përqafoi, kur shfaqti dëshirën të pajtohej me ne. Sipas një këndshikimi Sania kish pasur të drejtë kur kish dyshuar seriozisht te përzemërsia e papritur e mamasë. Ajo kish ditur diçka.



Më qëlloni (krejt papritmas) me ndejtë me të... Më thanë të drejtën i druhera atij takimi, siç na ndodh kur ndeshim përballë një shok ushtrie mbas 30 e kusur vitesh, ndonëse koha e kalueme bashkë ka qenë e pakrahasueshme me askënd tjetër për sinqeritetin, ngushëllimet, trishtimin dhe sflitet; për zhgënjimet dhe hidhësitë e një jete pa shpresa, përkundër andrimeve nën qiellin e natës dyst me yje që shkëlqejnë e kputen honeve të errët; për ngashërimat e heshtuna me kokën e mbulueme ndën batanijet e ashpra ushtarake... Po, por nuk mjaftuakan as këto, se na, prapëseprapë, i bishtnojmë takimit: kthejmë kokën mënjane, kinse nuk e vemë oroe, kinse jemi t'përpimë prej punës, ndërkohë që vigjëlojmë veshëcurrekë, derisa momenti i takimit të jetë shmangë. Atëherë kthejmë të lehtësue prapë në udhën tonë.

Se, sigurisht, nuk jemi ma të njajtë, me gjasë, as unë, as ai... Jeta që s'len gur mbi gur pa e ndryshue, ka ba tashma të vetën... Madje ka gjasë, që mbas kaq kohe, na ka gjasë me folë në gjuhë të ndryshme me njani-tjetrit. A ka gja ma t'pikëllueshme se tmerri i moskuptimit? Të qenët i pakuptuem në këtë botë t'randume me shenja?

Por në një qoshk të botës paska qenë parathanë që ernat e vetmisë t'na përballnin pashmangshëm. Isha po ai dhe ai - ishte po unë. Vetëmse fytyrat tona shprehnin ndryshim të dukshëm. Koha që len gjurmët e veta me hartën e brengave, me pakënaqësitë dhe me pengjet e papërbushuna, atë s'e kishte prekë as përskej: fytyrë rioshe me dy sy

shkëlqarë, t'uritun për andrra, njëlloj si atëherë, kur ishim bashkë, para tridhjetë e kusur motesh.

- Si i lodhun më ngjan, si i prishtë, - thotë tue e anue kryet për me më pa n'profil.

- Jam mirë, - ia kthej, - jam mirë, po aq sa ndjehesh mirë dhe ti.

- Unë nuk ndjehem hiç mirë... Nga e gjete se jam mirë? Ku e sheh të mirën teme? - thotë, tue ia qëllue taktikës sime për me i ba lak kuvendimit. Andaj më gozhdon me pyetje:

- Çdo me thanë mirë, simbas teje? Mos ndoshta ti quen mirë atë kohë kur ishim bashkë në kazermë dhe qanim netëve tue ba shërbim roje në kodrat me ullishta?

- Kanë kalue mote dhe nuk them se ishim mirë, por kishim andrrat, - i them. - Të kujtohet Paulini? Vrau veten në vendrojë me një të shkrepme... Pati mbështetë mjekrren në grykën e pushkës dhe plumbi i kishte dalë përmbas rrashtet. Kishte shpërthye pranvera, nëse e mban mend dhe rrjedha e përronit aty ndanë nuk dëgjohej, por dukej prej rrëkesë së luleshegëve, që skuqte në një vazhdë të vetme drejt Drinit. Na qamë atëbotë për Paulnin që i dha fund vedit: aq i ri, aq i gjatë, aq i pashëm, aq gazmor dhe nuk na besohej, se si mund të ikte ashtu, ai deli djalë, pa asnji shkak të dukshëm, kur tan jetën e kishte përpara e mundej me u ba çka t'ia kishte anda. Nuk e pritshim prej tij...

- Lene Paulinin ti, mos m'iu shmang kuvendimit, - tha, tue m'këputë pa pikë taktit, mandej fill shtoi: - Nuk kemi qa për Paulinin atëbotë, or pallosh groshe...

- Thue ti...?

- As ti e as unë... Paulini ishte thjesht një shkas. Nji ndërmendje. Nji qortim për mungesën e guximit dhe burrnisë që ti nuk e pate... me e ba të njajtën gja dhe pse e shestoje kahmoti. Po thuej lavdi Zotit që u gjet Paulini...

- Qe, tash po vret të trasha mbarë e prapë e nuk din çka po qet goje... Ç'pate? Ti ma njeft guximin... si mundesh me e vu në dyshim?

- Nuk ke qa për Paulin të thashë, mos t'rrejë mendja. Kaq.

- E ti? Ti vetë, për kënd e kishe vajin? Dro për vajzën e komandantit që humbi garën e vrapimit? Se ti i pate ba hartimin, me sa po më bie ndërmend...

- S'po them as për vedi, se po qaja për Paulinin e shkretë, jo...

- A ban me ditë, për kand? Për duditë e prendverës dro?

- Leni mahitë! Vajin tem e kisha për ty! Për diç që po të piqej në mendje, që po t'avitej tinëzash e që unë nuk kisha fuqi me e ndalë, derisa ndodhi pashmangshëm një mesnate, në kapanonin e braktisun. Pa krismë... me jastëk. Pabesisht. Në kulmin e gjumit të pafajshëm. Bash ditën që prisnim lirim. Ma qite për dritareje kurmin, kinse të pajetë, e mandej, dite me e heqë zvarrë e me e fshehtë në prronin me shegë të egra, tashma të pjekuna. Askujt s'i ra në sy mungesa jeme natë tollovi festive, ku ushtarë e komandanta ishin të zanun me ndamje, përqafoje dhe zhurmën e kamionave ushtarakë, që prisnin të mbusheshin me ushtarët e liruem në oborin e repartit. I kishe ba hesapet mirë, si dhelapën vjeshte, me e fshehtë vrasën tande mes haresë e galdimit të përcjelljes, nën tingujt e harmonikës. Pse hesht? A mos po rrej? Mandej dihet, u ktheve pa mue... Pse s'e thue? Kjo asht arsyeja pse më bishtnon e ndërron rrugë? Ke bash fytyrën e atij që nuk guxon me u përballë.

- Qe pra... a po përballemi? - qita e thashë, tue e pa drejtazi në bebe të synit. - Po përballemi, ani, por ta dijshe, sak kam qenë tue ndërrue udhë...

- Ta dijshe? Ta dijshe çfarë?

- Që je kaq budallë. Ke qenë qysh atëherë, a po tani je ba i marrë?

- Por nuk asht kjo arsyeja që të shtyu me më hekë qafe ashtu, si brac, në mesnatë, me jastëk në fytyrë, në pikun e gjumit që e kput njërin si deka...

- Në kjoftë se ty t'ashtë ulë galuc ndër tru se të paskam hjekë qafe në atë mënyrë, besa boll mirë paskam ba, por s'po ma spiegon një gja: pse hem të paskam mbyttë e hem më del përpara si fanti spathi, tue më broçkullisë një thes me marrina?

- Ti veçse kujtove se më hoqe qafe... Po siç e sheh, unë kam jetën teme, ashtu siç deshe ti ta kem, ndamas prej tejet. Dhe a e di ç'ka? Po ta them një gja të mbrame e po largohem kësaj radhe, se nuk po mundem ma gjatë me të durue: je ba i shëmtuet, i prishtë e i mërzhitshëm, mu si një gazetë lokale e kohës sonë...

- Mirëmbetsh! - thotë e largohet për me hupë në turmën laramane të rrugës.

- Ani, prapë ka me kthye, kem me u ndeshë, - them, tue ngushëllue vedin, me një përballje tjetër, për të cilën nuk jam krejt i sigurtë.

[mirë se vini bashkatdhetarë!](#)

AEROPORTI ADEM JASHARI

Kur aterruam, pritëm gjatë për valixhet.
Dikur kuptuam që ato s'kishin ardhur.
Asgjë e re, mërgimtarët humbin gjithmonë
copa të vetat ndër aeroporte.
Aeroportet janë bisha që i kafshojnë
rregullisht, ashtu si gjahtohen buajt në vada ujërash.
Nga njëherë bishat vjellin mbrapsht
çfarë kanë kafshuar, e mërgimtarët
gjejnë copa të veta, stërkequr në zorrë të bishës.
Nga njëherë ato copa treten përgjithmonë.
Mërgimtarët duhet herdokur t'u qasen bishave.
E ato presin durueshëm, të fshehura
mbrapa emrash të mëdhenj.

[o sa mirë që keni ardhë](#)

GJAKOVË

Ja ku jam prapë, në këtë qytet mes tre lumenjsh.
Një syresh pothuaj është shtjerrur,
e një tjetër ishte gjithmonë më shumë përrua
se lum. Por emrat i kanë madhështorë:
Krenë. Llugë. Erenik. Trini e shenjtë që ngërthen
tiparet e qytetit: krenarinë, punët llogë,
e erën e freskut që ka prurë uji në çdo vendbanim
qysh nga agu i kohëve që përmenden.
Por cilat kujtime përmenden? Cilat harrohen?
Nga larg më thërret nëna të kthehem, se ra terri.
Mirëpo ajo s'është më këtu. Duhet të ripërkufizoj
se ç'të quaj ag të kohëve, e të ndaj vërtet mendjen
se ç'dua të mbaj mend.

[a doni me shku en det](#)

NIMFA

Janë ulur të tri vajzat e mia
e hanë ngeshëm bashkë më në fund
Në anëdetin shqiptar
Gjithçka është njësoj si në kujtimet e tyre
Deti njësoj turkozë
Dielli njësoj i nxehtë
Kënga e gjinkallave njësoj ëndërrimtare
si isoja që jehon diku në largësi
(ky është ai momenti perfekt)
Bijat e mia kënaqen si uliksë të kthyer në shtëpi
Diku jashtë perimetrit të gëzimit
ndiej si u shtohen dyshimet
E si të quhet vallë ky vend i mirë
kur askush s'duket i lumtur
e të gjithë me të cilët flet duan të ikin sa më larg
(përmbysjet nisin gjithmonë në periferi të vetëdijes)
Vajzat kanë arritur atë moshë
kur flasin me njëra-tjetrën tinëza prindërve
Vitin tjetër ndoshta s'vijmë dot bashkë më
Ndoshta kjo është vera e fundit kur ky det
është njësoj turkozë
si ndër kujtime të fëmijërisë
e ky diell njësoj i nxehtë
e kjo këngë gjinkallash njësoj ëndërrimtare
si isoja që paket diku në largësi

[nga jeni juve](#)

SHPELLA E ULQINAKUT

Organizatorët kishin përmendur shpellën si atraksion kryesor por, kur arritëm, na thanë se s'hynim dot brenda. E shikoni mbase edhe vetë, na thanë, që anija është tepër e madhe dhe hyrja s'e zë; m'u duk metaforë e saktë, por s'di se për çka. Kur dolëm në stere, goditëm një skaf. Ndërsa turistët polakë po lahashin, ne u bëmë drugëz që përshkonte cohën blu të Jonit, duke lënë pas vrushkuj fijesh të lara shkume nëpër avlëmend të ujtë. Diell e valë. Nando italian i ua la drejtimin vajzave dhe, ndërsa hidhte nganjëherë sytë te timoni, zuri të rrëfejë historinë e vet. Mall e mërgim. Në anë të skafit stërpikat sajoni një ylber të vocërr që na ndiqte si këlysh lotësh. Shpella e detarit ulqinak ndodhej te Kepi i Gjuhëzës, në fund të siudhësës që dikur quhej Gadishulli i Rrufeve, por që sot mban emërtimin Karaburun. Hundë e zezë. Në dorën e regjur të Nandos, skafi hyri brendë me thjeshtësi elegante, si liburnë lashtësie. Ngadalë, si pilgrimë në procesion solemn. Heu. Poshtë nesh, një sy ekliptik bluje të akullit, dhjetë metra thellësi. Lart nesh, shpendë kureshtarë duke endur një rrëfim stalaktitësh. Notre Dame. Kur po largoheshim nga andej, mbasi ishim pagëzuar në altar perëndish, askush nga ne s'kish gojë të fliste. Nano italian i zuri të nanurisë në gjuhë të vet, diel e vallë, mall e mallëngjim. Këlyshi i lotëve



na ndiqte nëpër Jon. Ne ishim drugëz që përshkonte cohën blu të Jonit, vrushkuj fijesh të shpëlara shkume nëpër avlëmend të ujtë mbas nesh. Organizatorët kishin plotësisht të drejtë. Shpella e ulqinakut vërtet s'duronte anije të mëdha. Ajo do që vdektarët t'i qasen të përkorë, ngadalë. Si pilgrimë në procesion.

[sa do të rrini](#)

SAZAN

Shoqëruesi kish hyrë vërtet në rol.
"Në kohën e diktaturës këtu ishte një bazë e flotës
ku rrinin nëndetëset tona. Kishte shkollë
për fëmijët e oficerëve, një teater, e vinotekë."

Ishulli i pabanuar na vështronte
nga njëmijë sy të gërryer dritaresh të errëta;
na këndonte me njëmijë gjinkalla.
Ato u kishin kënduar të njëjtën këngë ilirëve,
grekëve, romakëve, princave arbër, venecianëve,
osmanëve, francezëve, anglezëve, italianëve.
"Kujtoni fundin." "Çdo lavdi mbaron me ne."
Asnjë syresh s'ua kish vënë veshin.

"Sazani është i vetmi vis shqiptar
me klimë nëntropikale", thonte shoqëruesi.
Unë ngel me rezerva për shtetësinë e pemëve.
Por dielli, deti dhe njëmijë gjinkalla
mbanin iso.

[a ju pëlqen më shumë këtu a atje](#)

ERA ÇAM

"a ma jep një çik atë deodorantin se më vjen erë çam"
- dëgjuar në Vlorë, anno 2022

1.
erë çam
erë djerse e gjaku të freskët që ende bujis
nga damarë të hapur

erë gjenocid

2.
e pra dikur kundërmonim sapun ulliri nga banjat publike
në janinë
e aromë mëndafshi e parfumes nga arta
erë boje pergamenti e librash të vjetra në skolitë tona

erë deti ndër portet

dikur qemë gjindja më urbane në këtë gadishull të nëmur
pothuaj gjysma prej nesh rronim në qytete

bashkëjetonim përditë nëpër lagjet tona
me frëngj vllahë turq arabë persianë çifutë anglezë
ndërsa pampurët na sillnin lajme të mrekullishme
nga Egjeu i gjerë e nga Joni jonë

erë limoni tek bujtinat në filat erë portokall
erë bredhash nga mal i kurrilave në sarajet mbi ajdonat
nga mal i shtizës atje lart mbi pargë
erë pishash

(sot ajdonatin e quajnë paramithi)

3.
erë grurë katundet tona erë miell
pesëdhjetë mullinj bluanin përditë vetëm në prevezë
se aty kishim 175 fshatra

në filat 68 në magëlliç 76
në ajdonat 64

tash ua stërkeqin emërtimet:
livadhia lekoures lakres malsis toskes liopes
kalouresis giomaris poules
gouresis gourakoukis gourabardis goursi
gestenia molia dardis
kriesis krouia krouiasis krouiabardis
lioumi lioumibardis lioumises likenis
lekouris
giakis

4.
një ditë na dëbuan zbathur
pasi na grabitën nga gjithçka pos gjuhës e emrave
çobanë gdhë e priftërinj idhnakë

kishin vendosur të sajojnë një vath gjigant
pa larmi ngjyrash e gjuhësh të bezdisshme qytetesh
ndaj na masakruan e na dëbuan të tërë
shqiptarë vllahë sllavë turqi persë arabë arumunë
çifutët gjer tek i fundi

katundin që krijuan e quajtën krenarisht "qytetërim"

5.
erë shkrumb
mure tulla çati trerë të rëna
në flakë

çirrije fëmijësh
erë kurmi nga prindër që kalben
ndanë përrënsh

djersë e gjak kutërbonte kush mbijetoi
gjer këtu

6.
më vonë na fajësuan edhe tanët
si vegël të djallit

ndonëse djallin s'ua sollëm ne
atë e gjetëm këtu midis jush

7.
erë çam
erë gjaku të valë që ende bujis në truma
nga damarë të hapur

erë gjenocid

8.
por dikur kundërmonim sapun ulliri nga hamamet e
janinës
e aromë mëndafshi e parfumes nga arta
e erë limoni nga serrat në filat e në margëlliç erë portokall

e erë grurë nga mbanin katundet
e portet erë det

9.
vallë fryn ende era jonë
nga mal i kurrilave mbi ajdonat e në mal të shtizës
atje tej mbi pargë

[a ju mbaruan ditët a](#)

PRISHTINË

Ky është qytet dashurish të ndërlikuara.
Gjatë luftës këtu e donin guerilen me afsh
nëpër kafene të mbushura deng.
Kafenetë u zbrazën vetëm kur e grahën klientelën
gjer matanë kufirit, ashtu si grahen bagëtitë.
Me britma, e me goditje të herëpashershme.
Pas luftës u kthyen e gjithë klientela dalë-ngadalë,
si bagëti që e ka mësuar rrugën e shtëpisë.
Sot kafenetë janë prapë të mbushura deng.
Edhe kjo ndoshta quhet fitore.

[mirupafshim bashkatdhetarë!](#)

AEROPORTI ADEM JASHARI

Para nisjes, na kanë ndërruar oraret e fluturimit
pesë herë rresht. Asgjë e re,
mërgimtarët janë mësuar me jetë interesante.
Aeroportet janë bisha që na kafshojnë
rregullisht, si gjahtohen buajt në vada ujërash.
E ne presim durueshëm, të zënë rob
prej emrash të mëdhenj.

Fletë xhami

Qofsha vargu i parë që poetët shkruajnë për dashurinë.

Jeta ime, lule e mbirë nga farë e humbur.
Përshatje, nëna ime, ti më rrit mua.
Pritje, njerka ime, ti më njerizon mua..
Shtatë vite, shtatë kodra larg, shtatë male fshehur.
Ne, me sa vërtetësi, luajmë lojën kukafshehtas?

Dielli m'i hap sytë. Hëna më ndan hije-hije. Vetmia bëhet më pak shterpë.

Depresion. Adoloshencë. Shndërrimi vajzë-grua.
Turpi nga trupi.
E di se nuk isha unë, ishin traumat e tyre të fëmijërisë.
Mendja ime e zonja për të afruar njeriun e lënë pasdore.
Ndizen e shuhen cigaret një mbi një. Një mbi një. Një mbi një.

Prindër të kuptueshëm. Kërkojnë të zakonshmen:
Punë, martesë, fëmijë.

Të tjerët janë të egër. S'tregojnë kurrë ç'kërkojnë nga unë.
Zot! Fytyrën e kujt ma ke mveshur
që asnjë buzëqeshje s'më rri?

Dikur më blenë kukulla.
Nuk qe e lehtë derisa mësova t'i vesh,
t'i ushqej, t'i vë në gjumë.
Unë dhe nëna u shkrimë në një.
Qosheve u jepja gji...

Pastaj poezia erdhi përpara shkronjave.
Jo ajo nuk më erdhi me moshën,
Por me varfërinë.

Poezia. poezia. poezia.
Vitet ikin. Ikin. Ikin.

Plaken njerëzit. Ikin. Ikin. Ikin.
Drunjtë priten. Priten. Priten.
Shpërngulen njerëzit. Shtegtojnë. Shtegtojnë. S'kthehen.
Ëndrën e vendit të largët jetojnë.

Unë pres. Pres. Pres.
Çuditërisht më mua koha më mjafton,
se macja më vjen nën këmbë, mjaullon,
vazhdoj e përgëdhel sa ëndërrimet na zëvendësojnë.

Bota vazhdon lojën me kukulla...
Shoqëria jeton ëndërrat. Këtë lus!
Vijnë njerëz, vërshojnë si lumë,
pikërisht kur vetminë e kam pranuar,
pyesin se a më duken të depresionuar.
Më bëjnë të besoj se të njëjtit mes veti tërhiqen.
Qesh. Eh, jeta e këtyllë. E këtyllë. E këtyllë.
Pastaj ata ikin. Shërohen nga heshtja ime. Unë jam njësoj.
Po njësoj.

Ditëlindjet vijnë ikin. Ikin vijnë.
Njësoj. Vec dy-tre lot asgjë më shumë, asgjë. Poezi poezi
poezi.

Kam ndryshuar që atëherë. Sigurisht duhet të kem
ndryshuar.
Arrat u prenë të gjitha. Shtëpia e vjetër u prish.
Kukullat gjej sa herë kërkoj ndonjë rrangallë të vjetër.

Shumë luleve ua humbëm farën.
Nëna s'e pranon që s'mundet ta fusi perin në gjilpërë.
Thotë se drita është dobësuar.
Babai i humbi të gjithë dhembët. Tani duket i penduar.
Se kush gëzon që jeta ik? Se kush u ngop? Më thoni kush u
ngop?

Takime me shoqërinë. Fëmijë. Nuk hanë. Barkqitje.
Kokëdhimbje.
Dielli s'na rrit më, po na plak. Po na plak. Na plak.
Ende pa u ngopur me fëmijërinë. Duhet të rikrijomë të
tjerë. T'i bëjmë njësoj si ne. Njësoj.

Qofsha jashtë kësaj loje. Jashtë, larg, zhdukur.
Kukullat e mia më me shumë dëshira se sa unë.
Unë mbes vargu i parë dhe i fundit
i poetit që urren poezinë e dashurisë.
A më pak se kaq, më pak. Ik... ik... ik...

**Refren i vetmisë**

Dhe vazhdoj të të kujtoj,
si refren të pashkëputur,
si gur unaze të humbur,
si yll që e pash teksa shuhej.

Lulet harrova t'i ujis,
gjetet binin nën kokë,
prisja të m'i mbulonin duart...
dhe vjeshta, e nesërmja ime,
që ma çelte rrugën drejt kolovajzës
ku më luhate kujtimi yt.
Lulet mbetën të thara midis fletëve të librave
ku dikur rrëshqiste syri yt, zëri im.

Vazhdoj të pres ndoshta do të dëgjoj hapat e tu,
se ti do të vish për të marrë atë që le tek unë.
Kohën, lëkurën, buzët, thonjtë, shikimin
dhe dorën tënde kur m'i vendosje flokët prapa veshi.
Por më mirë që ti nuk vjen,
qesharakë do të dukeshim në sytë e njëri-tjetrit.
Si bëhemi se harrojmë atë që djersët na pi?

Dhe nën zë
fillohet të këndohet
kjo këngë me vjeshtë që më përkund,
ndrisin yjet larg qiellit tim
në qiellin tim këputen cepa dhe më ngulen në krahëror,
në këtë refren të pashkëputur vetmie,
këndoju a qaj nën zë, jetoju.

Histori njerëzore

Kulmi i pjekurisë sime
qenka i barbartë me pendesën
e pritjes së momentit
që tani s'është më i rëndësishëm edhe po të vijë.

Kaq vite kalojnë
dhe vetja ime e pamatshme me asgjë,
e pangjasueshme me asnjë,
e rrënuar që në filizin e parë.

Përse?

Flasin histori, rrëfejnë histori,
se ju duket interesante narcizi që mbytet në lum
dhe unë trishtohem se jam ai,
se meduzës iu pre koka dhe çmendem se unë jam ajo...
Unë. Unë. Unë.
Ç'thellësi shoh brenda shpirtit tim,
që nuk i njoh dhe druaj se do të vdes pa mundur t'i prek.

Dhe nuk është frikë kjo që kam,
nuk është turp ky që kam...
E mbase, mbase është sëmundje
që të më falni,
veç fjala ma shëron.

Se si është nata pa ty

E si mund të jetë nata kur ti mungon?
Kthehet aty kur dita akoma s'qe krijuar.
Përse mua më duhet të dëgjoj të lehurat e qenve
e ta shoqëroj dhe hijen që u ik atyre?
Dhe ai fëmijë përse qan atje? A fle nëna e tij?
Kush të i jetë afruar pranë,
se fëmija e i dashuruari bien pre e lojrave...
Përse e pash ëndërrimtarin të mbete jashtë derës së qelqtë
dhe as trokitja, as hija nuk i përkisnin më atij?

Oh, sa e ftohtë është nata kut ti mungon.
Bëhem përgjuesja e çdo mëkati,
dëshmitarja e çdo djalli.
Shoh hijet e magjistricave që lahen mbi varre.
Dhe i shikoj se si mëngjeseve qajnë për fatkeqësitë e botës.
Dhe era rrapëllon me grushta dritaren.
E sikur këmbët të të zvarriteshin nëpër këtë dyshemë
do të isha e fjetur në lëkurën tënde,
cepat e yjeve do t'i kisha puthur në mbarimin e syrit tënd.
Dhe dritarja i përhaset erës në kurriz.

Nata, oh, sikur të qe veç nata në gjithë këtë vetmi,
por është vetmia në gjithçka që krijohet,
thërime bëhen mendimet. Pa nisur përfundojnë në shijen
e qenësisë tënde.
Në çdo mendim, ti je shpërqëndrimi i tij.

Oh, si mund të jetë nata veç natë kur ti mungon,
kur është pika e zbulimit të botës,
dhe pa ty asgjë s'ka formë, asgjë.
Më lër veç të fshihem në këtë kaos të heshtur.
M'i vendos duart si nënkresë... të flej, të flej pak me
mungesën tënde.

E përjetshme

Nuk e dija
që do të vija këndeju
dhe s'do kënaqem me asnjë ditë të jetuar.
Do të ngarend për mësimin e njëfarë të vërtete
e cila mund t'jetë lojë e mendjes sime.
Nuk e ndjej të domosdoshme
të përkas këtu a dikujt.
E kam ditur që prindërit mua më përkasin,
dhe asesi e kundërta.
Që gjuha dhe dora janë zotëruesit e mi.
Nuk hyri gjë tjetër në syrin tim
siç mund të të hynë mizat e imta
nëpër rrugët e shkreta buzëmbremjeve të verës.
Syri im qe dashuronjësi i thjeshtësisë.
Fushë me bar dhe një lis qindravjeçar midis.
Pasi dhe atë e pash në shumë metamorfoza
njësoj si e vërteta.
Ndonjëherë veç hëna arrin të më çudisi
kur tretet ndër mjegulla
e më bëhet se një ujku diku
ende pas saj ulërin.

Në thelb të çdo arti padyshim që është humanizmi. Është pikërisht kjo që i jep vlerë krijimeve artistike, shkrimeve letrare, çka është dëshmuar që nga koha e skribëve të lashtë me dorëshkrimet e purpurta. Humanizmi i tejkalon ideologjitë, utopitë, besimet fetare, madje dhe patriotizmin. Kanë kaluar 80 vjet që nga koha kur Ana Frank nisi të shkruajë ditarin e saj, një vepër po aq humaniste siç ishte ajo e Primo Levit, ditare këto të shkruara në kohën e tragjedisë së madhe që pësoi bota me nazizmin dhe holokaustin. Janë libra reference dhe ndokush mund të pyesë: Përse dorëshkrimi i asaj adoleshenteje ka prekur shpirtin e botës dhe është botuar në 70 gjuhë të huaja, në masën e 30 milionë ekzemplarëve. E gjen atë libër në biblioteka, në shtëpitë e njerëzve, e gjen në adaptimet teatrale, filmike, pikturale apo radiofonike, në produktet e shumta kulturore. Dhe përsëri mund të pyesësh: Përse kjo vepër është kaq e dashur dhe 80 vjet pas holokaustit. Dhe përgjigja është se në themel të atij dorëshkrimi, kjo histori ishte një nga shëmbujt e mëdhenj të humanizmit. Madje Primo Levi do të thoshte për këtë libër se “*faqet e tij të prekin më shumë se sa vetë viktimit*”. Kaloj në Champs Elysées të Parisit dhe posteri me fytyrën e Ana Frankut është ngado nëpër kioskat e gazetave dhe revistave. Afrohem dhe e shoh nga afër, një moment të gjatë, vështroj atë fytyrë melankolike, të brishtë, me dy sy të zinj dhe një butësi të jashtëzakonshme, çka më çon shumë vite më parë kur me Omer Kaleshin, i cili sapo kishte hapur një ekspozitë pikturash në sallonin e ambasadës shqiptare në Amsterdam, një ditë në u ndalëm dhe tek shtëpia e dikurshme e Ana Frank në strehëzën e fshehtë të saj. Sapo kishim lënë kishën protestane Westerkerk ku ishte vendosur varri i Rembrandit dhe shumë shpejt u gjendem në rrugën plot pemë që fëshfërinin nga një fllad i bukur në 263, Prisenegracht, një shtëpi tre katëshe që tashmë ka hyrë në historinë e botës. Otto Frank, babai i saj, i vetmi i mbijetuar nga tetë ata banorë të fshehur në atë vend, nuk e kishte menduar kurrë se prapa asaj porte të fshehur, maskuar me një faqe biblioteke, do të shkruhej një libër që do ti fliste aq shumë botës.

Me ardhjen e nazizmit, familja Frank u largua nga Frankfurti i Gjermanisë dhe u vendos në Amsterdam, me shpresën se atje do ishin të qetë nga progromet naziste që kishin nisur ndaj hebrevjeve në Gjermani. Por me pushtimin e Hollandës në vitin 1940, jeta do të merrte një tjetër drejtim. Si tregëtar që ishte dhe sipërmarrës i shoqërisë Opteka, bashkë me ortakun e tij Pels, në korrikun e vitit 1942, dy familjet u fshehën pas asaj porte që Ana do e quante “Aneksi” në ditarin e saj (“Achterhuis”, në hollandisht) portat e së cilës do të hapeshin vetëm kur do të vinte ti gjente Gestapo, një ditë gushti të vitit 1944. Kjo shtëpi tashmë është kthyer në muze. Aty janë pjesët e fshehura, aty mund të shohësh imazhet e projektuara të banorëve të asaj bote të fshehur, duke imagjinuar jetën e tyre në heshtjen e plotë, në një kohë që jeta për hollandezët jashtë, në dritën e diellit, vazhdonte normalisht. Kush ka lexuar *Ditarin* e Ana Frankut dhe ata janë të shumtë, ka udhëtuar pikërisht në këtë botë të përshkruar thjeshtë nga një vajzë e re, e cila ndër të tjera kishte shkruar: “*Të ngasësh biçikletën, të kërcesh, të fërshëllesh, të zbulosh botën, të ndjesh rininë, ja çfarë ëndëroj, por ndërkohë s’duhet të tregoj asgjë nga këto, pasi le të imagjinojmë një cast nëse që të tetë ne që jemi brenda të ankohevi dhe të tregohemi fatkeqë. Atëherë çdo të ndodhte me ne?...*” Dhe kështu jeta vazhdonte. « *Kam frikë se do na zbulojnë dhe do na pushkatojnë* » shkruan ajo në shtatorin e atij viti... Të gjithë kanë frikë. Zhurma më e vogël që vjen nga pjesa tjetër e ndërtesës ku janë punonjësit e shoqërisë bën që zemrat e atyre njerëzve të ngrihen në

(Tetëdhjetë vjet pas fillimit të shkrimit të Ditarit nga Ana Frank)

NESËR, “DITARE” TË TJERA DO TË LEXOJMË NGA ANA FRANK

nga Luan Rama

ankth me pyetjen e madhe: Po tani, çdo të ndodhë me ne? « *Në Hollandë po ndodhin gjëra të tmerrshme. Por çfarë i pret ata njerëz që i çojnë në vende të largëta? Mendojmë se shumicën e tyre i masakrojnë. Radio angleze thotë se ata i asfiksojnë përmes gazit. Si duket kjo është metoda më e shpejtë e eliminimit të tyre...* » Më pas ajo shton: « *E dashur Kitty, kam veçse lajme të kësqia për të të dhënë. Mijtë tanë dhe të njohur të tjerë hebrej i marrin me grupe dhe Gestapo i transferon në Westerbok ku me vagona kafshësh i çojnë drejt kampit të hebrevjeve në Drenthe. Ai vend duhet të jetë e tmerrshëm sepse njerëzve nuk u japin asgjë për të ngrënë...* » Ana shkruante për ditët që kalonin, peizazhe të fjalës dhe të banorëve, brenda atyre dy dhomave të vogla, mes frikës se mos papritur dera troket: Otto, ati i saj me një fjalor pranë tij që lexon një libër të Dickens, çifti Van Daan që grindej, zozja e tij që hidhte nganjëherë vështrime jo dashamirëse, darkat e përbashkëta, librat e saj të dashur të Gëtes dhe Shjlerit, dëgjimi i “Radio Londra”, biri i çiftit Van Daan, Peter i heshtur, me të cilin ajo kishte dëshirë të uleshin në një shkallare dhe të putheshin për të ndërjet dëshirat e para të një vajze të njomë, copëza jete përshkruar me një ndjesi të jashtëzakonshme. Ana Frank nuk heziton të shkruajë dhe për menstruacionet e para të saj, për prostitutat që kishte vështruar duke u zhdukur bashkë me to, për shtëpitë publike si në Paris, duke shtuar se dhe i ati i saj kishte qenë në to. Këtyre banorëve, Ana u ka vendosur pseudonime të ndryshme duke menduar se mos ditari binte në dorë të tjetërkujt. Nëna quhej Nora, Ana vetë kishte pseudonimin Anne Aulis Robin, e motra, Margot, quhej Betty Aulis Robin... ndërsa ditarin e saj e ka quajtur Kitty, duke iu drejtuar si ti drejtohej vetvetes apo një

shoqeje tepër intime, një personazhi të dyzuar, siç shkruan që në fillim kur nis ditarin e saj më 12 qershor të vitit 1942, çaste kur tashmë ata janë të fshehur: “*Shpresoj se do mund të të besoj shumë gjëra çka nuk mund ta bëj me askënd tjetër dhe uroj të më jesh një mbështetje e madhe*”.

Atë ditë në shtëpinë e Ana Frankut në krah të Omerit, tek vështroja projektimin e fotografive të Anës, fytyrën e saj herë të qeshur e herë të trishtë, shkrimet e saj, bllokun me kuadrat e kuqe, fotot e saj fëmijë, në shkollë apo diku në një tarracë ulur në një shezlong, mendova në çast atë pasazh të ditarit që kisha lexuar vite më parë, atë çast kur një mbrëmje, buzë dritares, ajo dhe Peter, ai djalë i heshtur, vetmitar dhe i brishtë, shikonin yjet dhe bisedonin për jetën. Ishte një nga ditët më të lumtura të saj, edhe pse me Peter shpesh ajo sillej ashpër dhe për këtë qëndrim, më pas qortonte veten. Bisedonin zëulët dhe unë risolla në mendjen time atë dialog të bukur adoleshentësh:

“*Besoj se para se të thoni “natën e mirë” ju jepni gjithnjë një të puthur? - Një puthje? - Shumë puthje do të thuash... jo ti besoj? - Jo, praktikisht unë s’kam puthur askënd ndonjëherë! - As për ditëlindjen tënde? - Ah, po, kjo është e vërtetë...*” Dhe ata vazhdonë të bisedojnë për botën jashtë, natyrat e tyre të ndryshme, për brishtësinë e tij dhe mënyrën shpenguese të saj. “*Ti me ke ndihmuar parreshtur! - më thotë papritur ai. - Duke bërë çfarë? - e pyeta e habitur. - Nga mënyra tënde e gëzueshme... Padyshim ishte gjëja më e bukur që më tha dhe se ndryshe nga herët e tjera unë mendoja të mos e shqetësoja atë duke i shkruar pranë, por përkundrazi, ai e donte këtë!...*”


Ana shkruante bukur. Ishte shpirti i saj që fliste, pjekuria e parakohëshme e



saj. Ajo është e ndjeshme dhe pikërisht ai vend i fshehtë ku s’mund të shohë botën jashtë veçse fshehurazi nga dritarja, i jep një forcë të brendshme, i jep një poetikë të mrekullueshme, e bëjnë atë të mënçur, e rrisin në moshë, madje e bëjnë të zbulojë thellësitë e shpirtit human apo të kuptojë më mirë raportet njerëzore, dilemat e jetës, familjen. “*E dashur Kitty. Askujt në botë nuk mund ti shkruaj gjëra mbi veten time dhe nderat që provoj, përveç teje. Pse të mos flisja dhe diçka për çështjet seksuale? Prindërit dhe njerëzit në përgjithësi kanë qëndrime të ndryshme mbi këtë gjë. Në vend që tu thonë diçka vajzave si dhe djemve të tyre që nga moshë 12 vjeçare, kur flasin mes tyre për gjëra të tilla prindërit i largojnë fëmijët nga dhoma dhe kështu fëmijët s’kanë rrugë tjetër veç ti zbulojnë vetë me rrugë të tjera... Ajo çka bëjnë një burrë dhe një grua është instinkti im që më flet...*” 18 mars 1944). Por shpesh është ankthi që e kap Anën për fyti. Ditët janë të trishta. “*Çdo ditë marr valerian kundër ankthit dhe depresionit, por kjo nuk më pengon të jem në një gjendje akoma më të rëndë ditën tjetër. Një shpërthim të qeshuri do kishte me efekt se dhjetë hape të tilla, por ne këtu në fakt kemi harruar të qeshim. Nganjëherë kam frikë se mos fytyra ime deformohet nga trishtia dhe goja do detyrohet të ketë hije serioze...*” (16 shtator, 1943).

Lufta vazhdon, ndërkohë që Ana vazhdon të tregojë historitë e jetës brenda mureve të pakapërcyeshëm ku të gjithë flasin me zë të ulët, këndojnë rrallë e me zë të ulët, qajnë me zë të ulët, duke ëndërruar netëve të errta jetën, ditë që shpresojnë të vijjnë. Ana shkruan për maçokun e saj të dashur që i ngjeshet më parë dhe që tashmë nuk e ka më. “*Maçoku Moortje më mungon çdo çast dhe askush nuk e di se sa shumë mendoj për të. Dhe shpesh herë qaj. Është shumë i mirë dhe e dua shumë. Ëndërrroj llojlloj mënyrash për ta sjellë përsëri tek unë...*” Ajo kujton gjithashtu stilografin e saj të shtrenjtë, dhuratë dikur nga gjyshja e saj, stilografin me këllëf të kuq që çdo mbrëmje e merrte të shkruante. Tashmë nuk e ka më. Mban mend që një ditë më parë e kishte me vete kur nisi të qëronte patatet. Vallë e ka hedhur bashkë me lëkurat e patateve në zjarrin e sobës apo do kishte rënë diku tjetër? Të nesërmen, ishte i ati që pastroi sobën dhe gjeti atë çka kishte mbetur nga ai stilograf me majë floriri që siç shkruante ajo “*ishte gjëja më e çmuar që kishte. Kam vetëm një ngushëllim, edhe pse i vogël. Stilografi im u dogj siç do dua dhe unë më vonë të digjem...*” E trishtueshme të shkruhet kjo nga një vajzë 14 vjeçare.

Në 13 janar 1943, ajo shkruante: “*Jashtë ndodhin gjëra të tmerrshme. Natën dhe ditën njerëzit e shkretë i rrëmbejnë me forcë, ashtu pa pagazhe, veç me një trastë në krahë dhe pak para. Madje plaçkat që kanë ua flakin gjatë rrugës. Familjet shpërbëhen, burrat, gratë, fëmijët ndahen nga njëri-tjetri. Kur fëmijët kthehen nga shkolla nuk gjejnë më prindërit e tyre... Të gjithë kanë frikë. Dhe*



natën, me qindra avionë fluturojnë mbi Hollandë. Duket egoiste kur ne flasim për "pas luftime", kur ne ëndërrojmë për rroba dhe këpucë të reja, ndërkohë që do duhet që çdo qindarkë ta vendos mënjani dhe ta ruajmë për njerëzit e tjerë të pas luftës, për të shpëtuar atë çka mundemi... Mund të të flisja me orë të tëra ditari im, për mjerimin që shkakton lufta dhe kjo më trishton akoma më shumë. Nuk na mbetet veç të presim sa më qetësisht të jetë e mundur fundin e këtyre fatkeqësive. Hebrejtë dhe të krishterët, si dhe mbarë planeti presin, e shumë prej tyre presin veç vdekjen. Gjithë të mirat. Ana."

Megjithë gjendjen e rëndë shpesh Ana dëshmon për humorin e saj, përshkruan situata komike, mënyrën si flë i ati, si gërhet, apo si flë me motrën Margot "shypur si sardelet." "Mbrëmë pyeta Margot nëse isha e shëmtuar, por ajo më tha se unë isha e këndshme, se pëlqejta të bëja humor, se kisha sy të bukur, disi të vagëta... a thua?" Një çast tjetër ajo kujton nënën e saj, kur natën i shkon tek krevati për ta marrë në shtratin e saj, por ajo nuk pranon dhe pak më vonë shkon në shtratin e të atit, dhe këtë ajo e quan një mëkat.

Liria afrohet. Në praverë të vitit 1944 duke dëgjuar Radio Orange (Radio Londre), komentatori thotë se njerëzit duhet ti shkruajnë dëshmitë e kësaj kohe që pas luftime ato të botohen dhe që historia të shkruhet përmes përjetimeve njerëzore. Atëherë Ana mendon që ditarin ta rishkruajë, ta rikthejë në një roman, ndërkohë që shkruan plot mbresa të tjera të veçanta dhe që kanë të bëjnë me kohën para luftime. Më 5 prill 1944 ajo shkruan : « Vallë a do mund të bëhem ndonjëherë gazetare apo shkrimtare ? E shpresoj shumë këtë gjë, pasi përmes shpirtit tim unë mund të dëshmoj, të shënoj mendimet e mia, ideat dhe frutet e imagjinatës time. » Dhe më pas, një tjetër ditë shton: "Mendoj se do të ishte interesante nëse do ta botoja librin tim « Aneksi ». Kjo do të ishte diçka interesante për njerëzit, të cilët do të mësonin se si kemi jetuar këtu ne hebrenjtë..." Pak përpara se të zbuloheshin nga Gestapo, dora e saj ka shkruar: " Vështroj se si dalëngadalë bota po transformohet në një lloj shkretëtire, dëgjoj fort e më fort zhurmën e një shtrëngate që po afrohet e do na vrasë edhe ne, ndëj vuajtjen e miliona njerëzve e megjithatë, por kur vështroj qiellin, mendoj se gjithçka do të ndryshojë, se mizoria do të marrë fund, se qetësia dhe paqja do mbretërojnë mbi botën tonë..."

Ana shkruan për luftën, për botën e mirë dhe mizore, për fjalimet e Curçillit dhe librin për jetën e Galileut që i pëlqen aq shumë, mediton për mitet e vjetra të antikitetit, për Tezeun, Edipin, Orfeun, Jasonin dhe Herkulin, shkruan për avionët që bombardojnë dhe lëvizjen e trupave si të ishte një kroniste, edhe pse është e ngjuar brenda katër mureve. Në mbrëmje, të gjithë mblidhen pranë radios për të dëgjuar lajmet e frontit. Shpresojnë. Ngrejnë flamujt e padukshëm brenda zemrave të tyre, shpresojnë. Data 1 gusht 1944 është data e fundit që shkruan në ditar dora e saj. Ajo përshkruan mirësinë që ndjen brenda shpirtit të saj, të cilën shumë pak ia njohin të tjerët. Dhe ajo ka besim në botën e saj, në dashurinë për njerëzit dhe botën. Të ngjan si një filozofe edhe pse është 15 vjeç! E jashtëzakonshme Ana Frank. Ç'shëmbull i bukur i botës së qytetëruar edhe kur kjo botë është në ditët më të zymta të saj, në kohën e mizorisë dhe të holokaustit.

Kështu, në 4 gusht 1944, « Aneksi » siç e quan ajo atë vend të fshehtë, zbulohet. Dikush, nga ata të shoqërisë ngjitur, i ka denoncuar. Në orën 10 policia gjermane "Grüne polizei", i merr të gjithë. Në 8 gusht ata gjenden në stacionin e trenit të Amsterdamit. Më pas është rruga drejt kampit famëkeq Auchwitz... Dhe padyshim, Ana e ndjente mungesën e ditarit të saj. Vallë e kanë gjetur? Vallë e kanë djegur?

Jo, ajo s'do të shkruante më. "Kitty" do ti mungonte shumë. S'do të mund ta përshkruante atë udhëtim të gjatë, mbyllur në një vagon mallrash, pa bukë, pa ujë, duke parë nga një dritare e vogël me hekura qiellin e vrenjtur e të lagësht, plot gjëmime bombash të atij udhëtimi pa kthim. Pas atij kampi të tmerrshëm, Ana dhe Margot transferohen në kampin tjetër të Bergen-Belsen. Gjermania naziste po binte. Kur në Bergen-Belsen prisnin ditën e lirisë, një mbëmje, e lodhur nga tifo, Margot u shemb nga krevati dhe vdiq. Ana jetoj dhe disa ditë më pas dhe u shua po nga tifo. Ajo nuk arriti ta shohë dritën e lirisë, të shëtiste me biçikletë rrugëve të Amsterdami, të dashurohej me Peter, të ndjente flladin e rrugës, duke shpresuar botimin e ditarit dhe librit të saj « Jeta e Cady-së », me një histori dashurie. Kur Otto Frank u kthye nga kampi, ai e kuptoi se nga të tetë banorët e atij vendi të fshehur vetëm ai kishte mundur të shpëtonte. Mikesha e tij hollandeze dhe bashkëpuntorja e ngushtë Miep Gies, i dorëzoi dorëshkrimin e Anës, që kishte mundur ta merrte menjëherë pas arrestimit të tyre dhe bastisjes së shtëpisë. Imagjinioj tani Otto Frank duke lexuar atë ditar me duart që i dridhen, në trishtim më të madh, atë ditar të shkruar në një kohë holokausti, duke zbuluar shpirtin e madh të Anës, duke zbuluar një vajzë tjetër të cilën ai, i ati i saj nuk e kishte arritur ta njilte si duhej, bota e së cilës tashmë po e mahniste. Ana e dashur nuk ishte një adoleshente 15 vjeçare që u shua në kampin e përqëndrimit. Ana ishte një inteligjencë e përkryer. Disa fragmente të ditarit ai i hoqi. Nuk donte që të mbeteshin kritikak e Anës për nënën e saj, grindjet mes banorëve të atij vendi të fshehtë. Kur libri botohej në Amsterdam, Otto ia dërgoi dhe një botuesi amerikan, i cili me lehtësinë më të madhe gjykoj se ai libër ishte thjesht ditar i një adoleshenteje me përshkrime të rëndomta, pa parë në të simbolikën e madhe të jetës së një familjeje në kohën e holokaustit. Dukej se ky botues nuk e kishte kuptuar në thellësi se çdo të thoshte flama naziste, pa kuptuar humanen që ishte brenda njeriut dhe në mometet më ekstreme të ekzistencës së tij. Përse vallë kjo histori vlerësohet kaq shumë edhe tetëdhjet vjet pas fillimit të shkrimit të tij, shkruar nga një e panjohur që kurrë nuk ishte sprovuar në aventurën letrare. Vlera e librit padyshim qëndronte në atë se historia e familjes së saj ishte një histori universale. Të përshkruash botën tënde të zakonshme kur të mungon liria është gjithnjë një histori tronditëse, pasi humbja e lirisë është humbja më e madhe që mund ti ndodhë një njeriu.

Sot që shkruajmë për ditarin e Ana Frankut, mendja na shkon menjëherë në gjithë ato vende të fshehta, bunkerë uzinash e fabrikash, ku ukrahinasit e thjeshtë, burra, gra, fëmijë, u fshihen mizorive dhe barbarisë së një mareshalli tjetër, të përngjashëm me Hitlerin, i cili quhet Putin. Nesër me siguri do të lexojmë të tjerë ditarë të dhimbshëm, të adoleshentëve, të rinjve e grave të Mariupolit dhe gjithë Ukrainës që jetuan apokalipsin e çmendurisë vrasëse dhe të shuarjes se llojit njerëzor ; do të lexojmë ditare të tjerë shkruar nën hijen e bombave, nën peshën e barbarisë. Ja pse Ana Frank na është e çmuar edhe sot: ajo, si shkrimtarë të tjerë të mëdhenj, na hapi rrugën për të rënë kambanës kundër barbarisë dhe për tu ngritur kundër saj! Po, nesër do të lexojmë ditare të tjerë të Ana Frankut siç shkruante ajo: « Dalëngadalë bota po transformohet në një lloj shkretëtire, dëgjoj fort e më fort zhurmën e një shtrëngate që po afrohet e do na vrasë edhe ne, ndëj vuajtjen e miliona njerëzve e megjithatë, por kur vështroj qiellin, mendoj se gjithçka do të ndryshojë, se mizoria do të marrë fund, se qetësia dhe paqja do mbretërojnë mbi botën tonë..."

Tradita dhe e sotshmja në Panairin XXI të Librit në Ulqin

(30 korrik – 02 gusht, 2022)

Për të njëzetën vitin radhazi, u mbajt në Ulqin Panairi i Librit, organizuar nga Instituti i Librit dhe Promocionit me mbështetjen e Organizatës Turistike të Ulqinit. Dhjetra botues nga të gjitha trevat shqipfolëse të Ballkanit, u bënë bashkë, jo veç njëri me tjetrin por edhe me lexues, shkrimtarë, përkthyes duke u njësuar natyrshëm nën hijen e kalasë. Diku aty ku thuhet se qe burgosur Servantesi, shihje edhe ndonjë Rosinant të lidhur, i frikësuar nga turistët që në radhë prisnin t'i shoqëronte për një resme.

Pranë Plazhit të Vogël, masivi i rërës buzë me buzë me detin ku çadrat e kashtës që jepen me qira krijojnë mozaikun e bukur me çrregullsinë e çadrave të sjella nga pushesit mbështetur në supet e tyre, aty pra, në të dy anët, stenda të bardha, si dallgë, plot me erë kripi, të reshuara ballëpërballë njëra me tjetrën, presin të ikë dielli për t'u vizituar nga të interesuarit. Bota letrare dhe studimore shqipe merr një dritësim tjetër, ndryshe nga ai i zakonshmi që i jep vapa e çmendur e Tiranës apo Prishtinës.

E kujtoj i çoroditur, si hije a vagulli, herën e parë kur mora pjesë në Panairin e Ulqinit. Nuk kam qenë më shumë se pesë vjeç, pasi lexoja me zor dhe shkronjat cirilike - vizatime alla Miro më janë dukur gjithmonë - i dalloja me vështirësi nga ato latinet. Njëra nga stendat, në dy cepat e saj, kishte të kapur tullumbacë me helium. Zonja aty, pasi u prezantua me time ëmë si botuese, ma dha njërin prej tyre. E mbahta me vete në plazh, lidhur për çadër, në restorant lidhur për karrige, rrugës në makinë lidhur te kyçi i dorës deri sa në darkë, poshtë pallatit në Shkodër, u shkëput e fluturoi tej.

Besoj, duhet të kem qarë.

"Po shkon te shkronjat," më tha gjyshja.

"Pse?" e pyeta me sytë e mbufatur nga lotët e nxehtë.

"A e din se shkronjat janë konstelacione, yje të bamë bashkë? Meqë e ke marrë te një Panair Librit, edhe tullumbaci don me shku te vendi ku përket."

E kisha harruar, deri në këtë Panair kur e pashë sërish atë zonjën botuese, tanimë mike e bashkëpunëtore, ndërkohë që i buzëqeshja në shenjë përsëritjeje.

Dita e dytë e Panairit, e shtuna, është përherë dita më e ngarkuar e tij. Edhe sivjet, në mëngjes, u bë një takim me shkrimtarin gjirokastrit Odise Kote. Në një librari tepër të veçantë, e mbushur vetëm me libra shqip, mu në zemër të Ulqinit, ku mikpritja të linte mbresa tepër këndellëse, njëlloj si edhe biseda e përzemërt, tepër e këndshme me Kote për gjithë krijimtarinë e tij, duke u ndalur më tepër në romanet "Funerali i hijes" dhe "Betimi i thyer".

Menjëherë më pas, po aty, shtëpitë botuese "Pegi" dhe "Toena" promovuan kolanat e tyre mbështetur nga programi *Creative Europe* lidhur me mënyra të ndryshme sesi kultura jonë mund t'i qaset tematikave evropiane si *skandale* apo *mirëkuptimit* të cilat me valenca lidhen me letërsinë, pikërisht nëpërmjet kësaj të fundit.

Kur erdhi darka, pas promovimit të librit "Arbëreshët, midis realitetit dhe mitit" të Fatmir Toçit, juria e përbërë nga kryetarja Arta Marku Qëndro, drejtori i Muzeut Historik Kombëtar Dorian Koçi si dhe pedagogu i universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" Ismet Kallaba shpalli çmimet që, këtë vit vinin me një risi. Përveç atyre të treve që ndaheshin zakonisht, sivjet u shtua për herë të parë edhe "Olcinium", vlerësim për veprën më të mirë studimore apo esesitike, pra *non - fiction*.

Kryetarja Arta Marku, pasi foli rreth përzgjedhjes së laureatëve, ftoi personalitetet të ndryshme për t'ua dhënë secilit syresh çmimin. Fillimisht, drejtoresha e Qendrës Kombëtare të Librit dhe të Leximit, znj. Alda Bardhyli dha për Xhahid Bushatin "Dega e Ullirit" për përmbledhjen me vjersha "Trumcak bredharak". Fituesi i vjetshëm i "Servantes"-it, Bujar Hudhri e ndau të sivjetmin për fituesin Erion Gjatollin, për përkthimin nga italishtja të romanit "Ethet" nga Jonathan Bazzi. Ndërsa Neritan Ceka i dha "Olcinium"-in Fatmir Toçit për librin e promovuar më herët.

Çmimi "Liburnia" që përherë është konsideruar kryesori i Panairit, ai i cili ndahet për prozatorin më të mirë, sivjet iu dha shkrimtarit Ridvan Dibra. Libri fitues, "Gruaja që deshe", për hir të rastësisë, një rastësi aq e veçantë, aq e bukur, aq e këndshme, një pjesë e ngjarjeve të atij romani ndodhin pikërisht në atë tarracë ku edhe u vlerësua me çmim:

Ndodh në verë, gjatë pushimeve, në një hotel buzë detit. Je ulur me Gruan në tarracën e madhe të hotelit dhe prej aty, duke gjerbur kafetë e mëngjesit, shijoni të dy peizazhin e mrekullueshëm, që shtrihet para jush. Gruaja është veshur lehtë e me shije dhe duket më tërheqëse se kurrë.

Mëngjesi është i pastër qelibar – asnjë fllorë reje në qiell – dhe premtori një ditë magjike.

Pas pak, në tavolinën ngjitur me tuajën, vjen e ulet dikush. Nuk e kishit vënë re më parë. Herët e tjera. Ose nuk kishte qenë. Me siguri. Një burrë në moshën tënde, ndoshta më i ri. Sakaq, në fraksion të sekondës, ti kap shkrepimën e vetëtimtë mes shikimit të Gruas dhe të burrit aty pranë. Tronditesh. Çoroditesh në çast. Sepse e njeh mirë këtë shkrepimë. E ke provuar, dikur, me la femme fatale. I di pasojat e një fataliteti të tillë. Më pas, qetësohesh disi dhe nis e ndjek me vëmendje lojën e shikimeve mes Gruas e burrit aty pranë. Burri është i bukur. Më i ri se ti. Edhe më i gjatë. Konstatime të tilla sikur ta rikthejnë tronditjen. Tronditjen e çoroditjen. Por vendos ta mbledhësh veten dhe të mos bësh figurë të keqe. Sidomos para Gruas. Që duket se e ka harruar plotësisht praninë tënde aty. Dhe s'rreket të fshihet ndopak, të bëhet më diskrete. Sepse shikimet e saja drejt burrit të panjohur janë krejt të hapura dhe lehtësisht të lexueshme. Tamam pors shikimet e pafajshme të fëmijës drejt një lodre, të cilën e ka dëshiruar prej kohësh. Kështu për disa minuta. Derisa vjen një çast, kur ti s'je më në gjendje ta përmbash veten. Ngrihesh në këmbë, zë Gruan për krahu dhe thua me ton të lartë: "Ikim! Kjo s'ka kuptim..."

Por ja që atë ditë nuk ikëm, sepse e gjitha kishte shumë kuptim, deri kur nata u mbyll me foton tradicionale të të gjithë fituesve bashkë. E mandej, unë si ish student i tij bashkë me profesor Ridvanin, zonjën e tij dhe botuesin tonë e disa të njohur e miq të tjerë, qëndruam deri vonë, duke kujtuar, menduar, reflektuar. "E kujtoni kur, në vit të parë të universitetit më përqeshët para klase për një status në facebook ku thoja se së shpejti do të botohej një novelë e imja?" e pyeta, pak më tepër nga vera sesa kureshtja. Qeshi, qeshëm dhe sërish, uruam fituesit, deri kur fituesit u mërztitën e, bashkë me mërzinë e tyre erdhi edhe domosdoshmëria për t'i dhënë fund asaj nate.

Andreas Dushi

Një piktor i cili i drejtohet publikut jo vetëm që t'i paraqesë veprat e tij, por për t'i shfaqur edhe ca nga idetë mbi artin e pikturës, e ekspozon veten ndaj disa rreziqeve.

Në radhë të parë, duke ditur se shumë njerëz pëlqejnë ta mendojnë pikturën si shtojcë të letërsisë dhe si rrjedhojë duan që të shprehë jo ide të përgjithshme të përshtatura me mjetet piktoreske, por veçanërisht ide letrare, kam frikë se do ta shohin me admirim piktorin që merr përsipër pushtimin e tokës së njeriut letrar. Në fakt, jam tërësisht i ndërgjegjshëm që folësi më i mirë i piktorit është vepra e tij.

Gjithsesi, piktorë si Signac, Desvallieres, Denis, Blanche, Guerin dhe Bernard, kanë shkruar mbi çështje të tilla dhe janë mirëpritur nga periodikë të ndryshëm. Personalisht, thjesht do të përpiqem të shpreh ndjenjat dhe aspiratat e mia si piktor pa u shqetësuar për shkrimin.

Por tani parashikoj rreziqet e të dukurit kontradiktor me veten. E ndiej të fortë lidhjen mes veprave të mia të hershme dhe atyre të kohëve të fundit, por nuk mendoj ashtu siç mendoja dje. Ose më saktë, ideja ime bazë nuk ka ndryshuar, por mendimet e mia janë zhvilluar dhe mënyrat e mia të shprehurit kanë ndjekur mendimet. Nuk mohoj asnjëherë prej pikturave të mia, por secilën prej tyre do ta pikturoja ndryshe, nëse do të më duhej ta ribëja. Destinacioni im është gjithmonë i njëjti, edhe pse ndjek rrugë të ndryshme për ta arritur.

Së fundmi, nëse përmend emrin e një artisti apo një tjetri, do të jetë për të treguar se si ndryshojnë qasjet tona, dhe mund të duket sikur po i nënçmoj veprën. Kështu rrezikoj të akuzohem për padrejtësi kundrejt piktorëve, të cilëve ua kuptoj mirë qëllimet dhe rezultatet, ose ua vlerësoj më shumë arritjet, dhe do t'i përdor si shembuj, jo për të vendosur superioritetin tim mbi ta, por për të treguar më qartë, përmes asaj që kanë bërë, atë çfarë unë po përpiqem të bëj.

Ajo që unë po ndjek, mbi të gjitha, është shprehja. Herë pas here është pranuar se unë kam një aftësi teknike të caktuar, por ambicia ime është e kufizuar, nuk shkon përtej kënaqësive tërësisht vizuale që mund të merren nga vështrimi i një pikturë. Megjithatë mendimi i një piktorin nuk duhet konsideruar si i ndarë nga mjetet e tij piktoreske, pasi mendimi vlen jo më shumë se shprehja e tij nëpërmjet mjeteve, e cila duhet të jetë më e plotë (dhe me të plotë dua të them e ndërlikuar), sa më i thellë të jetë mendimi. Nuk kam mundësi të bëj dallimin mes ndjesisë që kam për jetën dhe mënyrës sime të përkthimit të saj.

Shprehja, për mua, nuk qëndron në pasionet që ndizen në fytyrën e njeriut apo që manifestohen nga lëvizjet e dhunshme. I gjithë rregullimi i pikturës time është ekspresiv: vendi i zënë nga figurat, hapësirat boshe rreth tyre, proporcionet, çdo gjë ka pjesën e vet. Kompozimi është arti i rregullimit në një mënyrë zburuese të elementeve të ndryshme nën urdhrin e piktorit për të shprehur ndjenjat e tij. Në një pikturë, çdo pjesë do të jetë e dukshme dhe do të luajë rolin e caktuar, qoftë kryesor apo dytësor. Çdo gjë e padobishme në pikturë është, siç duket, e dëmshme. Një vepër arti duhet të jetë harmonike në tërësinë e saj: çdo detaj i tepërt do të zëvendësojë një detaj thelbësor në mendjen e spektatorit.

Kompozimi, qëllimi i të cilit duhet të jetë shprehja, modifikohet sipas hapësirës që do të mbulojë. Nëse marr një letër të një përmase të caktuar, vizatimi im do të ketë marrëdhënien e nevojshme me formatin e saj. Nuk do ta përsëris këtë vizatim në një letër me proporcione të tjera, si për shembull, drejtkëndësh në vend të katrorit. As nuk duhet të jem i kënaqur me një zmadhim të thjeshtë, nëse më duhet ta transferoj vizatimin në një letër me të njëjtën formë, por dhjetë herë më të madhe.

HENRI MATISSE, "SHËNIMET E NJË PIKTORI", 1908



Një vizatim duhet të ketë forcën zgjeruese e cila i jep jetë gjërave rreth saj. Një artist i cili do të kalojë një kompozicion nga një kanavacë të një më e madhe, duhet ta krijojë në një rend të ri që të ruajë shprehjen e saj; duhet të përshtatë karakteret dhe jo vetëm ta ndreqë në një kanavacë më të madhe.

Harmonia dhe mospajtimi i ngjyrave mund të prodhojnë efekte të pranueshme. Shpesh kur filloj të punoj, regjistroj ndjesi të freskëta dhe sipërfaqësore gjatë seancës së parë. Disa vite më parë ndonjëherë edhe ndihesha i kënaqur me rezultatit. Por sot nëse do të isha i kënaqur, tani që mendoj se mund të shoh më larg, piktura ime do të kishte një paqartësi në të: duhet të kisha regjistruar ndjesitë fluturake të një momenti i cili mund të përcaktonte jo tërësisht ndjesitë e mia dhe të cilat mezi do t'i njihja ditën tjetër.

Dua të arrij atë gjendje kondensimi të ndjesive që prodhon pikturën. Mund të jem i kënaqur me një punë që e bëj në një të ulur, por lodhem shpejt prej saj, ndaj parapëlqej ta ripunoj që më vonë ta njoh si përfaqësim të gjendjes time mendore. Kishte një kohë që nuk i lija kurrë pikturat e mia të varura në mur sepse më kujtonin momente emocionale të tepërta dhe nuk më pëlqente t'i shihja sërish kur isha i qetë. Këto ditë përpiqem të vendos paqe në pikturat e mia dhe t'i ripunoj për sa kohë që s'ia kam dalë.

Të hamendësojmë se dua të pikturoj trupin e një gruaje: në radhë të parë e mbush me hir dhe hijeshi, por e di që duhet t'i jap diçka më shumë. Do ta kondensoj kuptimin e këtij trupi duke kërkuar linjat e tij thelbësore. Hijeshia do të jetë më pak e dukshme në vështrimin e parë, por rrjedhimisht duhet të dalë nga imazhi i ri i cili do të ketë një kuptim më të gjerë, edhe më njerëzor. Hijeshia do të jetë më pak spikatëse sepse nuk do të jetë cilësia e vetme e pikturës, por nuk do të ekzistojë më pak nga qëndrimi brenda konceptit të përgjithshëm të figurës.

Hijeshia, butësia, freskia – ndjesi të tilla fluturake. Kam një kanavacë në të

cilën ngjyrat janë ende të njoma dhe filloj t'i punoj sërish. Toni padyshim do të bëhet më i mërziqshëm. Do të zëvendësoj tonin origjinal me një më të dendës me të madhe, një përmirësim, por më pak joshëse në prag.

Piktorët impresionistë, veçanërisht Monet dhe Sisley, kanë ndjesi delikate, shumë të afërta me njëra-tjetrën: si rezultat kanavacat e tyre duken të gjitha të ngjashme. Fjala "impresionizëm" karakterizon përsosmërisht stilin e tyre, pasi regjistrojnë mbresa fluturake. Nuk është përcaktim i përshtatshëm për disa piktorë të kohëve të fundit të cilët u shmangen mbresave të para, dhe e konsiderojnë gati të pasinqertë. Një interpretim i shpejtë i një peizazhi përfaqëson vetëm një moment të ekzistencës së tij [durée]. Parapëlqej, duke këmbëngulur për karakterin e tij thelbësor, të rrezikoj humbjen e hijeshisë që të arrij qëndrueshmëri më të madhe.

Nën këtë vazhdimësi momentesh të cilat përbëjnë ekzistencën sipërfaqësore të qenieve dhe gjërave, të cilat po i modifikon dhe po i transformon vazhdimisht, mund të kërkoj për një karakter më të vërtetë, më thelbësor, të cilin artisti do ta kapë që t'i japë realitetit një interpretim më të përhershëm. Kur shkojmë te dhomat e skulpturave të shekullit të shtatëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë në Louvre dhe shohim, për shembull, një vepër të Puget, mund të vërejmë që shprehja është e forcuar dhe ekzagjeruar deri në pikën që bëhet shqetësuese. Është një çështje tjetër nëse shkojmë në Luxembourg; qëndrimi me të cilin skulptorët kapin modelet është gjithmonë ai në të cilin zhvillimi i gjymtyrëve dhe tensionit të muskujve shfaqet në epërsinë më të madhe. Dhe sërish lëvizja e kuptuar kështu nuk i përket asnjë gjëje në natyrë: kur e kapim papritur në foto të çastit, imazhi rezultues nuk na kujton asgjë që kemi parë. Lëvizja e kapur teksa po ndodh është kuptimplotë për ne vetëm nëse nuk izolohet ndjesinë e tanishme as nga ajo që e paraprinë as nga ajo që e ndjek.

Ka dy mënyra për t'i shprehur gjërat; njëra është t'u shfaqësh vrazhdësi, tjetra t'ua evokosh nëpërmjet artit. Duke shmangur

veten nga përfaqësimi fjalë për fjalë i lëvizjes, arrin bukuri më të madhe e madhështi. Shih një statujë egjiptiane: na duket e ngurtë, por ndjejmë që imazhi i trupit ka aftësi lëvizjeje dhe e cila, pavarësisht ngurtësisë, është e animuar. Grekët janë tepër të qetë: një burrë që hedh një disk kapet në momentin kur mbledh fuqinë, ose të paktën, nëse shfaqet në pozicionin më të tendosur e të pasigurt të nënkuptuar nga veprimi i tij, skulptori e mishëron dhe e kondenson që balancimi të rithemelohej, duke sugjeruar kështu idenë e kohëzgjatjes. Lëvizja në vetvete është e paqëndrueshme dhe jo e përshtatshme për diçka të qëndrueshme si skulptura, në mos artisti është i ndërgjegjshëm për të gjithë veprimin nga i cili shfaq vetëm një moment.

Më duhet të përcaktoj saktësisht karakterin e objektit ose të trupit që dëshiroj të pikturoj. Për ta bërë këtë, e studioj metodën time me shumë kujdes: nëse vendos një pikë të zezë në një fletë të bardhë, pika do të jetë e dukshme sado larg ta mbaj: është shënim i qartë. Por pranë kësaj pike vendos një tjetër, dhe më pas një të tretë, dhe tashmë ka hutim. Që pika e parë të ruajë vlerën duhet ta zmadhoj teksa vendos shenja të tjera në letër.

Nëse mbi një kanavacë të bardhë vendos disa ndjesi blu, jeshile, të kuqe, çdo furçë e re ul rëndësinë e pararendëseve. Supozojmë se më duhet të pikturoj një brendësi: kam përpara meje një bufë filxhanësh; më jep ndjesinë e të kuqes së ndezur, dhe vendos një të kuqe që më kënaq. Themelohej një lidhje mes kësaj të kuqeje dhe të bardhës së kanavacës. Ja të vë një jeshile pranë të kuqes, dhe ta bëj dyshtemenë të verdhë; dhe sërish do të ketë një lidhje mes jeshiles, ose të verdhës me të bardhën e kanavacës e cila do të më kënaqë. Por këto tone të ndryshme reciprokisht dobësojnë njëra-tjetrën. Është e nevojshme që shenjat e ndryshme që përdor të balancohen që të mos shkatërrojnë njëra-tjetrën. Për ta bërë këtë duhet të organizoj idetë e mia: marrëdhëniet mes toneve duhet të jenë të tilla që të mbështeten jo të shkatërrohen. Një kombinim i ri ngjyrash do të ketë sukses dhe do të japë tërësinë e paraqitjes sime. Jam i detyruar të zhvendos deri sa më në fund piktura të mos duket tërësisht e ndryshuar kur, pas modifikimeve të suksesshme, e kuqja ia ka dalë të jetë dominuese mbi jeshilen. Nuk mund ta kopjoj natyrën në mënyrë servile; jam i detyruar ta interpretoj dhe t'i jap shpirtin e pikturës. Nga marrëdhëniet që kam gjetur në të gjithë tonet duket të rezultojë një harmoni e gjallë ngjyrash, një harmoni analoge me një kompozim muzikor.

Për mua e gjitha është te konceptimi. Kështu duhet të kem një pamje të qartë të tërës qysh në fillim. Mund të përmend një skulptor të madh i cili na jep disa copëra të admirueshme: por për të një kompozim është thjesht një grupim fragmentesh, i cili rezulton në një shprehje konfuze. Në vend të tij shih një nga pikturat e Cézanne-it: të gjitha janë kaq mirë të rregulluara sa pavarësisht largësisë ku qëndron apo sa figura përfaqësohen gjithmonë do të arrij të dallosh qartësisht çdo figurë dhe të dish se cilat gjymtyrë i përkasin cilit trup. Nëse ka rregull dhe qartësi në pikturë, do të thotë se që nga fillimi ky rregull dhe kjo qartësi ka ekzistuar në mendjen e piktorit, ose që piktori ishte i ndërgjegjshëm për domosdoshmërinë e tyre. Gjymtyrët mund të kryqëzohen ose të ndërthuren, por në sytë e spektatorit megjithatë do të qëndrojnë të lidhura dhe do të ndihmojnë në artikullimin e trupit të duhur: i gjithë hutimi zhduket.

Funksioni kryesor i ngjyrave duhet që t'i shërbejë shprehjes sa më mirë të jetë e mundur. Unë i vendos tonet pa një plan të paramenduar. Nëse në fillim, dhe ndoshta pa ndërgjegje, një ton më ka joshur ose kapur veçanërisht, më së shumti pasi

piktura mbaron vërej që e kam respektuar këtë ton ndërkohë që progresivisht kam ndryshuar dhe transformuar gjithë të tjerat. Aspekti shprehës i ngjyrave më imponon në një mënyrë krejtësisht instinktive. Për të pikturuar një peizazh vjeshte nuk do të përpiqem të mendoj se çfarë ngjyrash i shkojnë kësaj stine, do të frymëzohem vetëm nga ndjesia që ngjall stina te unë: pastërtia e akullit e qiellit blu të athët e shpreh stinën po aq mirë sa nuancat e gjethnajës. Vetë ndjesitë e mia ndryshojnë, vjeshta mund të jetë e butë dhe e ngrohtë si një vazhdim i verës, ose shumë e freskët me një qiell të ftohtë dhe pemë ngjyrë limoni që i japin një mbresë drithëruese dhe shpall tashmë dimrin.

Zgjedhja ime e ngjyrave nuk qëndron në ndonjë teori shkencore; është e bazuar në vëzhgime, ndjesi, dhe përjetime të ndjera. Frymëzuar nga disa faqe të Delacroix, një artist si Signac është i preokupuar me ngjyrat komplementare, dhe njohuria teorike e tyre do ta udhëheqë të përdorë një ton të caktuar në një vend të caktuar. Por unë thjesht përpiqem të vendos ngjyrat të cilat japin ndjesinë time. Ka një proporcion shtytës tonesh që mund të më udhëheqin të ndryshoj formën e një figure ose të transformoj kompozimin tim. Deri sa të kem arritur këtë proporcion në të gjitha pjesët e kompozimit përpiqem për të dhe vazhdoj të punoj. Pastaj vjen një moment kur të gjitha pjesët kanë gjetur marrëdhëniet e tyre të qarta, dhe nga aty do të ishte e pamundur për mua të shtoja një furçë pa m'u dashur ta ripikturoj të gjithën.

Në realitet, mendoj se vetë teoria e ngjyrave komplementare nuk është absolute. Në studimin e pikturave të artistëve njohuria mbi ngjyrat e të cilëve varet nga instinkti dhe ndjenja, dhe në një analogji të vazhdueshme me ndjesitë e tyre, mund të përcaktosh disa ligje ngjyrash dhe kështu të zgjerosh limitet e teorisë së ngjyrave siç është përcaktuar tani.

Ajo që më intereson nuk është as natyra e qetë as peizazhi, por figura njerëzore. Është ajo që më lejon më së miri të shpreh mrekullimin gati fetar ndaj jetës. Nuk këmbëngul mbi gjithë detajet e fytyrës, në vendosjen një nga një me saktësi anatomike. Nëse kam një model italian i cili në pamje të parë jep vetëm një ekzistencë tërësisht kafshërore, gjithsesi zbuloj cilësitë e tij thelbësore, penetroj mes linjave të fytyrës që sugjerojnë gravitetin e thellë që vazhdon në çdo fytyrë njerëzore. Një vepër arti duhet të mbajë brenda vetes domethënien e saj e tërë dhe t'ia imponojë atë vëzhguesit edhe para se të kuptojë subjektin. Kur shoh afresket e Giotto-s në Padua nuk e shqetësoj veten për të njohur se cilën skenë nga jeta e Krishtit kam përpara meje, por kuptoj menjëherë ndjeshmërinë që del nga ajo, sepse është në linjat e saj, në kompozimin, në ngjyrën. Titulli shërben vetëm për të pohuar përshtypjen time.

Ajo që unë ëndërroj është një art i ekuilibrit, pastërtisë e paqes, i lirë nga shqetësimi apo subjektet depresionuese, një art i cili mund të jetë për çdo punonjës mendor, për biznesmenin si dhe njeriun e letrave, për shembull, një ndikim qetësues e lehtësues në mendje, diçka si një kolltuk i mirë i cili të jep pushim nga lodhja fizike.

Shpesh lind një diskutim mbi vlerën e proceseve të ndryshme, dhe marrëdhënien e tyre me temperamentet e ndryshme. Bëhet një dallim mes piktorëve të cilët pikturojnë direkt nga natyra dhe atyre që pikturojnë vetëm nga imagjinata. Personalisht, mendoj se asnjë prej këtyre metodave duhet të parapëlqehet duke përjashtuar tjetrën. Të dyja mund të përdoren me radhë nga i njëjti individ, ose sepse i duhet kontakti me objektet që të marrë ndjesitë të cilat do t'i zgjojnë kreativitetin, ose ndjesitë e tij janë tashmë të organizuara. Në çdo rast, ai do të arrijë në tërësinë që do të jetë piktura.



Dhoma e kuqe, 1908

Sidoqoftë, mendoj se mund të gjykohej gjallëria dhe fuqia e një artisti i cili, pasi ka marrë mbresa nga direkt nga spektakli i natyrës, ka aftësinë të organizojë ndjesitë e tij për të vazhduar punën në të njëjtën gjendje mendore në ditë të ndryshme, dhe për t'i zhvilluar këto ndjesi; kjo fuqi dëshmon që është mjaftueshëm mjeshtër i vetes për t'iu nënshtruar disiplinës.

Mjetet më të thjeshta janë ato që e lejojnë më së miri artistin për të shprehur veten. Nëse ka frikë nga banalja nuk mund t'i shmanget duke u dukur i pazakonshëm, ose duke bërë vizatime të çuditshme apo duke përdorur ngjyra ekscentrike. Mjetet e tij të shprehjes duhet të rrjedhin thujtë nga nevoja e temperamentit të tij. Duhet të ketë përlësinë e mendjes për të besuar që ka pikturuar vetëm atë që ka parë. Më pëlqen mënyra si e shpreh Chardin: "Aplikoj ngjyrën deri sa të ketë një ngjashmëri." Ose Cézanne: "Dua të siguroj një ngjashmëri," ose Rodin: "Kopjo natyrën!", Leonardo thoshte: "Ai që mund të kopjojë mund të krijojë." Ata që punojnë me një stil të paramenduar, duke i kthyer qëllimisht kurrizin natyrës,

humbasin të vërtetën. Një artist duhet të kuptojë, kur po arsyeton, që piktura e tij është një dredhi; por kur pikturon duhet të ndihet sikur ka kopjuar natyrën. Edhe kur largohet nga natyra, duhet ta bëjë me bindjen se po e interpreton më të plotë.

Disa thonë se pikëpamje të tjera mbi pikturën mund të priteshin nga një piktor, dhe se unë kam nxjerrë vetëm klishe. Kësaj, do t'i përgjigjem se nuk ka të vërteta të reja. Roli i artistit, ashtu si i studiuesit, përbën kapjen e të vërtetave të tanishme që i përsëriten shpesh, por të cilat marrin kuptim të ri për të dhe të cilat ai do t'i bëjë të vetat kur të kapë kuptimin e tyre më të thellë. Nëse pilotëve do t'u duhej të na shpjegonin kërkimin që çoi në largimin e tyre nga toka dhe ngritjen në ajër, thjesht do të konfirmenin parimet elementare të fizikës të lëna pas dore nga shpikës më pak të suksesshëm.

Një artist përfiton gjithmonë nga informacioni për veten e tij, dhe unë jam i lumtur që kam mësuar pikën time të dobët. M. Péladan te *Revue Hebdomadaire* i qaset një numri të caktuar piktorësh, mes

të cilëve duhet të fus dhe veten, të cilët e quajnë veten 'Fauves', dhe sërish vishen si gjithë të tjerët, që të mos bien në sy më shumë se këmbësorët në dyqan. A vlen kaq pak gjeniu? Nëse do të ishte çështja vetëm tek unë, që t'i qetësohej mendja M. Péladan-it, nesër do ta quaja veten Sar dhe do të vishesha si nekroman.

Në të njëjtin artikull, ky shkrimtar i shkëlqyer deklaroi se unë nuk pikturoj sinqerisht, dhe do të më justifikohesh acarimi nëse nuk do të kishte zbutur deklaratën e tij duke thënë, "Dua të them ndershmërisht në respekt ndaj idealeve dhe rregullave." Problemi është se ai nuk e përmend se ku janë këto rregulla. Jam i gatshëm që ato të ekzistojnë, por nëse do të ishte e mundur të mësoheshin, sa artistë sublimë do të kishim!

Rregullat nuk ekzistojnë jashtë individëve: ndryshe një profesor i mirë do të ishte aq gjeni i madh sa Racine. Çdokush prej nesh ka aftësinë të përsërisë parime të përsosura, por pak mund të penetrojnë kuptimin e tyre. Jam i gatshëm të pranoj se nga një studim i veprave të Raphael-it apo Titian-it mund të merret një grup rregullash më i plotë se te veprat e Manet apo Renoir, por rregullat e ndjekura nga Manet apo Renoir ishin ato që i përshtateshin temperamenteve të tyre dhe unë parapëlqej ato piktura para veprave të atyre që janë të kënaqur me imitimin e *Venus of Urbino* or the *Madonna of the Goldfinch*. Këto të fundit, duam apo jo, ne përkasim në kohën tonë dhe ndajmë opinionet e saj, ndjesitë, madje dhe deluzionet. Të gjithë artistët mbajnë gjurmën e kohëve të tyre, por te artistët e mëdhenj kjo shënjohej më thellë. Epoka jonë, për shembull, përfaqësohet më mirë nga Courbet sesa Frémiet. Na pëlqen apo jo, sado me këmbëngulje ta quajmë veten të dëbuar, mes periudhës dhe vetes tonë themelohet një lidhje e patretshme, të cilës vetë M. Péladan nuk i arratiset dot. Estetët e të ardhmes ndoshta mund të përdorin si dëshmi librat e tij nëse u ngulitet në kokë të zbulojnë që askush në kohën tonë nuk kuptonte gjë për artin e Leonardo da Vinci-t.

Përktheu Enxhi Hudhri



Kërcimi, 1910

ROMAN I RI NGA MIRA MEKSI



Një grua e re sfidon vdekjen në përballje me një sëmundje të rëndë gjymtuese për feminitetin e saj. Sfidon edhe dashurinë ku kish lidhur shpresën për jetën, që e braktis në çastet më të vështira. Në luftën për mbijetesë arrin të mbahet fort pas fillit të matriarkave të gjakut, fillit të gjakut të nënës, që shkon gjer në fund të kohërave.

Një amazonë luftëtare përballlet me gjymtimin e feminitetit të saj për të manovruar Harkun e Pathyeshmërisë të prijësës. Ajo përleshet trup më trup me dashurinë, të cilën nuk e pranon, por që ia imponojnë perënditë.

Brenda një kohe mitike, mijëra vitet e shkuara dhe e sotmja puqen në një pikë. Të dyja gratë e reja, shëmbëlltyra të njëra-tjetrës në lumin e kohës që nuk ndalet, takohen në një çast vetëtimë për të shkëmbyer fuqinë magjike të mbijetesës.

Një thriller fantastik ku bashkohet e shenjta e tatuazhit të Alefit dhe brirëve të demit të Kretës, magjia e një varëseje kamé të stërlashtë me kumte pellazge, mugujt e mitologjisë greke dhe tmerri i pandemisë Covid-19 – gjithçka për të zbuluar përjetësinë e thelbit të ekzistencës njerëzore, nga pena mjeshtërore e autores së romanit të suksesshëm “Kutia e Agatha Christie-t”.